



**AUTORITETI I  
KONKURRENCËS**

---

**RAPORTI VJETOR 2015**

**DHE**

**SYNIMET KRYESORE TË PUNËS PËR VITIN 2016**

**Autoriteti i Konkurrencës**

Adresa: Rr. Sami Frashëri, nr. 4,

Kati IV, Tiranë

Tel: +355 4 2 234 504

Fax: +355 4 2 234 497

Faqe e internetit: [caa.gov.al](http://caa.gov.al)

Email: [competition@caa.gov.al](mailto:competition@caa.gov.al)

## TABELA E PËRMBAJTJES

<b>Fjala e Hyrjes E Kryetarit të Komisionit</b>	4
<b>I. AUTORITETI I KONKURRENCËS – ZHVILLIMET KRYESORE</b>	5
<b>I.1 Përmbledhje e zhvillimeve kryesore</b>	5
<b>I.2 Zbatimi i rezolutës së Kuvendit për 2015</b>	8
<b>II. ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURRENCËS</b>	10
<b>II.1 Administrimi i ankesave</b>	10
II.1.1 Tregu i komunikimeve elektronike	11
II.1.2 Tregu i mediave audiovizuale	14
II.1.3 Tregu i energjisë elektrike	15
II.1.4 Tregu i prokurimeve publike	16
II.1.5 Tregu i shërbimit të transportit ndërkombëtar detar	17
II.1.6 Tregje të tjera	17
<b>II.2. Hetim i përgjithshëm në sektorin bankar</b>	19
<b>II.3. Marrëveshjet e ndaluara</b>	19
II.3.1 Hetim në tregun e prokurimeve “Ndërtimit të pjesës së jashtme të Unazës së madhe”	20
II.3.2 Hetim në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të cigareve të fabrikuara	21
II.3.3 Hetim në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve	22
II.3.4 Hetim në tregun e shërbimeve të hotelerisë	22
II.3.5 Hetim në tregun e prokurimit publik e sinjalistikës rrugore	23
II.3.6 Hetimi në tregun e prokurimit publik për ruajtje objektsh për vitin 2015	24
<b>II.4. Përrjashtim nga ndalimi i marrëveshjeve “KESH dhe OSHEE</b>	24
<b>II.5. Abuzimi me pozitën dominuese</b>	26
II.5.1 Hetim në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve	26
II.5.2 Hetimi në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve	27
II.5.3 Hetim paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN	28
II.5.4 Hetim në tregun e telefonisë celulare me pakicë	30
<b>II.6. Kontrolli i përqendrimeve</b>	31
II.6.1 Përqendrimet e autorizuara	32
<b>II.7. Rishikimi i të drejtave ekskluzive</b>	35
<b>II.8. Monitorimet e tregut</b>	37
II.8.1 Monitorim i tregu i importit dhe shitjes së karburanteve	37
II.8.2 Monitorimi i tregun të shërbimit të pajisjeve fiskale	37
<b>II.9. Rishikimi gjyqësor i çështjeve të Autoritetit të Konkurrencës</b>	38
II.9.1 Analiza e rasteve të rishikimit gjyqësor	41
<b>II.10. Përafrimi i legjislacionit në fushën e konkurrencës</b>	44
<b>III. ADVOKACIA DHE KULTURA E KONKURRENCËS</b>	45
<b>III.1 Vlerësimi i akteve dhe projekt-akteve normative</b>	45

<b>III.2. Rekomandimet e mirëfunksionimin e tregjeve</b> .....	48
III.2.1 Në tregun e energjisë elektrike .....	48
III.2.2 Në tregun e karburanteve dhe gazit të lëngshëm të naftës .....	49
III.2.3 Në tregun e transportit ajror dhe detar .....	49
III.2.4 Në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare .....	50
III.2.5 Në tregun e ndërtimit/prokurimit publik .....	50
III.2.6 Në tregun e pajisjeve fiskale .....	51
<b>III.3 Bashkëpunimi ndërinstitucional</b> .....	51
III.3.1. Bashkëpunimi me entet rregullatore dhe institucionet e tjera publike .....	51
III.3.2. Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës dhe gjyqësorin .....	51
III.3.3 Marrëdhëniet me Ministrinë e Integritimit Evropian .....	52
<b>III.4. Kultura e konkurrencës – marrëdhëniet me publikun dhe mediat</b> .....	52
<b>IV. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR</b> .....	55
<b>IV.1 Bashkëpunimi me Komisionin Evropian</b> .....	55
<b>IV.2. Bashkëpunimi me OECD (RCC Budapest)</b> .....	55
<b>IV.3. Bashkëpunimi me UNCTAD</b> .....	55
<b>IV.4. Bashkëpunimi me Rrjetin Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN)</b> .....	56
<b>V. BURIMET NJERËZORE</b> .....	57
<b>V.1. Struktura organizative dhe funksionet e Autoritetit të Konkurrencës</b> .....	57
<b>V.2. Forcimi i kapaciteteve administrative</b> .....	58
<b>V.3. Menaxhimi financiar</b> .....	59
<b>VI. PRIORITETET PËR VITIN 2016</b> .....	60
<b>VI.1. Zbatimi i ligjit të konkurrencës</b> .....	60
<b>VI.2 Përafrimi dhe përmirësimi i legjislacionit</b> .....	61
<b>VI.3. Rritja e advokacisë dhe bashkëpunimi ndërinstitucional</b> .....	61
<b>VI.4 Forcimi i kapaciteteve administrative</b> .....	62
Shtojca 1 Të dhëna statistikore mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës sipas viteve .....	63
Shtojca 2 Vendimet e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2015 .....	64
Shtojca 3 Ekzekutimi i gjobave të vendosura nga Komisioni deri më 31 Dhjetor 2015 .....	68
Shtojca 4 Lista e Vendimeve shoqëruar me Urdhër Ekzekutimi .....	69
Shtojca 5: Përqendrimet e njoftuara dhe të autorizuara .....	70
Shtojca 6: Rezoluta e Kuvendit për veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës .....	71
Shtojca 7: Raporti i Progresit i Komisionit Evropian, Kapitulli 8: Politika e konkurrencës .....	73
Shtojca 8: Matrica e vendimeve për dhënie rekomandimesh për projektaktet për vitin 2015 .....	74
Shtojca 9: Organograma e Autoritetit të Konkurrencës .....	82
Shtojca 10 Buxheti faktik i Autoritetit të Konkurrencës viti 2015 .....	83

## FJALA E HYRJES E KRYETARIT TË KOMISIONIT

PROF.DR. LINDITA MILO (LATI)

Shpesh akademikët dhe politikanët i referohen lirisë ekonomike si një nga instrumentat jetikë për rritjen ekonomike të vendit ndërkohë që komuniteti i biznesit dhe konsumatorët i referohen konkurrencës së drejtë si burim i rritjes së mirëqenies së tyre.

Rritja ekonomike, punësimi, rritja e investimeve dhe teknologjia e inovacioni, përmirësimi konkurrueshmërisë së ekonomisë janë gjithmonë pjesë përbërëse e strategjive të çdo qeverie, por jo gjithmonë përfitimet nga politikat konkrete janë ato të duhura. Shkak i deformimit është mënyra e zbatimit të strategjive, politikave dhe e ligjeve, prandaj në sistemin e së drejtës ndërtohen garantët e mbrojtjes së interesave të publikut.

Kjo ka qenë filozofia e veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës, eksperiencia 12 vjeçare e të cilit ka treguar se deformimet në treg shkaktohen nga mosfunksionimi i sistemeve dhe një institucion është vetëm një nga hallkat e sistemit dhe nuk mund të zëvendësoj sistemin.

Prandaj dhe zbatimi me efikasitet të politikës dhe ligjit të konkurrencës kërkon jo vetëm një institucion të pavarur të konkurrencës, por mirëfunksionimi i të gjithë pjesëve të tjera të së drejtës në Shqipëri që mundësojnë mirëfunksionimin e tregjeve.

Ndërhyrjet e vazhdueshme si në tregjet e rregulluara dhe në tregjet e liberalizuara kanë evidentuar sfidat e vazhdueshme e mbikëqyrësit të lojës së ndërmarrjeve në treg, për të zbuluar dhe ndaluar praktikant antikonkurrese të konkurrentëve, por jo vetëm.

Një sfidë e vazhdueshme mbetet edhe bashkëveprimi me rregullatorët sektorial e pushtetin ekzekutiv të cilat duhet të respektojnë ligjin dhe rezolutën e Kuvendit për të marre paraprakisht vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt akt që ka si qëllim apo pasojë kufizimet sasiore apo cilësore të konkurrencës në treg.

Autoriteti i Konkurrencës nuk është thjesht një emër në listën e institucioneve të tjera rregullatore dhe publike, por është pjesë jetike e sistemit që garanton zbatimin e kushtetutës për lirinë e veprimtarisë ekonomike dhe ekonominë e tregut. Prandaj efekti real i ndërhyrjes në treg të këtij institucioni kërkon domosdoshmërisht bashkëpunim dhe marrjen në konsideratë të vendimeve dhe rekomandimeve nga politika, ekzekutivi dhe entet rregullatore.

## I. AUTORITETI I KONKURENCËS – ZHVILLIMET KRYESORE

Sistemi ekonomik në Republikën e Shqipërisë bazohet në ekonominë e tregut dhe në lirinë e veprimtarisë ekonomike, pohim i cili është i saksionuar në Kushtetutë. Për rrjedhojë, konkurrenca është një fenomen bashkëshoqërues i sistemit ekonomik dhe instrumenti që garanton përfitimet ekonomike që rrjedhin nga ekonomia e tregut. Si një vlerë e padiskutueshme, për nxitjen dhe mbrojtjen e konkurrencës është ndërtuar kuadri ligjor, i cili përbëhet nga Politika dhe Ligji i konkurrencës, si dhe sistemi ligjor që garanton konkurrencën e drejtë. Gjithashtu është ndërtuar kuadri institucional i përbërë nga Autoriteti i Konkurrencës dhe institucionet që garantojnë trajtimin e barabartë të lojtarëve të tregut, mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtjen e pronësisë intelektuale, etj.

Autoriteti i Konkurrencës është institucion publik i pavaruar që vepron në zbatim të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar) (këtu e në vijim Ligji) dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës, që përbëjnë instrumentet ligjore që mundësojnë adresimin dhe zgjidhjen e kufizimeve, shtrembërimeve dhe pengimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Gjithashtu, institucioni i konkurrencës funksionon në zbatim të normave dhe praktikave më të mira të administratës publike dhe të së drejtës europiane të konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës vepron për të siguruar një konkurrencë të lirë dhe efektive në treg në zbatim të Ligjit, duke u mbështetur në disa shtylla kryesore që sigurojnë mbrojtjen e konkurrencës nga praktikant anti-konkurrese duke përfshirë: marrëveshjet e ndaluara në formën e karteleve apo sjelljeve të bashkërenduara dhe abuzimin me pozitën dominuese. Gjithashtu, institucioni i konkurrencës duhet të sigurojë nxitjen e konkurrencës nëpërmjet kontrollit të përqendrimeve të ndërmarrjeve për të mos lejuar krijimin ose forcimin e pozitës dominuese në tregjet përkatëse, vlerësimin e të drejtave ekskluzive dhe të veçanta, si dhe advokacinë e konkurrencës duke dhënë rekomandimet për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në funksion të nxitjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Nëpërmjet veprimtarisë së tij, Autoriteti i Konkurrencës, synon për një treg sa më funksional e objektiv, i cili nuk mund të realizohet pa mundësuar gjithëpërfshirjen e të gjithë aktorëve dhe faktorëve të tregut. Në këtë këndvështrim, mirëfunksionimi i tregjeve kërkon kujdesin si për mirëqenien e konsumatorëve, ashtu edhe për t'i bërë tregjet sa më të hapura për hyrjet e reja dhe konkurrese. Kjo karakteristikë e ligjit të konkurrencës përbën një nga aspektet e përhershme të veprimtarisë së institucionit të konkurrencës që është realizuar nëpërmjet bashkëpunimit të vazhdueshëm me Kuvendin, institucionet qendrorë dhe vendore, entet rregullatore, bizneset e organizatat e tyre, si dhe shoqatat e mbrojtjes së konsumatorëve.

### I.1 Përmbledhje e zhvillimeve kryesore

Edhe për vitin 2015, veprimtaria e institucionit të konkurrencës ka qënë në zbatim të Ligjit e Politikës së Konkurrencës, duke trajtuar me kujdes ankesat si impulsi kryesor mbi problematikat që shfaqen në tregjet e ndryshme, të Rezolutës së Kuvendit mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2014, si dhe të detyrave të përcaktuara në raportet e progresit nga Bashkimi Europian.

Veprimtaria shumë dimensionale të Autoritetit të Konkurrencës gjatë 2015, pasqyrohet nëpërmjet 51 Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, të cilat janë ndërmarrë në zbatim të ligjit, duke shqyrtuar rastet e marrëveshjeve të ndaluara, abuzimit me pozitën dominuese, kontrollit të përqendrimeve, rekomandimeve për të drejtat ekskluzive dhe projekt-aktet si dhe shqyrtimit të ankesave dhe veprimtarisë procedurale të Autoritetit. Më konkretisht për sjelljet antikonkurrese janë marrë 6 vendime për marrëveshje të ndaluar dhe 3 vendime për abuzimin me pozitën detyruese; 1 vendim për masa të përkohëshme ndaj një ndërmarrje; 11 vendime mbi kontrollin e përqendrimeve; 11 vendime me rekomandime nga vlerësimet e akteve ligjore të institucioneve të tjera publike dhe enteve rregullatore; 3 vendime mbi miratimin e akteve nënligjore të konkurrencës; 1 vendim për përjashtimin e marrëveshjeve, si dhe 15 vendime për procedurat.

Numri i ankesave të adresuara pranë Autoritetit të Konkurrencës gjatë vitit 2015 është 50 kundrejt 33 ankesave të depozituara gjatë vitit 2014, fakt i cili ka krijuar mundësinë e identifikimit të problematikave në tregje, si dhe tregon rritjen e besimit të biznesit dhe konsumatorit tek institucioni garant i lirisë ekonomike.

Qasja ligjore dhe institucionale për të shqyrtuar pa vonesë çdo ankesë sipas objektit të Ligjit dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera për t'i dhënë zgjidhje problematikës së tregjeve, ka sjellë një rritje të besimit publik të institucionit të konkurrencës të përkthyer në një sërë aktesh dhe vendimesh për rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Referuar ankesave të ndara sipas sektorëve rezulton se numri më i madh ka qenë në **tregun e komunikimeve elektronike**, ku gjatë vitit të kaluar ishin 22 ankesa të operatorëve që operojnë në tregun përkatës kryesisht për çështje të rregullimit nga autoriteti rregullator (AKEP).

Risi për ankesat vihet re në **sektorin e medias audiovizive me pagesë**, kryesisht lidhur me detyrimin e operatorëve televizivë për të transmetuar pa pagesë në platformat dixhitale ose kabllorët dhe për këtë arsye, Autoriteti i Konkurrencës ka filluar monitorimin e tregut për të dhënë vendimet përkatëse për hapjen e tregut për konkurrencë dhe heqjen e të drejtave ekskluzive të transmetimit të televizioneve kombëtare dhe lokale për t'i vendosur operatorët në kushtet e “barazisë në treg”.

**Prokurimet publike** mbeten shqetësuese në këndvështrim të konkurrencës, problematika e të cilës i referohet prokurimit të shërbimit të rojeve fizike, madhësisë së loteve, si dhe kriterëve të veçanta në procedurat e prokurimit.

Edhe institucionet publike kanë kërkuar ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës në rastet e dyshuara për kufizim të konkurrencës në treg. Vlen për tu përmendur roli proaktiv i Kontrollit të Lartë të Shtetit në rastin e denoncimit të një marrëveshje të mundshme të ndaluar në prokurimin publik të unazës së re të Tiranës si dhe dy ankesa nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për procedurat e prokurimit publik të shërbimit e-taxation dhe shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike.

**Sektori i energjisë elektrike**, gjithashtu ka shfaqur probleme në funksionimin e tij dhe përveç një procedure të thelluar të hetimit për blerjen e energjisë nga OSHEE për mbulimin e humbjeve, ka patur edhe ankesa kryesisht për diferencimin e faturimit të biznesit mes tensionit të ulët dhe tensionit të mesëm, si dhe çështjet e rregullimit të disbalancave.

**Tregu i telefonisë** ka qenë sërish objekt i procedurave hetimore nga Autoriteti i Konkurrencës nisur mbi bazën e ankesës së operatorëve më të vegjël të tregut mbi diskriminimin e tarifave dhe ofertave për thirrjet brenda me jashtë tregut. Pas përfundimit të procedurave hetimore, Komisioni i Konkurrencës vendosi mbi detyrimin e ndërmarrjes me pozitë dominuese Vodafone Albania për zbatimin e masave detyruese për barazimin e tarifave dhe minutave brenda me jashtë rjetit dhe që të ndalojë të aplikojë tarifa në nivel pakice që kanë efekt diskriminues për sipërmarrësit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare, për të gjitha ofertat e hedhura në treg. Shumë jetike për mirëfunksionimin e këtij tregu është roli i entit rregullator.

Nisur nga disa monitorime të ndërmarra nga Autoriteti i Konkurrencës ndërvite dhe problemet e identifikuar për **tregun bankar**, Komisioni i Konkurrencës vendosi për realizimin e një studimi të plotë të këtij tregu, i cili do të mundësojë të adresohen rekomandimet e duhura për mirëfunksionin e këtij tregu tepër jetik për ekonominë e vendit

Edhe gjatë vitit 2015, në zbatim të detyrave të vendosura nga Kuvendi, Autoriteti i Konkurrencës ka kryer vlerësimin *ex-post* të të drejtave të veçanta dhe ekskluzive të dhëna, duke pasur parasysh mbrojtjen dhe ruajtjen e parimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i të gjitha kontratave koncensionare, ka rezultuar se përgjithësisht gjatë procedurës për dhënien e koncensionave vazhdon të mos respektohet detyrimi i nenit 69 të Ligjit për të marrë vlerësimin e Autoritetit gjatë procedurës së dhënies së të drejtave ekskluzive. Në këto kushte, Komisioni i Konkurrencës u detyrua që të shprehet me një vendim për qeverinë mbi detyrimin e zbatimi të këtij detyrimi ligjor. Në vijim të këtij vendimi, muaji dhjetor i vitit të kaluar shënoi risi, pasi Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës depozitoi pranë Autoritetit të Konkurrencës 3 draft marrëveshjeve koncensionare, ku kërkohej dhënia e mendimit të Autoritetit në lidhje me shkëlqen e mundshme të parimeve të konkurrencës. Në këto raste, institucioni ka kryer një vlerësim *ex-ante* të këtyre draft kontratave koncensionare, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse.

Gjatë vitit 2015, janë shqyrtuar dhe autorizuar 11 raste përqendrimesh lidhur me përfitimn e kontrollit, bashkimin e ndërmarrjeve apo krijimin e një ndërmarrje të re. Përqendrimet e ndodhura janë shqyrtuar si për efektet pozitive të sjella në treg, parë kjo nga pikëpamja e konsumatorit dhe rritjes së efikasitetit në treg ashtu edhe nga premiset e mundshme për të krijuar apo forcuar pozitën dominuese të ndërmarrjes së përqendruar në treg në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi si dhe direktivave komunitare. Kryesisht tregu financiar ka qënë objekt i vlerësimeve dhe autorizimeve të përqendrimeve.

Problematikë vazhdon të jetë **sistemi gjyqësor** që sipas raportit të progresit të KE-së, *“vonesat në proceset gjyqësore janë shumë të gjata dhe duhen bërë përpjekje të mëtejshme për të rritur disponueshmërinë dhe cilësinë e trajnimit për gjyqtarët mbi politikën e konkurrencës”*.

Për të adresuar këtë problematikë, e cila është shumë jetike për efektet në treg të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, janë ndërmarrë disa nisma për trajnimin e gjyqtarëve duke përdorur fondet e dy projekteve të BE-së gjatë viteve të kaluara si dhe të UNCTAD-it në fund të vitit 2015. Por, problem mbetet vonesa e madhe e shqyrtimit të çështjes, e cila zbeh ndjeshëm ndërhyrjen e Autoritetit të Konkurrencës për rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Kështu në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative, gjatë vitit 2015, janë trajtuar gjithsej 6 (gjashtë) vendime të Komisionit të Konkurrencës nga të cilat 2 (dy) kanë përfunduar me rrëzim padie dhe 2 (dy) të tjera me pushim gjykimi, duke lënë në fuqi vendimet e Autoritetit të Konkurrencës, ndërkohë që 2 (dy) çështje kanë përfunduar me pranim padie. Në Gjykatën e Apelit Administrativ gjatë vitit 2015 kanë qenë për shqyrtim 9 (nëntë) çështje, nga të cilat është shqyrtuar vetëm 1 (një) çështje dhe mbeten edhe 8 (tetë) çështje për t'u shqyrtuar në 2016. Në çështjen (Ferlut) e shqyrtuar gjatë vitit 2015 në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë është vendosur pranimi i padisë kundrejt vendimit të Komisionit të Konkurrencës. Nga ana tjetër në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë gjatë 2015 kanë qenë 12 çështje për shqyrtim, nga të cilat nuk është shqyrtuar asnjë prej tyre duke mbetur të gjitha për tu shqyrtuar gjatë vitit 2016, si çështje të mbartura.

Përgjatë 2015, Autoriteti i Konkurrencës ka vijuar procesin e plotësimit të kuadrit ligjor sekondar në përputhje me legjislacionin europian, duke miratuar Udhëzimin "Mbi vlerësimin e kufizimeve vertikale", Udhëzimin "Kushtet dhe detyrimet në rastet e përqendrimeve" si dhe Programin e ri të Lehtësimit nga Gjobat. Programi është i bazuar në përvojat e përbashkëta të Autoriteteve Homologe që kanë operuar me një program lehtësimi për një numër vitesh dhe ka pasur sukses në zbulimin e praktikave anti-konkurrese në rastet e marrëveshjeve të ndaluara duke ofruar lehtësim të plotë ose të pjesshëm për ndërmarrjet që do të bashkëpunojnë me Autoritetin e Konkurrencës.

## **I.2 Zbatimi i rezolutës së Kuvendit për 2015**

Rezoluta e Kuvendit për veprimtarinë e Autoritetit përveç vlerësimit ka dhënë dhe disa rekomandime, të cilat në mënyrë të përmbledhur pasqyrohen si vijon:

Gjatë vitit 2015 janë përfunduar rastet hetimore të filluara në vitit 2014 si në tregun e prokurimeve publike në ndërtimin e unazës së re të Tiranës, hetimi në tregun e prodhimit, importit dhe të shitjes me shumicë e pakicë të karburanteve e të gazit të lëngshëm, tregun e transportit detar të pasagjerëve, si dhe tregu i komunikimeve elektronike, etj. Për secilin rast janë dhënë vendimet përkatëse, të cilat janë kryesisht rekomandime për entet rregullatore apo vendime me detyrime për ndërmarrjet, apo me masa të përkohëshme sipas specifikave të çështjeve.

Gjatë vitit 2015 janë përmirësuar instrumentet e hetimit të befasishëm dhe janë realizuar një sërë inspektimesh të befasishme (pa njoftimin e palëve) si dhe janë trajnuar inspektorët me pajisjet më të fundit të inspektimeve Forensic. Por, përsëri pamundësia për të gjetur evidenca direkte shtron si një prioritet kryesor rritjen e ekspertizës jo vetëm për ivestigimet, por edhe për analizat e thelluara ekonomike për të identifikuar sjelljen e firmave në treg.

Trajnimi i gjyqtarëve me ekspertët e UNCTAD në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës është një tjetër objektivi i rezolutës së Kuvendit i realizuar nga Autoriteti i Konkurrencës dhe që pritet të vijojë edhe gjatë këtij viti në kuadër të projektit të asistencës me UNCTAD.

Gjatë vitit 2015 Autoriteti i Konkurrencës ka prezantuar në një sesion të veçantë në Gjenevë gjatë Asamblesë vjetore të UNCTAD, dokumentin e vlerësimit të Autoritetit të Konkurrencës kërkuar nga ana jonë dhe është konkluduar me një projekt asistence të



financuar nga UNCTAD. Rekomandimet e këtij raporti do të përdoren për të rritur bashkëpunimin ndërinstytucional me entet rregullatore dhe institucionet e tjera publike.


Gjatë vitit 2015, Shqipëria ka marrë një vlerësim pozitiv nga mbikëqyrësit ndërkombëtarë të shprehur në konkluzionet e raportit të progresit të Bashkimit Europian për Shqipërinë : “Shqipëria ka shënuar progres të moderuar në fushën e politikës së konkurrencës”. Më konkretisht, për Autoritetin e Konkurrencës, raporti vëren se “në fushën antikartel dhe kontrollit të përqendrimeve Autoriteti i Konkurrencës ka miratuar udhëzimet për vlerësimin dhe abuzimin e pozitës dominuese në treg dhe ka hartuar udhëzime të reja bazuar në njoftimin e Komisionit Europian”. Gjithashtu janë vlerësuar pozitivisht kapacitetet administrative të Autoritetit të Konkurrencës, me nje “nivel të mirë ekspertize” duke shënuar në këtë mënyrë progres në kapacitetet e institucionit për zbatimin e ligjit.

## II. ZBATIMI I LIGJIT TË KONKURRENCËS

Ligji “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar në vitin 2010 parashikon një nen të veçantë për mënyrën e trajtimit të ankesave që mund të kenë palët e interesuara për konstatime ose dyshime lidhur me kufizime, shtrembërime apo pengime të konkurrencës. Në vijim, trajtimi i ankesave bëhet në respektim të afateve sipas rregullores së Funkcionimit të Autoritetit të Konkurrencës duke garantuar mbetjen anonim të ankimesit sa herë kërkohet nga ky i fundit.

### II.1 Administrimi i ankesave

Në total gjatë vitit 2015 ishin 49 ankesa nga të cilat 25 janë konstatuar në përputhje me objektin e Ligjit. Sikurse paraqitet edhe në diagramën e mëposhtme, nisur nga 4 raste kanë filluar procedura hetimore, 5 raste janë vlerësuar dhe kanë konkluduar me vlerësim ligjor, për 5 ankesa janë monitoruar dhe janë dhënë rekomandime, për 8 ankesa kanë vijuar monitorime, ndërsa 3 raste janë ankesa administrative për revokimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës.



Edhe në rastet e ankesave që janë konstatuar jashtë objektit të Ligjit është mbajtur qëndrim pro-aktiv duke bashkëpunuar me institucionet përgjegjëse për t'i dhënë zgjidhje ankimeseve sipas legjislacionit në fuqi.

Në vijim paraqiten të gjitha ankesat e depozituar pranë Autoritetit të Konkurrencës të cilat janë të grupuara sipas tregjeve.

### II.1.1 Tregu i komunikimeve elektronike

Tregu i komunikimeve elektronike mbetet, edhe për vitin 2015, ndër tregjet për të cilat ka patur më shumë ankesa me spektër të gjërë për mosfunksionimin e konkurrencës, megjithëse është një treg i rregulluar. Më konkretisht

1. *Ankesat e ndërmarrjeve "Plus Communication" sh.a dhe "Albtelecom" sh.a kundër ndërmarrjes Vodafone Albania sh.a.* për abuzim në tregun e telefonisë së lëvizshme në Shqipëri nëpërmjet aplikimit të tarifave të diferencuara brenda dhe jashtë rrjetit në ofertat e hedhura në treg. Bazuar në ankesën e ndërmarrjes "Plus" sha si dhe monitorimin e tregut, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me Vendimin nr. 336, datë 11.11.2014, "Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare ndaj shoqërisë Vodafone Albania sh.a". Konstatimet e ndërmarrjes Albtelecom për sjelljen e ndërmarrjes Vodafone Albania në tregun e telefonisë celulare me pakicë, ishin evidentuar edhe në Raportin e hetimit paraprak të nisur sipas ankesës së shoqërisë Plus sh.a dhe u trajtuan në të njëjtën procedurë hetimore. Më shumë detaje mbi këtë rast paraqitet në seksionin II.5.4 .

2. *Ankesat e ndërmarrjeve "Vodafone Albania" sh.a dhe "AMC" sh.a në lidhje me ofertat promovionale të ndërmarrjes Albtelecom në qytetet e Vlorës dhe Gjirokastrës.* Pas vlerësimit i është kërkuar AKEP-it që të shqyrtojë ankesën e ndërmarrjes Vodafone, në lidhje me zbatueshmërinë e detyrimeve të vendosura nga vetë AKEP në vendimet e tij ku ka shpallur ndërmarrjen Albtelecom SHA me fuqi të ndjeshme në treg për telefoninë fikse dhe celulare, si dhe ka vendosur detyrimet përkatëse, lidhur me: ndarjen e llogarive për telefoninë fikse dhe atë të lëvizshme; detyrimin e transparencës; detyrimin e mos-diskriminimit; ofertat e përbashkëta mes segmenteve të tregut të telefonisë fikse, celulare dhe shërbimit të internetit. Nga ana e Autoritetit i është kërkuar regullatorit që të monitoroj zbatimin e detyrimeve.

3. *Ankesat e ndërmarrjes "Plus Communication" sh.a mbi tenderin me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX".* "Plus Communication" me nr. 155 prot, dt. 13.02.2015, si dhe nr. 196 prot, dt. 20.02.2015, pretendon se kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit me objekt: "Dhënia e të drejtave të përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX", përbëjnë pengesë / barrierë për hyrjen e operatorëve të vegjël në një treg përkatës si gjenerata 4G.

Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit të shqetësimeve të ngritura nga "Plus Communication" SH.A, Komisioni i Konkurrencës, me anë të Vendimit Nr. 351, datë 03.03.2015 "Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike lidhur me brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX", vendosi t'i rekomandojë AKEP-it që t'u mundësohet të gjithë operatorëve celularë e drejta e përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WiMAX, duke i vendosur ata në kushte të barabarta konkurrence në treg.

4. *Ankesa e shoqërisë "Nisatel" ndaj shoqërisë AMC sh.a* lidhur me aplikimin e tarifës së re për terminimin e thirrjeve hyrëse ndërkombëtare në rrjetin e AMC-së. Duke filluar nga data 01.01.2015, tarifa e re e AMC për të gjitha thirrjet hyrëse ndërkombëtare nga Nisatel drejt rrjetit AMC Mobile do të jete 29.4 leke/minutë. Sipas Nisatel ky njoftim është selektiv pasi AMC aplikon tarifë tjetër për operatorët e tjerë alternativë me të cilët ka marrëveshje interkoneksioni.

Lidhur me këtë ankesë, Autoriteti i Konkurrencës realizoi seanca dëgjimore me palët si dhe me bordin vendimmarrës së AKEP-it, dhe konstatoi se palët ishin në proces negociatash, prandaj arritëm në përfundimin se nuk ishte nevojshme ndërhyrja e Autoritetit të Konkurrencës.

5. *Ankesa e ndërmarrjes “Plus Communication” sh.a* për revokimin e Vendimit të AKEP Nr.2614, datë 10.09.2015. Nga vlerësimi i ankesës, rezultoi se: lidhur me përdorimin e spektrit të frekuencave, organi kompetent i ngarkuar nga Ligji “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, (i ndryshuar), është AKEP-i, i cili jep autorizimet e përdorimit të spektrit të frekuencave dhe monitoron përdorimin e tyre. Lidhur me rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike në tregun e teknologjisë me bazë të gjerë “3G”, Komisioni i Konkurrencës është shprehur me Vendimin nr.161, datë 02.12.2010 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike në tregun e teknologjisë me bazë të gjerë 3G”, duke kërkuar hapjen e tregut.

#### *Ankesa jashtë objektit të Ligjit:*

6. *Ankesa e ndërmarrjes “Vodafone Albania” sh.a* lidhur me përdorimin e spektrit për shërbime 3G nga ndërmarrja “PLUS” SHA. Nga vlerësimi ligjor i ankesës, rezultoi se: institucioni përgjegjës për dhënien e autorizimeve të përdorimit të spektrit të frekuencave dhe monitorimin e tyre është AKEP-i, ndaj për këtë arsye, me shkresën Nr. 248/1, datë 27.05.2015, Autoriteti i Konkurrencës i është drejtuar AKEP-it, si organi kompetent për ti dhënë përgjigje pyetjeve dhe shqetësimeve të ngritura nga ndërmarrja Vodafon Albania. Në vijim të procesit regulatori ka argumentuar bazën ligjore mbi të cilën është autorizuar.

7. *Ankesat e ndërmarrjes “Albtelecom” sh.a, kundër ndërmarrjeve “AMC” sh.a dhe “Vodafone Albania” sh.a,*

8. *Ankesat e ndërmarrjeve “Albtelecom” sh.a dhe “AMC” sh.a, kundër ndërmarrjes “Vodafone Albania” sh.a*

9. *Ankesa e ndërmarrjes “Plus Communication” sh.a kundër ndërmarrjeve “Telekom Albania” sh.a dhe “Vodafone Albania” sh.a.*

Të tre ankesat lidhen me fillimin e ofrimit të shërbimit 4G nga këto ndërmarrje. Referuar vlerësimin të kryer është konstatuar se lidhur me përdorimin e spektrit të frekuencave është AKEP-i organi kompetent i ngarkuar nga Ligji specifik, të cilit i janë drejtuar të gjitha ankesat për procedim administrativ.

10. *Ankesa e ndërmarrjes “Albtelecom” sh.a. kundër AMC sh.a.* për hedhjen në treg të ofertave promovionale të ndërmarrjes në paketat mujore AMC Super Universal dhe AMC Universal. Nga vlerësimi rezultoi se ankesa e paraqitur nuk është në objektin e ligjit “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, pasi është organi rregullator, AKEP-i, i cili mbikëqyr zbatimin detyrimeve të vendosura me vendim të Këshillit Drejtues nga ana e operatorëve dhe në rast moszbatimi, merr masat e përcaktuara në Ligj.

11. *Ankesa e ndërmarrjes “Albtelecom” sh.a.* për konkurrencë të pandershme të ndërmarrjes “Albanian Mobile Communication” sh.a, nëpërmjet ndryshimit të emrit tregtar të shoqërisë tregtare në “Telekom Albania” sh.a dhe pasojat serioze shtrembëruese të konkurrencës që lindin në tregun e telefonisë në Shqipëri. Nga vlerësimi rezultoi se ankesa e paraqitur nuk është në objektin e Ligjit.

12. *Ankesa e ndërmarrjes “AMC” sh.a. dhe ankesa e ndërmarrjes “Albtelecom” sh.a.* lidhur me mundësinë e dhënies së 2 të drejtave të përdorimit të lira në brezin 2100 MHz shoqërisë Plus, duke parashikuar pagesë me këste nga ana e AKEP. Nga vlerësimi vërehet se nga ana e AKEP-it, po ndiqen procedurat e parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore lidhur me dhënien e të drejtave të përdorimit në brezat e frekuencave 1900-1980 MHz dhe 2110 – 2170 MHz, brezi-IMT. Në bazë të ankesës, shqetësimi i ndërmarrjes AMC sha është ngritur në bazë të të dhënave jo zyrtare dhe në një moment kur nga ana e organit rregullator (AKEP) janë marrë të gjitha opinionet e ndërmarrjeve të interesuara nëpërmjet procesit të konsultimit publik dhe nuk është marrë ende asnjë vendim mbi vazhdimin e procesit. Referuar sa më sipër, ankesa është jashtë objektit të Ligjit dhe se organi kompetent që jep të drejtat e përdorimit të spektrit të frekuencave është AKEP-i.

13. *Ankesa e një klienti të ndërmarrjes “Albtelecom” sh.a. kundër kësaj ndërmarrjeje,* lidhur me çmimin e paketës që ofrohet nga kjo ndërmarrje prej 690 Lekë. Nga vlerësimi, rezultoi se ankesa është jashtë objektit të Ligjit dhe sjellja e ndërmarrjes “Albtelecom” sh.a. mund të jetë një praktikë çorientuese, për të cilën, organi kompetent i ngarkuar nga Ligji Nr. 9902, datë 17.04.2008 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”, është Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve, të cilit iu adresuam për ankesën.

14. *Ankesa e ndërmarrjes “Telekom Albania” sh.a. kundërt ndërmarrjes “Albtelecom” sh.a.* lidhur me fillimin e ofrimit të shërbimit 4G nga kjo ndërmarrje në brezin 1800 MHz. Referuar vlerësimit të kryer rezultoi se ankesa është jashtë objektit të Ligjit dhe se organi kompetent që jep autorizimet e përdorimit të spektrit të frekuencave dhe monitoron përdorimin e tyre është AKEP-i, kurse organi kompetent lidhur me shqyrtimin e ankesave në lidhje me praktikën tregtare çorientuese është Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve.

15. *Ndërmarrja “Plus Communication” sh.a. ka dërguar për dijeni, vlerësim dhe konsiderim Ankimin Administrativ Nr. Prot. 359, date 26.03.2015 të shoqërisë Plus drejtuar Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP).* Nga vlerësimi i ankesës rezultoi se Autoriteti i Konkurrencës është shprehur disa herë dhe i ka kërkuar AKEP-it zbatimin sa më të shpejtë dhe hyrjen në fuqi të vendimeve të tij të dala në zbatim të analizës së tregut të telefonisë celulare. Aktualisht jemi në një procedurë ankimi administrativ dhe ashtu si është shprehur dhe Ministria e Inovacionit dhe Administratës Publike, organi kompetent i përcaktuar nga ligji për shqyrtimin e këtij ankimi administrativ dhe marrjen e një vendimi përfundimtar është AKEP-i.

#### *Ankesa në proces vlerësimi*

16. *Ankesat e ndërmarrjeve “Plus Communication” sh.a. si dhe “Albtelecom” sh.a kundërt ndërmarrjes “Vodafone Albania” sh.a.* lidhur me paketat tarifore MyClub 300 dhe ClubEntry 300. Ankimesit kërkon marrjen e masave të menjëhershme për ndërprerjen e ofrimit të nga ndërmarrja Vodafone dhe fillimin e procedimit administrativ ndaj Vodafone për këto oferta. Në vazhdim të procedurës janë realizuar seancat dëgjimore me ankimesit si dhe është kërkuar vlerësimi paraprak i AKEP-it, nëse ofertat e ndërmarrjes Vodafone janë në përputhje me Vendimin e AKEP-it Nr. 2523, datë 06.11.2014 “Për Përcaktimin e sipërmarrësit Vodafone Albania Sh.a., si FNT për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Vodafone dhe vendosjen e masave rregulluese”, të ndryshuar me Vendimin Nr. 2542, datë 13.03. 2015. Pas

marrjes së mendimit paraprak të AKEP-it do të vazhdohet me vlerësimin e plotë të ankesave.

17. *Ankesa e ndërmarrjes “Plus Communication” sh.a.* për marrjen e masave të menjëhershme për lënien në fuqi të tarifës aktuale asimetrike të interkoneksionit të PLUS me operatorët e tjerë edhe pas datës 01.01.2016. Lidhur me sa më sipër, fillimisht nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës janë organizuar seanca dëgjimore me përfaqësues të ndërmarrjeve PLUS, Vodafone dhe AKEP. Aktualisht AKEP është duke monitoruar tregun dhe do të shprehet më një vendim përfundimtar për të cilin do të njoftojë Autoritetin e Konkurrencës.

18. *Ankesa e ndërmarrjes “Telekom Albania” sh.a. kundër ndërmarrjes “Albtelecom” sh.a.* mbi ofertën të quajtur “Paketat festive” të hedhur në treg. Lidhur me vlerësimin e kësaj anekese, kemi kërkuar organizimin e një seance dëgjimore me ndërmarrjen ankuese (Telekom), si dhe i kemi kërkuar AKEP-it dhënien e mendimit në lidhje me ankesën dhe nëse kjo ankesë është në përputhje me Vendimin e AKEP-it Nr. 2526, datë 06.11.2014 Për “Përcaktimin e sipërmarrësit Albtelecom Sh.a., me Fuqi të Ndjeshme në Treg për terminimin e thirrjeve në rrjetin publik telefonik të lëvizshëm Albtelecom dhe vendosjen e masave rregulluese”, të ndryshuar me Vendimin Nr. 2542, datë 13.03.2015 Për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimet e Këshillit Drejtues të AKEP me Nr. 2522, 2523, 2524, 2525 dhe 2526, datë 06.11.2014”. Pas realizimit të seancës dëgjimore dhe të marrjes së vlerësimit të AKEP-it në lidhje me ankesën do të vijojmë me shqyrtimin dhe vlerësimin përfundimtar të Ankesës.

#### *Ankesa për revokim të Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës*

19. Kërkesë e ndërmarrjes “Vodafone Albania” sh.a. për revokimin në shpalljen e Pavlefshmërisë Absolute të Vendimit Nr. 356, datë 31.03.2015 të Komisionit të Konkurrencës "Për marrjen e masave të përkohshme ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë". Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjes “Vodafone” dhe i këndvështimeve të dhëna nga kjo ndërmarrje në seancën dëgjimore të datës 08.04.2015 për vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 356, datë 31.03.2015, rezultoi se: a) Ndërmarrja Vodafone nuk ka paraqitur asnjë fakt apo provë të cilat kanë shërbyer si bazë për dhënien e këtij vendimi të Komisionit të Konkurrencës e cila pas njoftimit të këtij vendimi të ketë ndryshuar; b) Ndërmarrja Vodafone nuk ka paraqitur asnjë pretendim se të dhënat e administruara nga Autoriteti i Konkurrencës gjatë procedurave hetimore dhe para marrjes së këtij vendimi janë jo të sakta apo të mara nëpërmjet mashtrimit.

Meqenëse nuk plotësohej asnjë nga kriteret e parashikuara në nenin 46 të Ligjit , nuk u pranua kërkesa për revokimin dhe shpalljen e pavlefshmërisë absolute të Vendimit nr. 356, datë 31.03.2015 të Komisionit të Konkurrencës "Për marrjen e masave të përkohshme ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SHA në tregun e telefonisë celulare me pakicë".

#### *II.1.2 Tregu i mediave audiovizuale*

Në tregun e mediave audiovizuale janë paraqitur 3 ankesa nga të cilat: për 1 ankesë ka filluar procesi i monitorimit; për 1 ankesë u realizua vlerësimi ligjor; dhe 1 ankesë rezultoi jashtë objektivit të ligjit. Më konkretisht:



20. *Ankesa e ndërmarrjes “Abcom” sh.p.k. kundër ndërmarrjes “Digitalb” sh.a.* mbi disa shqetësime në tregun e mediave audiovizuale. Për njohjen e plotë të problematikave në këtë treg shumë të rëndësishëm për pluralizimin e mediave është ngritur një grup punë për monitorimin e këtij tregu, i cili është në proces.

21. *Ankesa e ndërmarrjes “Tring” sh.a. kundër televizioneve kombëtare Top Channel dhe Klan TV, si dhe platformës Digitalb,* mbi refuzimin e trasmetimit të reklamës së tij. Bazuar në ankësën u realizua seanca dëgjimore në datën 27.10.2015 me ankimuesin për të identifikuar evidencat që disponoheshin për të vërtetuar pretendimin e tij lidhur me mos trasmetimet e reklamave në televizionet e tjera. Ankimuesit ju kërkua që të plotësojë “Formularin Tip” të ankesës me pretendimet për kufizimet ose shkeljet e mundshme të konkurrencës, përshkrimin e fakteve të cilave ju referohet: si arsyet e refuzimit, listë çmimesh për reklamat edhe të televizioneve të tjera, kontrata me televizionet e tjera etj. Ndërmarrja Tring, me anë të shkresës së saj Nr. 471 Prot., datë 09.11.2015 ka sjellë informacion shtesë në lidhje me pretendimet e saj. Nga vlerësimi rezultoi se marrëdhëniet në këtë treg midis ndërmarrjes Digitalb dhe operatorve të tjerë bazohet në një marrëveshje e cila ishte përjashtuar nga Komisioni i Konkurrencës<sup>1</sup> bazuar në një proces transparent dhe duke marrë mendimin e të gjithë lojtarëve të tregut, marrëveshje e cila përfundonte në 31.12.2015. Për këtë arsye u konkludua se tregu duhet të monitorohet për të identifikuar sjelljen e operatorit me fuqi tregu.

22. *Ankesa e TV Kabllor Udënishti lidhur me biznesin e tij dhe kontrollet, shkresat paralajmëruese dhe gjokat e rënda nga ana e Autoritetit të Mediave Audiovizuale.* Nga vlerësimi i ankesës rezultoi se kjo ankesë ishte jashtë objektivit të këtij Ligji.

### II.1.3 Tregu i energjisë elektrike

Në tregun e energjisë elektrike janë paraqitur 3 ankesa nga të cilat: 2 ankesa kanë rezultuar me vlerësim ligjor dhe rekomandime; 1 është për revokim VKK.

23. *Ankesa e ndërmarrjes “Fix Pro” Sh.p.k. kundër ndërmarrjes “Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” (OSHEE),* lidhur me faturimin gabim nga ana e kësaj ndërmarrjeje si klient që furnizohet nga tensioni i ulët (pika e matjes), ndërkohë që faktikisht furnizohet nga tensioni i mesëm, pasi kabina elektrike është investim i tij. Në vazhdim të procedurës për shqyrtimin e ankesës së mësipërme, nga ana e Autoritetit të Konkurrencës u kërkua informacioni mëtejshëm nga OSHEE dhe ERE si dhe u zhvilluan seanca dëgjimore me ankimuesin, ERE dhe OSHEE. Në përfundim Komisioni i Konkurrencës u shpreh me Vendimin Nr. 385, datë 3.12.2015 për “Disa rekomandime për ERE mbi zgjidhjen e problematikës së faturimit për klientët e lidhur në tensionin e mesëm dhe faturohen në tensionin e ulët”, vendosi t’i rekomandojë ERE-s: zgjidhjen përfundimtare për klientët e lidhur në Tension të Mesëm duke miratuar një tarifë të posaçme sipas kategorisë së klientëve, me qëllim vendosjen në kushte jo diskriminuese dhe të njëjta konkurrence; Vlerësimin e tarifës së zbatuar nga OSHEE nëse përbën një tarifë mbi tarifën e miratuar dhe kompensimin përkatës të klientëve në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi.

24. *Ankesa e Shoqatës së Furnizuesve të Energjisë Elektrike, në lidhje me marrëveshjen për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sha dhe*

<sup>1</sup> Procesi i vlerësimit për përjashtimin e marrëveshjes është paraqitur në Raportin e aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2014.

OSHEE, aprovuar nga ERE me vendimin Nr. 12, datë 06.02.2015. Në përfundim të procesit të vlerësimit Komisioni i Konkurrencës u shpreh për përjashtimin e marrëveshjes si marrëveshje të ndaluar. Në mënyrë më të detajuar gjithë procedura paraqitet në seksionin II.4 .

25. *Ankesa e ndërmarrjes “GEN-I Tirana” sh.p.k. për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 355, datë 20.03.2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”.* Pas vlerësimit të ankesës, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 363, datë 14.05.2015 “Mbi refuzimin e kërkesës së ndërmarrjes “GEN-I Tirana” shpk për revokimin e Vendimit Nr. 355, datë 20.03.2015 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”, vendosi refuzimin e kërkesës së ndërmarrjes GEN-I Tirana.

#### II.1.4 Tregu i prokurimeve publike

Në tregun e prokurimeve publike janë paraqitur 4 ankesa nga të cilat: në 1 rast ka filluar procedura hetimore; 1 me monitorim tregu; 1 me vlerësim ligjor; dhe 1 rast është jashtë objektit.

26. *Ankesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve*, lidhur me procedurën e prokurimit të zhvilluar me objekt “Ruajtje objektesh ku është akomoduar administrata tatimore” e ndarë në 13 lote, ku është konstatuar se gjatë hapjes së ofertave të operatorëve ekonomikë dhe veçanërisht në lotin e Tiranës 6 (gjashtë) prej operatorëve ekonomikë ofertues, kanë paraqitur një ofertë ekonomike me vlerë të barabartë. Komisioni i Konkurrencës është shprehur për hapjen e procedurës hetimore, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës, për periudhën objekt hetimi. Trajtimi më i detajuar është paraqitur në seksionin II.3.6 .

27. *Ankesa e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve* lidhur me dy procedura prokurimi me objekt “Blerje Infrastruktura mbështetëse për sistemin e ri E-Taxation” dhe “Blerje pajisje elektronike për e-filing dhe D.I.S. ku disa operatorë ekonomikë nuk kanë paraqitur oferta ekonomike duke krijuar kushte që operatori fitues të mbetet i vetëm në konkurrim. Sipas DPT mosparaqitja e këtyre ofertave ekonomike, krijon dyshimin se midis këtyre operatorëve mund të ketë marrëveshje të ndaluara. Për vlerësimin e këtij tregu autoriteti ka filluar e monitorimit e këtij tregu, i cili është në proçes.

28. *Ankesa e ndërmarrjes “Trezhnjeva” kundër “Korporata Elektro-energjetike Shqiptare” sh.a.* lidhur me prokurimin publik me objekt: “Shërbim Privat i sigurisë Fizike të objekteve të KESH sh.a.”. Bazuar në informacionin e marrë nga autoriteti kontraktor rezulton se ankesa e ndërmarrjes Trezhnjeva dhe e ndërmarrjeve të tjera ankuese janë marrë në shqyrtim nga ky autoritet kontraktor duke vendosur pranimin e pjesëshëm të tyre, si dhe duke kryer modifikimet përkatëse në dokumentet e kësaj procedure prokurimi. Sikurse njofton KESH, ndërmarrja Trezhnjeva rezulton si ofertues në të katër lotet në konkurrim.

29. *Ankesa e ndërmarrjes “Intersig” sh.a. kundër Ministrisë së Mbrojtjes* lidhur me prokurimit publik me objekt: “Sigurimi i mjeteve ajrore (helikopterë) në kompletim të Forcave të Armatosura”. Në përgjigje të kërkesës së Autoritetit të Konkurrencës, autoriteti kontraktor ka sqaruar se ankesa është marrë në trajtim dhe i është drejtuar



Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit.

#### II.1.5 Tregu i shërbimit të transportit ndërkombëtar detar

30. *Ankesa e ndërmarrjes “Gerveri” Sh.p.k kundër ndërmarrjes “Porti Vlorë” sh.a* Ndërmarrja Gerveri ankohet se Porti Vlorë sh.a. kërkon të prishë në mënyrë të njëanshme kontratën ekzistuese midis tyre dhe grafikun e udhëtimit të tragetit të kësaj ndërmarrjeje në Linjën Vlorë - Brindisi, duke vendosur një grafik të ri, i cili e detyron tragetin të udhëtojë një ditë po dhe një ditë jo. Sipas ankuesit kjo bëhet për të hapur rrugën e futjes së një tragei të ri në këtë linjë, duke i dhënë këtij të fundit automatikisht 50% të tregut. Pas vlerësimit të ankesës dhe realizimit të seancave dëgjimore me ankimuesin, Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës (Porti Vlorë nuk u paraqit në seancë dëgjimore), Komisioni i Konkurrencës u shpreh me Vendimin Nr. 369, datë 02.07.2015 “Për disa masa detyruese në tregun e shërbimit të transportit ndërkombëtar detar në Portin e Vlorës”, vendosi: Ndalimin e ndarjes së tregut të shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve nga ndërmarrja “Porti Vlorë” SHA; Detyrimin e ndërmarrjes “Porti Vlorë” SHA të zbatojë dhe lejojë operimin në kushte të barabarta, të të gjithë operatorëve që operojnë në terminalin e Portit të Vlorës, duke i vendosur ato në gjendje të favorshme konkurrence, për shërbimin e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve, duke u mundësuar konkurrimin midis tyre brenda së njëjtës ditë.

#### II.1.6 Tregje të tjera

Ankesa në tregje të tjera nga të cilat rezultojnë: 2 raste ka filluar procedura hetimore; 1 rast me vlerësim ligjor; 2 ankesa jashtë objektit të ligjit; dhe 1 me revokim VKK.

31. *Ankesa e shoqërisë “Geci” Sh.p.k*, në lidhje me shqetësimin mbi disa “çmime të ngurtësuar dhe të fiksuara të shërbimeve të hotelerisë, si dhe mbi disa praktika të bashkërenduara në caktimin e tyre dhe ndarjen e tregjeve të këtyre shërbimeve. Bazuar në formularin e ankesës dhe vlerësimin e realizuar Komisioni i Konkurrencës, miratojë hapjen e hetimit në këtë treg, për të parë nëse ka, ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës për periudhën objekt hetimi, e cila përfundoi me rekomandime. Trajtimi më i detajuar i rastit paraqitet në seksionin II.3.4 .

32. *Ankesa e ndërmarrjes “Intesa SanPaolo Bank”* mbi qëndrimin e kundërligjshëm të mbajtur nga disa zyra vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, drejtuar Zyrës Qendrore të Pasurive të Paluajtshme. Nga vlerësimi ligjor i ankesës, rezultoi se procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, regjistrimi i hipotekës dhe radha e regjistrimit të tyre, rregullohen sipas dispozitave përkatëse të Kodit Civil dhe Ligjit “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Duke qenë se nga ana e Autoritetit të Konkurrencës është hapur një hetim i përgjithshëm në sektorin bankar, në formën e një studimi tregu, është propozuar që ky shqetësim i ngritur nga “Intesa Sanpaolo Bank Albania” të merret në konsideratë gjatë realizimit të këtij hetimi.

33. *Ankesa e ndërmarrjes “Infood”* lidhur me marrëveshjen e ekskluzivitetit të lidhur nga Shoqëria “All Balkans Corporation” sh.a. për ekskluzivitetin e distribucionit në Shqipëri të produktit Yougurt (kos frutash) të markës Campina. Nga vlerësimi i marrëveshjes objekt ankese u konstatua se ndërmarrja “All Balkans Corporatin” sh.a. ka një marrëveshje distribucioni me ndërmarrjen “Freisland Campina Hellas” me seli ne Greqi, për tregtimin e produktit yougurt kos frutash, dhe nga vlerësimi i dispozitave të

marrëveshjes së mësipërme nuk rezulton që ato të bien në kundërshtim me nenin 4 të Ligjit .

34. *Ankesa e “Shoqatës së Mbrojtjes së Tregtarëve dhe Tregut” kundër “EKMA Albania” Sh.p.k.* lidhur me efektet anti-konkurrese të veprimeve të ndërmarrjes. Bazuar në të dhënat e administruara gjatë monitorimit, informacionit të sjellë nga ana e Shoqatës së Mbrojtjes së Tregtarëve dhe Tregut si edhe vendimeve të marra nga ana e Prefektit të Qarkut Tiranë dhe institucioneve të tjera të ngarkuar me ligj për kontrollet e veprimtarisë së tregjeve, konstatohet se janë këto institucione të ngarkuara me ligj për mbikëqyrjen, rregullimin dhe liçensimin e tregjeve në Republikën e Shqipërisë. Pas realizimit të seancës dëgjimore Komisioni i Konkurrencës konkludoi se kjo problematikë nuk është objekt i Ligjit, por për të mundësuar rritjen e konkurrencës për ofrimin e shërbimit të tregëtimit iu rekomandua Bashkisë së Tiranës të mundësoj funksionimin e tregjeve alternative.

35. *Ankesa e ndërmarrjes “Lunxhëria”sh.p.k.* në lidhje me cilësinë dhe standardet e shitjes së produktit “trahana”. Nga vlerësimi i ankesës rezultoi se problematika që ngre subjekti “Lunxhëria” nuk hyn në objektin e veprimtarisë të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe nuk përbëjnë objekt shqyrtimi nga ana e tij.

36. *Kërkesë e ndërmarrjes “SICPA”* për revokim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 337, datë 11.11.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”. Nga vlerësimi i kërkesës së ndërmarrjes “SICPA” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës dhe i argumenteve të dhëna nga kjo ndërmarrje, konstatohet se nuk ndodhemi para kushteve për revokimin e vendimit. Për këtë arsye, Komisioni i Konkurrencës vendosi rrezimin e kërkesës së ndërmarrjes “SICPA” dhe lënien në fuqi të vendimit të Komisionit.

## **II.2. Hetim i përgjithshëm në sektorin bankar**

Shqetësimet e ngritura në media rreth tregut bankar dhe aplikimit të normave të larta të interesit të kredive kundrejt normave shumë të ulta të interesit të depozitave nga bankat e nivelit të dytë, u bë nxitje që Autoriteti i Konkurrencës të fillojë monitorimin e tregut të shërbimeve bankare ku objekti i monitorimit ishte vlerësimi i tregut të kredive (overdraft dhe kredi konsumatore), normat e interesave (çmimeve) të produkteve përkatëse dhe krahasimi me depozitat, yield-in dhe normën bazë të interesit.

Metodologjia e përdorur u bazua në disa studime të publikuara nga Banka e Shqipërisë si dhe në bazë të literaturave të ndryshme për sektorin bankar në vendet e rajonit dhe MLEX.

Në përfundim të analizës së treguesve të sistemit bankar në tërësi dhe e sjelljes së bankave të nivelit të dytë në tregun përkatës, overdraft dhe kredi konsumatore, u konstatua se tregu bankar paraqitet mesatarisht i përqendruar, ku asnjë nga bankat e nivelit të dytë nuk ka pozitë të ndjeshme në treg. Bankat aplikojnë norma të ndryshme për tre produktet bankare të analizuar. Spread-i midis interesave të kredive me depozitat dhe i interesave të overdraft-it me depozitat për gjithë sektorin bankar është shumë i lartë. Krahasuar me 8 vendet e rajonit në lidhje me spread-in e interesave të kredive me depozitat, Shqipëria radhitet e katërta duke lënë pas vendet si Mal i Zi, Kosova, Serbia dhe Bullgaria (për vitet 2011-2013), të cilat kanë spread-in me të vogël midis interesave të kredisë dhe depozitave.

Gjatë viteve të fundit, Autoriteti i Konkurrencës ka monitoruar dhe ka dhënë disa rekomandime në lidhje me mirëfunksionimin e tregut bankar në Shqipëri. Bazuar në problematikat e konstatuara gjatë këtyre monitorimeve, Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 41 (pika1) të Ligjit u shpreh në Vendimin nr. 373 datë 16.09.2015 për hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar.

Në thelb procesi është një studim i përgjithshëm i tregut, por në kuptim të Ligjit studimi i përgjithshëm i tregut njihet si hetim i përgjithshëm në sektor. Ky studim synon të vlerësojë nivelin e konkurrencës në sektorin bankar, identifikimin e problemeve që mund të sjellin kufizim të konkurrencës dhe dhënia e rekomandimeve, nëse është e nevojshme, për përmirësimin e mjedisit konkurrues në këtë treg jetik për ekonominë shqipëtare.

Metodologjia do të bazohet në praktikat më të mira europiane si dhe do të ketë asistencën e një eksperti për sektorin bankar. Analiza e konkurrencës do të vlerësojë zëvendësueshmërinë e produkteve bankare (depozita, kredi, overdraft etj) me produktet e subjekteve jo banka, shoqëritë e kursim kreditit dhe unioneve të tyre, të cilat ofrojnë produkte të ngjashme. Gjithashtu, studimi i përgjithshëm në tregun bankar do të vlerësojë sjelljen e bankave të nivelit të dytë në lidhje me komisionet, normat e interesit të aplikuara, për produkte të ndryshme si hapje llogarie, depozitë, kredi, transfertat bankare, etj., dhe krahasimi mes tyre, si dhe aspektet e sigurimit të kredive.

## **II.3. Marrëveshjet e ndaluara**

Gjatë veprimtarisë së tyre ndërmarrjet publike ose private mund të realizojnë marrëveshje mes tyre, të shkruara ose jo, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Por, ndërmarrjet duhet të kenë parasysh se ka disa marrëveshje apo sjellje të bashkërenduara të cilat janë të ndaluara nga Ligji "Për mbrojtjen e konkurrencës", (i ndryshuar), prandaj këto marrëveshje duhet të njoftohen pranë Autoritetit të

Konkurrencës dhe të vlerësohen nga Komisioni i Konkurrencës mbi efektet që sjellin ato në treg.

Ligji i konkurrencës ndalon të gjitha ato marrëveshje të cilat kanë si objekt ose si pasojë pengimin, kufizimin e shtrehtësimit e konkurrencës në treg. Në mënyrë të veçantë ndalohen marrëveshjet që (i) caktojnë, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, çmimet e blerjes ose të shitjes, apo çdo kusht tjetër tregtimi, (ii) kufizojnë ose kontrollojnë prodhimin, tregjet, zhvillimin teknik ose investimet;(iii) ndajnë tregjet ose burimet e furnizimit etj.

Ndërmarrjet duhet të kenë parasysh të mos përfshihen në marrëveshje të ndaluara, në formë të shkruar ose jo, sepse Ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” parashikon gjoba të rënda deri në 10 % të xhiros, por gjithashtu ofron edhe instrumentin e lehtësimit të pjesëmëm ose të plotë nga gjobat në rastet e bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës. Ky instrument synon të nxisë ndërmarrjet e përfshira në marrëveshje në shkelje të ligjit, të bashkëpunojnë me Autoritetin për t’i zbuluar ato kundrejt lehtësimit nga gjoba.

### II.3.1 Hetim në tregun e prokurimeve “Ndërtimit të pjesës së jashtme të Unazës së madhe të Tiranës, aksi V-L, Sauk – Bregu i lumit”.

Sikurse është raportuar për veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2014, Komisioni me anë të Vendimit nr. 333 datë 21.10.2014, u shpreh për hapjen e hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “ Ndërtimi i rrugës së unazës së jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit), Loti 1, Loti 2 dhe Loti 3” për periudhën e hetimit janar – dhjetor 2013.

Gjatë procedurave të hetimit paraprak nuk u gjetën evidenca direkte të bashkëpunimit midis ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedurat e tenderimit, por u evidentuan se oferatat ishin shumë afër me fondin limit. Në kushtet e dyshimit, Komisioni i Konkurrencës vendosi me anë të Vendimit nr. 346, datë 16.02.2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “ Ndërtimi i rrugës së unazës së jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit), Loti 1, Loti 2 dhe Loti 3” ndaj ndërmarrjeve: “Gener 2”, “Albavia”, “Gjoka Konstruksion”, bashkimit të Albavia, Favina dhe Alpin SRL dhe bashkimit të përkohshëm të “Gjoka Konstruksion dhe Gjiguria”, duke shtrirë periudhën objekt hetimi edhe për vitin 2014.

Gjatë procedurës hetimore u realizuan inspektimet në terren dhe u analizua dokumentacioni i paraqitur për të vlerësuar nëse kompanitë, për kryerjen e punimeve sipas kontratave, janë bazuar në kapacitetet teknike të veta apo kanë nënkontraktuar kompani për punime të ndryshme. Në përfundim të procesit rezultoi se bazuar në dokumentacionet faktike nuk kanë kompani nënkontraktuese.

Proçesi i hartimit, harmonizimit dhe bashkëveprimit të procedurave të prokurimit publik mes autoritetit kontraktor dhe ndërmarrjeve pjesëmarrëse në procedura është kombinim i shumë faktorëve, të cilat jo të gjitha janë objekt dhe mund të trajtohen nga ligji i konkurrencës si dhe Autoriteti i Konkurrencës.

Proçesi i prokurimeve publike mund të ketë patur si pasojë deformime në formën e konkurrencës së padrejtë, e cila mund të shkaktohet edhe nga sjelljet njerëzore që tejkalon parashikimet e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Kështu, nga verifikimet e Autoritetit të Konkurrencës për lotin e tretë konstatojmë që ARRSH nuk ka kërkuar

dokumentacionin ekonomik dhe financiar për të dy operatorët e bashkimit Gjoka shpk & Gjiguria shpk, si dhe mungon informacioni në lidhje me xhiron e tre viteve të fundit për Gjiguria shpk, si edhe pasqyrat financiare të viti 2009 për Gjiguria shpk megjithëse janë nënshkruar kontratat nga ARRSH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe inspektimet e kryera gjatë procedurave të hetimit paraprak në mënyrë të njëkohshme dhe të befasishme të gjitha ndërmarrjet nën hetim si dhe nga verifikimet në terren në procedurën e hetimit të thelluar nuk gjenden elementë të cilët vërtetojnë marrëveshjen ndërmjet kompanive fituese dhe konkurrese, por është sjellja e autoritetit kontraktor ajo që e ka bërë procesin dyshues për manipulime të mundshme të procedurave të prokurimit, dyshime për të cilat ka nisur procedimi nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për sa më sipër, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 358, datë 16.04.2015, vendosi mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtimi i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (Segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3” ndaj ndërmarrjeve: “Gener 2” Sh.p.k; “Albavia” Sh.p.k; “Gjoka Konstruksion” SH.A; bashkimit të shoqërive Albavia, Favina dhe Alpin Srl (JV) si dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Gjoka Konstruksion&Gjiguria” dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive “Albavia&Favina&Alpin Srl (JV)”.

Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës, vendosi t’i rekomandojë Autoritetit Rrugor Shqiptar që : (a) ndarja e loteve të mos krijojë mundësi për ndarje tregu sipas vëllimit të punimeve ndërmjet konkurrentëve dhe ndarje tregu gjeografik; (b) kryerjen e vlerësimit të plotë të kriterëve ekonomike dhe financiare për të gjithë pjesëmarrësit apo bashkimet e kompanive pjesëmarrëse me qëllim që të sigurohet trajtim i barabartë dhe jo diskriminues ndërmjet pjesëmarrësve në procedura; (c) të shmangë format e paradhënies dhe vlerësimit preferencial ndaj ndërmarrjeve të ndryshme të cilat kufizojnë konkurrencën.

### II.3.2 Hetim në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të cigareve të fabrikuar.

Tregu i importit dhe shitjes me shumicë të cigareve të fabrikuar ka qënë në proces hetimi, nisur që në muajin nëntor të vitit 2014. Në vijim të procedurave hetimore dhe nga analiza ekonomike e të dhënave të grumbulluara u konstatua se pesë ndërmarrjet e importimit dhe shitjes me shumicë të cigareve, nuk kanë patur sjellje të njëjtë për përcaktimin e çmimeve në treg. Rritja e çmimeve nga këto ndërmarrje ka reflektuar rritjen e barrës fiskale që ka ndodhur në fund të muajit Tetor 2014 dhe kjo rritje është realizuar në periudha të ndryshme kohore nga ndërmarrje të ndryshme, prandaj nuk mund të vlerësohen si çmime paralele dhe si të tilla nuk përbëjnë evidenca ekonomike që mund të përdoren për të provuar një praktikë të bashkërenduar me evidenca indirekte.

Si rrjedhojë, Komisioni i Konkurrencës vendosi mbylljen e procedurës së hetimit paraprak me Vendimin nr.353 , datë 05.03.2015, pasi nuk u konstatuan shkelje të nenit 4 të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2013 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, (i ndryshuar).

### II.3.3 Hetim në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve.

Gjatë periudhës nëntor-dhjetor të vit 2014 u vu re një rritje të çmimit të vezëve në treg. Bazuar në gjetjet e monitorimit të tregut të prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve, me propozim të Sekretariatit, Komisioni i Konkurrencës vendosi për hapjen e hetimit paraprak në këtë treg me Vendimin nr. 344, datë 02.02.2015 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve”, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës.

Për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve objekt hetimi u realizuan inspektime të befashisme (daën raids) në ndërmarrjet kryesore që operojnë në këtë treg. Duke qenë se gjatë inspektimeve nuk u gjetën evidenca direkte mes konkurrenteve, janë kryer analizat ekonomike me qëllim evidentimin e ndonjë sjelljeje të bashkërenduar mes konkurrenteve për fiksimin direkt apo indirekt të çmimit të shitjes së produktit.

Nga analiza e çmimeve mesatare mujore të aplikuara nga ndërmarrjet për secilën kategori produkti, u vu re se këto ndërmarrje aplikojnë çmime të ndryshme dhe ritmi i ndryshimit të tyre është i ndryshëm, duke mos vërejtur shenja të caktimit të çmimeve apo koordinimit të tyre në ritmin e rritjes apo të zbritjes. Gjithashtu nga analiza e çmimeve mesatare ditore të ndërmarrjeve më të mëdha për periudhën Nëntor – Dhjetor 2014, u vu re se ritmet e rritjes dhe ndryshimit të çmimit nuk kanë trende të njëjta si dhe çmimi i aplikuar nga ndërmarrjet për të njëjtën kategori produkti është i ndryshëm për periudha të njëjta.

Nga kjo analizë u konkludua se nuk kishte asnjë sjellje të koordinuar të ndërmarrjeve në lidhje me caktimin e çmimit dhe rritja e çmimit të produktit vezë kishte ardhur si pasojë e mungesës së ofertës në treg të këtij produkti.

Si konkluzion, nga inspektimet nuk rezultuan shenja të bashkëpunimit mes ndërmarrjeve nën hetim si dhe nga analiza e sjelljes së ndërmarrjeve dhe analizat ekonomike të çmimeve dhe ofertës nuk rezultoi kufizim i mundshëm i konkurrencës sipas parashikimeve të nenit 4 të Ligjit. Për këtë arsye, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr 362, datë 14.05.2015 vendosi mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve, pasi në përfundim të kësaj procedure hetimore nuk u konstatuan shenja të kufizimit të konkurrencës në këtë treg për periudhën nën hetim.

### II.3.4 Hetim në tregun e shërbimeve të hotelerisë.

Bazuar në ankesën e shoqërisë Geci Sh.p.k, sipas së cilës disa hotele në Tiranë, Sarandë etj, kanë kryer shkelje të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), duke përdorur pranë emrit të tyre emrin “Tirana Hotel”, gjithashtu pretendohet se këto hotele ofronin shërbime me çmime të ngurtësuar dhe të fiksuara, si dhe zbatonin praktika të bashkërenduara në caktimin e çmimeve dhe ndarjen e tregjeve të këtyre shërbimeve, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të Ligjit u shpreh me Vendimin nr.361, datë 11.05.2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimeve të hotelerisë”, mbi mundësinë e ekzistencës (ose jo) të praktikave të bashkërenduara në përcaktimin dhe fiksimin e çmimit në këtë treg, për periudhën janar-dhjetor të vitit 2014. Për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve janë realizuar inspektime (daën raids) në ndërmarrjet objekt hetimi me qëllim gjetjen e evidencave direkte dhe indirekte të një marrëveshjeje të mundshme midis konkurrentëve për fiksimit të çmimeve të shërbimit të hotelerisë. Nëpërmjet metodave hetimore u kërkuan shenja në lidhje me shkëmbimin e informacioneve dhe statistikave mbi numrin e dhomave të lira, numrin e klientëve apo dhe çmimin e ditës për dhomat e mbetura ose shpërndarjen e klientëve



në hotelet në të njëjtën zonë gjeografike. Gjatë këtyre inspektimeve nuk u gjet asnjë provë apo evidencë direkte që të provojë një marrëveshje apo sjellje të bashkërenduar në kuptim të Ligjit.

Me qëllim evidentimin e ndonjë sjellje të bashkërenduar mes konkurrenteve për fiksimin direkt apo indirekt të çmimit të ofrimit të shërbimit në tregun e hotelierisë, janë kryer analizat ekonomike në lidhje me çmimin e ofrimit të shërbimit për të vlerësuar nëse ndërmarrjet e të njëjtës kategori kishin aplikuar çmime të njëjta të ofrimit të shërbimit gjatë periudhës objekt hetimi. Pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave të inspektimit të realizuara në ndërmarrjet nën hetim si dhe nga analiza ekonomike e të dhënave nuk u gjetën evidenca indirekte të bashkëpunimit midis ndërmarrjeve objekt hetimi.

Si përfundim, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 371, datë 04.09.2015 u shpreh për mbylljen e hetimit paraprak në tregun e shërbimeve të hotelierisë, pasi nuk kishte shenja të kufizimit të konkurrencës. Gjithashtu, vendosi t'i rekomandoje AKEP-it diversifikimin e domaineve të hoteleve për të mundësuar një informacion simetrik për klientët që bëjnë rezervimin online dhe për të shmangur mbivendosjet që shkaktohen nga ngjashmëritë e domain-eve.

### II.3.5 Hetim në tregun e prokurimit publik për përmirësimin, rifreskimin e sinjalistikës vertikale e horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore.

Nisur nga një shqetësim i adresuar nga media e shkruar për mungesën potenciale të konkurrencës në tregun e shërbimit të sinjalistikës rrugore, Autoriteti i Konkurrencës kërkoi informacion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar (ARSH), lidhur me procedurat e prokurimit të realizuara në datat 07.09.2015 dhe 09.09.2015 me objekt: "Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale e horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore – vazhdimi, Loti 1 dhe Loti 2".

Nga shqyrtimi i procedurave të prokurimit në të dy lotet është vënë re se ndërmarrjet të cilat kanë fituar këto procedura prokurimi me vlera ofertuese shumë afër fondit limit, nuk kanë konkuruar në të dyja lotet dhe mund të kenë përdorur skemën e rotacionit në ofertave duke ndarë tregun (duke përfitur pjesë përafërsisht të barabarta të fondit limit).

Bazuar në raportin e monitorimit, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me Vendimin nr. 376, datë 15.10.2015 për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt "Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale e horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore – vazhdimi", Loti 1 dhe Loti 2", për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës".

Në vijim të procedurave, Komisioni i Konkurrencës, bazuar në raportin e hetimit paraprak u shpreh me Vendimin nr.386, datë 14.12.2015 për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt "Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale e horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore", për të evidentuar faktorët që mund të kenë ndikuar në kufizimin potencial të konkurrencës.

Procedurat e hetimit të thelluar vazhdojnë dhe do të përfshijnë përveç procedurave të prokurimit për përmirësimin, rifreskimin i sinjalistikës vertikale e horizontale në akset

kombëtare dhe përmirësimin e sigurisë rrugore loti 1 dhe 2, edhe procedura të tjera të prokurimit në tregun objekt hetimi.

### II.3.6 Hetimi në tregun e prokurimit publik për ruajtje objektsh për vitin 2015.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (DPT) i adresoi Autoritetit të Konkurrencës problematikën e identifikuar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi procedurën e prokurimit të zhvilluar nga DPT me objekt “Ruajtje objektsh për vitin 2015”, e ndarë në 13 lote. Nga informacioni i disponuar është konstatuar se gjatë hapjes së ofertave të operatorëve ekonomikë dhe veçanërisht në lotin e Tiranës, 6 (gjashtë) prej operatorëve ekonomikë ofertues kanë paraqitur një ofertë ekonomike me vlerë të barabartë. Nga paraqitja e këtyre ofertave identike krijohet dyshimi se midis këtyre operatorëve mund të ketë marrëveshje të ndaluar, gjë e cila bie ndesh me Ligjin “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).

Komisioni i Konkurrencës u shpreh me Vendimin nr. 380, datë 02.11.2015, “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ruajtje objektsh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për të parë nëse ka ose jo shenja të kufizimit të konkurrencës.

Për vlerësimin e sjelljes së ndërmarrjeve u shqyrtuan të dhënat e administruara gjatë fazës së inspektimeve në ndërmarrje, dokumentacioni i paraqitur nga ndërmarrjet në procedurën e prokurimit, si dhe dokumentacioni i administruar nga autoriteti kontraktor, pasi gjatë inspektimeve të befasishme të realizuara në ndërmarrjet pjesëmarrëse në këtë procedurë prokurimi nuk u gjet asnjë evidencë direkte që të vërtetonte bashkëpunimin në përgatitjen e ofertave në procedurat e prokurimit publik.

Pas shqyrtimit të raportit të hetimit paraprak rezultoi se një faktor që mund të ketë ndikuar në ofertat identike është rekomandimi i dhënë nga Agjencia e Prokurimit Publik (APP) dhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) më datë 01.04.2015, mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për marrjen e shërbimit privat të ruajtjes fizike. Ky udhëzues ka përcaktuar vlerën minimale që duhet të kenë parasysh autoritet kontraktore gjatë procedurës së prokurimit publik të shërbimit privat të ruajtjes fizike. Vlera e ofertave të pjesëmarrësve në tender ishte pothuajse e njëjtë për të gjithë operatorët, identik me vlerën e përcaktuar nga APP dhe KPP.

Për këto arsye janë zhvilluar takime në nivel teknik me APP dhe KPP për të rekomanduar zgjidhjen e problematikës së prokurimit të shërbimit të ruajtjes dhe sigurisë fizike që përbën dhe tregun me numrin më të madh të ankesave për prokurimet publike.

## II.4. Përrjashtim nga ndalimi i marrëveshjeve - Marrëveshja për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE

Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 5 dhe 6 të Ligjit, shprehet për përrjashtimin nga ndalimi nëse një marrëveshje nuk është marrëveshje e ndaluar (sipas nenit 4 të Ligjit), kontribuon në përrmirësimin e prodhimit ose të shpërrndarjes së produkteve ose në nxitjen e progresit teknologjik apo ekonomik dhe kur një pjesë e këtyre përrfitimeve i kalojnë klientëve e konsumatorëve.

Autoriteti i Konkurrencës është bërë me dije mbi ekzistencën e një marrëveshje dypalëshe, lidhur ndërmjet KESH dhe OSHEE, nga ankesa e Shoqata Shqiptare e



Furnizuesve të Energjisë Elektrike drejtuar institucionit të konkurrencës. Sipas ankimesit marrëveshja e shit-blerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE, miratuar nga bordi i ERE-s me Vendimin nr 12, datë 06.02.2015, kufizon konkurrencën dhe pjesëmarrjen në tregtimin e energjisë elektrike të kompanive të licencuara nga Entit Rregullator i Energjisë (ERE) dhe duhej të konsiderohej si marrëveshje në kundërshtim me politikën e Qeverisë Shqiptare.

Me kërkesën e Autoritetit Entit Rregullator i Energjisë depozitoi "Marrëveshjen për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE, për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015" si dhe Vendimin nr 12, datë 06.02.2015 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për miratimin e kësaj marrëveshje. Gjithashtu, OSHEE SH.A dhe KESH SH.A, paraqitën pranë Autoritetit të Konkurrencës, Formularin e Plotësuar të Njoftimit të Marrëveshjes. Sipas kësaj marrëveshje OSHEE do të blejë energji elektrike për mbulimin e humbjeve nga KESH SHA, që është ndërmarrje publike, ndërsa ky i fundit do të shesë energjinë elektrike në rastet e prurjeve të mëdha me çmim burse HUPX. Palët argumentuan se transaksionet do të jenë në përfitim të interesit publik dhe efikasitetit.

Marrëveshja potencialisht mund të përbëjë kufizim të konkurrencës për ofruesit e tjerë të furnizimit me energji elektrike siç janë tregtarët, prodhuesit e pavaruar të energjisë dhe prodhuesit e vegjël të energjisë, të cilët hyjnë në procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes të kryera nga OSHEE. Por arsyet e përjashtimit nga ndalimi u vlerësuan si :

- 1) Marrëveshja kontribuon në sigurinë kombëtare dhe problemet sociale që lindin në rastet e shkarkimeve dhe përmytjet në zonat përkatëse.
- 2) Marrëveshja kontribuon në shfrytëzimin maksimal dhe optimizimin e prodhimit dhe të shitjes së energjisë elektrike nga KESH SH.A., si shoqëria përgjegjëse dhe administruese e kaskadës së lumit Drin dhe HEC- eve prodhuese të saj, në kushtet e tepricave apo prurjeve të mëdha, raste emergjencash, kur edhe shitja në tregun e eksportit është e pamundur si rrjedhojë e kapaciteteve të limituara të interkoneksionit.
- 3) Marrëveshja siguron ulje të kostove për konsumatorët tariforë, pasi garanton furnizimin pjesërisht të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes nga energjia elektrike e prodhuar nga KESH SH.A. në kushtet e tepricës dhe prurjeve të mëdha, pasi ka plotësuar kërkesën e OSHEE, me çmim më të ulët sesa çmimi i importit të energjisë elektrike, bazuar në evidencat dhe të dhënat historike që disponojmë.
- 4) Sjell përfitime esenciale për konsumatorët tariforë, duke patur parasysh që kostot e sigurimit nëpërmjet blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, përfshihen në tarifën e furnizimit me pakicë për konsumatorët tariforë.
- 5) Pra, kjo marrëveshje është në përfitim të interesit publik dhe efikasitetit së tregut, në rastin e prurjeve të mëdha.

Për arsyet e mësipërme Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 367, datë 04.06.2015 vendosi për "Përjashtimin nga ndalimi të marrëveshjes për shit - blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE, për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015".

## II.5. Abuzimi me pozitën dominuese

“Pozitë dominuese” është pozita e një ose më shumë ndërmarrjeve në treg, që i lejon ato të jenë të afta të veprojnë, për sa i takon ofertës ose kërkesës, në mënyrë të pavarur nga pjesëmarrësit e tjerë në treg, si konkurrentët, klientët ose konsumatorët.

Pozita dominuese e një ose më shumë ndërmarrjeve vlerësohet duke marrë parasysh: a) pjesën e tregut përkatës të ndërmarrjes ose ndërmarrjeve në shqyrtim dhe të konkurrentëve të tjerë; b) pengesat në hyrje në tregun përkatës; c) konkurrencën potenciale; ç) fuqinë ekonomike dhe financiare të ndërmarrjeve; d) varësinë ekonomike të furnizuesve dhe blerësve; dh) fuqinë kundërvepruese të blerësve; e) zhvillimin e rrjetit të shpërndarjes së ndërmarrjeve dhe mundësitë e shfrytëzimit të burimeve të produkteve; ë) lidhjet ekonomike me ndërmarrjet e tjera; f) karakteristika të tjera të tregut përkatës si: homogjenitetin e produkteve, transparencën e tregut, uniformitetin e kostos dhe të madhësisë së ndërmarrjeve, qëndrueshmërinë e kërkesës ose të kapaciteteve të lira prodhuese.

Ligji “Për mbrojtjen e konkurrencës” ndalon abuzimin me fuqinë e tregut. Mund të përbëjnë abuzim me pozitën dominuese: a) vendosja, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, e çmimeve të padrejta të blerjes ose shitjes, ose e kushteve të tjera të padrejta të tregtimit; b) kufizimi i prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik; c) zbatimi i kushteve të pabarabarta për veprime tregtare të njëjta me palët, duke i vendosur ato në gjendje të pafavorshme konkurrence; ç) lidhja e kontratave, me kusht që palët e tjera kontraktuese të pranojnë detyrime shtesë; d) vendosja e çmimeve ose e kushteve të tjera, që kanë si objekt ose si pasojë pengimin e hyrjes ose nxjerrjen jashtë tregut përkatës të konkurrentëve të veçantë a të një produkti të tyre; dh) refuzimi për të tregtuar ose për të dhënë licenca; e) refuzimi i hyrjes së një ndërmarrjeje tjetër, kundrejt një shpërblimi të përshtatshëm, në rrjetin ose në infrastrukturën e ndërmarrjes me pozitë dominuese, nëse ky refuzim i përdorimit të njëkohshëm të rrjetit ose të infrastrukturave pengon ndërmarrjen tjetër të veprojnë si konkurrent i ndërmarrjes me pozitë dominuese.

### II.5.1 Hetim në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve.

Një nga rastet hetimore të trashëguara nga viti 2014 ishte edhe procesi i hetimit të thelluar në tregun e importit, prodhimit dhe shitjes me shumicë të karburanteve” ndaj ndërmarrjeve që ushtronin veprimtari në këtë treg dhe konkretisht: “Kastrati” SH.A, “Kastpetrol SH.A, “Europetrol Durrës Albania” SH.A, “Portoromano Oil” SH.A, “Bolv Oil SH.A, “Genklaudis” SH.A, “Everest Oil” SH.A, “Taci Oil International & Supply” SH.A dhe “Armo” SH.A për kufizime të mundshme të konkurrencës në tregun përkatës.

Nga raporti i hetimit të thelluar rezultoi se gjatë periudhës objekt hetimi, nuk u gjetën evidenca që të provonin marrëveshje të ndaluara apo abuzim me dominancën kolektive midis ndërmarrjeve objekt hetimi.

Hetimi i realizuar nga Autoriteti i Konkurrencës në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve evidentoi faktin se ekzistojnë hallka të tepërta në strukturën e tregut që nuk justifikojnë vlerën e shtuar që nga importi, zonat e lira doganore, shitjet me shumicë, shitjet me pakicë, deri tek konsumatori duke shkaktuar rritjen artificiale të kostove dhe një elasticitet të çmimit mesatarisht të ulët . Shkalla e lartë e përqendrimit të tregut dhe tendencat për rritjen e këtij përqendrimi kryesisht në

tregun e importit, kërkon përmirësime strukturore të tregut dhe ndërthurjen e instrumenteve përtej atyre të Autoritetit të Konkurrencës, për të ndihmuar në kontrollin e abuzimit dhe ndalimin e ndërmarrjeve që kanë fuqi tregu të aplikojnë praktika abuzive duke dëmtuar konsumatorin fundor.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me Vendimin nr.345, datë 12.02.2015 për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve, si dhe vendosi t'i rekomandojë Qeverisë Shqiptare, Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes:

1) Të rishikojë Ligjin nr. 8450, datë 24.02.1996 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", duke i krijuar mundësi ndërmarrjeve që operojnë në tregun e shitjes me shumicë të eurodieselit dhe benzinës: (a) të realizojnë edhe shitjen me pakicë, duke eliminuar në këtë mënyrë hallkat e tepërta në zinxhirin e tregtimit, për të mundësuar uljen e kostove të pajustificuara ekonomike në krahasim me vlerën e shtuar të produktit; (b) të ruajnë identitetin e produktit dhe të konkurrojnë nëpërmjet logos respektive tek shitësit me pakicë, për të mundësuar nxitjen e konkurrencës efektive në këtë treg.

2) Të krijojë bazën ligjore dhe infrastrukturën administrative të nevojshme, për një njësi të transparencës së çmimit të hidrokarbureve, në të cilën ndërmarrjet që operojnë në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve duhet të njoftojnë në kohë reale brenda 5-15 minuta këtë njësi dhe Autoritetin e Konkurrencës për çdo ndryshim të çmimit të shitjes me shumicë.

3) Vlerësimin e zbatimit të marrëveshjes koncesionare në portin "Vlora 1" për respektimin e detyrimit të mos përfshirjes së koncensionarit në tregtimin e karburantit si dhe transferimin e së drejtës ekskluzive në tregjet e lidhura.

4) Ndërtimin e instrumenteve për të kontrolluar hyrjet dhe daljet e shpeshta brenda vitit financiar të ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të karburanteve, të cilët gjenerojnë konkurrencë të pandershme.

#### II.5.2 Hetimi ne tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, nga OSHEE.

Në përfundim të hetimit paraprak në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, proces i nisur gjate vitit 2014, në muajin Shkurt 2015, grupi i punës dorëzoi raportin e hetimi me gjetjet përkatëse, sipas të cilave nuk kishte evidenca direkte apo indirekte të marrëveshjes horizontale midis ndërmarrjeve që operojnë në tregun e shitëblerjes së energjisë elektrike. Përpara vendimmarrjes Komisioni i Konkurrencës realizoi seance dëgjimore me palët e interesuara. Gjithashtu, edhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë kishte marrë një ankesë rreth shqetësimeve të tregut të blerjes së energjisë elektrike në rrjetin e shpërndarjes, dhe e përcolli këtë shqetësim duke ofruar konsulencë dhe ekspertizë.

Në këto kushte, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me anë të Vendimit nr. 355, datë 20.03.2015 "Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes", për të investiguar nëse kishte marrëveshje horizontale.

Gjatë procedurës u organizua një seance dëgjimore nëpërmjet “*call conference*” ndërmjet Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, ekspertit Italian dhe grupit të punës së Autoritetit. Në këtë fazë u njoh me problematikën dhe shqetësimet e tregut të energjisë elektrike në Shqipëri, si dhe rekomandimet e Komisionit të Konkurrencës. Në vijim u shkëmbyen eksperiencat dhe është diskutuar mbi aspekte të procedurës së ndjekur gjatë hetimit të thelluar. Hetimi i thelluar u fokusua në mundësinë e marrëveshjes horizontale, pra ndërmjet shoqërive pjesëmarrëse në procedurë prokurimi, si edhe në mundësinë e një marrëveshje vertikale ndërmjet shoqërive pjesëmarrëse dhe OSHEE. Gjatë procedurës së hetimit të thelluar, u kalkuluan skedulet kohore gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit si dhe u kontrollua korrespondenca përkatëse, por nuk u gjeten shenja të komunikimit vertikal apo horizontal.

Në përfundim të hetimit eksperti dërgoi sugjerimet opinionet e veta rreth rastit, të cilat u reflektuan në raportin e hetimit të thelluar. Konkluzionet e hetimit të thelluar konsistojnë kryesisht në problemet e tregut të cilat janë të lidhura me modelin e tregut, dhe bazën nënligjore rregullatore gjatë kryerjes së procedurave të blerjes së energjisë elektrike.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 388, datë 14.12.2015 vendosi “Mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes dhe për disa rekomandime për Entin Rregullator të Energjisë dhe Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike” si vijon :

T’i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë dhe Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës si dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike(OSHEE):

(a) gjatë procedurave të plotësimit të kuadrit nënligjor sipas parashikimeve të Ligjit nr. 43/2015 “Për energjinë elektrike” lidhur me Modelin e Tregut dhe rregulloret e posaçme për blerjen e energjisë nga OSHEE për mbulimin e humbjeve, të mbahen parasysht rekomandimet e përsëritura të Autoritetit të Konkurrencës lidhur me parimet e garës dhe transparencës së procedurave dhe zbatimin e rregullave të ankandit sipas praktikave më të mira të ofruara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe vendet antare;

(b) të ndalojë pjesëmarrjen e ndërmarrjeve të lidhura që i përkasin të njejtit grup, apo kanë lidhje aksionerësh, të paraqiten me oferta të veçanta në procedurat e prokurimit apo të blerjes së energjisë elektrike.

Në lidhje me hetimin e thelluar nga ana e një operatori i cili ishte përfshirë në hetim u depozitua një ankesë kërkesë për përjashtim nga procedura e hetimit të thelluar.

Pas shqyrtimit të kërkesës Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 363, datë 14.05.2015 u shpreh për “Refuzimin e kërkesës së GEN – I Tirana shpk për revokimin e Vendimit nr. 355 , date 20.03.2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”

### II.5.3 Hetim paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës.

Gjatë viteve të fundit, Autoriteti i Konkurrencës ka patur në monitorim të vazhdueshëm tregun e importit dhe shitjes me shumicë të gazit të lëngshëm, pasi ky treg paraqitej me tregues të lartë të përqendrimit për gjithë periudhën që disponoheshin të dhëna. Ndërmarrjet në treg ofronin produkte homogjene, me elementë të kostos dukshëm transparente (çmim burse, shpenzime shkarkimi, transporti e magazinimi, ushtrim të

aktivitetit të importit në të njëjtin lokalitet), ku kërkesa për produkt ishte jo elastike dhe ku një ndërmarrje kishte pozitë të ndjeshme në treg.

Bazuar në raportin e monitorimit të realizuar nga Sekretariati, për të vlerësuar sjelljen e ndërmarrjes me pozitë dominuese në treg dhe pasojat e sjelljes së saj tek konkurrentët e tjerë, Komisioni i Konkurrencës u shpreh me Vendimin nr. 360, datë 04.05.2015 për hapjen e hetimit paraprak në këtë treg.

Për herë të parë, Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, realizoi analiza të thelluara ekonomike për vlerësimin e sjelljes anti-konkurrese të një ndërmarrje me pozitë dominuese. Vlerësimi u realizua në zbatim të Udhëzimit për pozitën dominuese si dhe metodologjive më të mira të OECD mbi rastet e abuzimit me pozitën dominuese. Gjatë analizës u aplikuan tre teste për vlerësimin e margine squeeze (ngjeshja e marzhit); a) *Testi e konkurrentit eficient* ku u krahasua çmimi i shitjes së ndërmarrjes së integruar në nivelin tjetër të tregtimit, me çmimin e shitjes së konkurrenteve më të afërt në të njëjtin nivel tregu, b) *Analiza e kostove dhe çmimit* të shitjes së ndërmarrjes me pozitë dominuese në nivelet e tjera të tregtimit dhe c) *Analiza i përfitueshmërisë* së ndërmarrjes me pozitë dominuese dhe ndërmarrjes së integruar vertikalisht.

Në vazhdim u vlerësuan elementë të një sjellje anti-konkurrese për çmime të larta nëpërmjet analizës së treguesve financiarë sikurse u vlerësua nëse ka elementë të një çmimi grabitqar. Analiza e çmimeve grabitqare konsistoi në krahasimin e kostove variabël dhe kostove totale me çmimin e shitjes së produktit nga ku u vu re se në periudha të shkurtra ndërmarrja me pozitë dominuese ka realizuar shitje nën koston totale dhe një sjellje e tillë mund të nxjerrë konkurrentët nga tregu ku vepron ndërmarrja me pozitë dominuese.

Gjatë procedurës së hetimit paraprak u kryen inspektime (*down raids*) në ndërmarrjet nën hetim ku nuk u gjet asnjë evidencë direkte apo indirekte që të provojë një marrëveshje apo sjellje të bashkërenduar në kundërshtim me Ligjin “Për mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar). Gjithashtu grupi hetimor u thellua në vlerësimin e nenit 8 dhe 9 të Ligjit dhe në praktikën më të mira në vlerësimin e abuzimit me pozitën dominuese. Bazuar në këto analiza, rezultoi se nuk kishte evidenca direkte apo indirekte të abuzimit me fuqinë e tregut nërmjet ngjeshjes së çmimit gjithashtu dhe gjatë fazës së hetimit paraprak nuk janë konstatuar praktika të cilat mund të konsiderohen si refuzim për të ofruar nga ana e ndërmarrjes me pozitë dominuese. Në përfundim të analizës konstatohet se në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të GLN ka dinamikë pothuajse të njëjtë midis çmimit të blerjes dhe atij të shitjes. Në nivelin e tregtimit me pakicë nuk u mundësua identifikimi i çmimit të shitjes për shkak të një rrjeti shumë të përhapur të shpërndarjes dhe të shitjes. Ndërsa ndërmarrja me pozitë dominuese kishte të njëjtën tendencë të çmimit të shitjes më atë të blerjes. Rënia e çmimit të shitjes për këto ndërmarrje rezultoi me më shumë se 30% për periudhën janar– prill 2015.

Në përfundim, pas vlerësimit të gjithë dokumentacionit të administruar gjatë procedurave hetimore në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm, rezultoi se nuk ka shkelje në kuptim të Ligjit ndaj Komisioni i Konkurrencës u shpreh me Vendimin nr 390, datë 21.12.2015, për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës.

Për një funksionim më të mirë të tregut objekt hetimi, bazuar në gjetjet e procesit hetimor, Komisioni i Konkurrencës vendosi t'i rekomandojë Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave:

(a) Të ndërmarrë veprimet e nevojshme për mirëfunksionimin e segmenteve të tregut të importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN-së në përputhje me nenet 14,15 dhe 16 të Ligjit nr 8450, datë 24.02.1999 "Për përpunimin , transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar

(b) Të ndalojë ndërmarrjet e shitjes me shumicë të GLN-së të shesin me pakicë tek klientët fundorë të cilët nuk janë të përfshirë në nenin 14 të Ligjit nr 8450, datë 24.02.1999.

(c) Të ndalojë ndërmarrjet e tregtimit me pakicë të GLN-së që të tregtojnë produkt për njësi të tjera që kanë si objekt rishitjen e këtij produkti siç parashikohet në nenin 16 të Ligjit nr 8450, datë 24.02.1999. Njësitë e shitjes me pakicë të GLN-së duhet të tregtojnë produkt vetëm për konsumatorët fundorë.

#### II.5.4 Hetim në tregun e telefonisë celulare me pakicë

Në muajin nëntor të vitit 2014, bazuar në ankesën e ndërmarrjes "Plus Communication" SHA, Komisioni i Konkurrencës vendosi për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare ndaj shoqërisë Vodafone Albania SH.A. për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës. Nga hetimi paraprak, rezultoi se ndërmarrja Vodafone Albania SH.A. zotëronte pozitë dominuese individuale në tregun objekt hetimi dhe ekzistonte rreziku për të shkaktuar një dëm të rëndë dhe të riparueshme për konkurrencën në tregun përkatës.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 356, datë 31.03.2015, vendosi marrjen e masave të përkohshme, për rivendosjen e kushteve të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, ndaj ndërmarrjes Vodafone në tregun e telefonisë celulare me pakicë. Më konkretisht: Vodafone Albania SH.A ndalohet të aplikojë tarifa në nivel me pakicë që kanë efekt diskriminues për sipërmarrësit e rrjeteve të tjera celulare kombëtare (a) Sasia e minutave brenda rrjetit Vodafone Albania të përfshira në oferta/pagesë fikse tarifore nuk duhet të ishte më e madhe se sasia e minutave drejt rrjeteve të tjera celulare kombëtare; (b) ndalimi aplikohet për të gjitha ofertat, shportat,opsionet dhe skontot e ofruara për abonentët.

Ndërmarrja Vodafone paraqiti këndvështrimet e saj në lidhje me masat e përkohshme përpara Komisionit të Konkurrencës dhe u shpreh mbi qëndrimin pro-aktiv për të adresuar shqetësimet e Autoritetit të Konkurrencës. Sipas ndërmarrjes Vodafone, nisur edhe nga përfundimet e Vendimit nr. 303, datës 16.01.2014, ajo në mënyrë të vazhdueshme ka ndërmarrë nisma në tregun e telefonisë celulare në mënyrë pro-aktive për të adresuar shqetësimet e Autoritetit të Konkurrencës. Për rrjedhojë Vodafon Albania argumentoi se sjellja e tyre bashkëpunuese së bashku me mbështetjen dhe orientimin e organeve rregullatore ndihmon thelbësisht për të arritur qëllimin e përbashkët për garantimin e konkurrencës efiçente dhe të ndershme që siguron përfitime për përdoruesit fundorë pa qenë nevoja për ndërhyrje dhe hetime të përsëritura.

Komisioni i Konkurrencës, pas vlerësimit të qëndrimeve të ndërmarrjes Vodafone Albania SHA lidhur me Vendimin nr. 356 datë 31.03.2015 dhe raportin e hetimit paraprak në tregun e telefonisë celulare me pakicë", me anë të Vendimit nr. 366, datë



04.06.2015, “Për detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e masave detyruese për barazimin e tarifave dhe minutave brenda me jashtë rrjetit” , u shpreh për detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e Vendimit nr.356 të Komisionit të Konkurrencës të datës 31.03.2015, për marrjen e masave detyruese që të ndalojë të aplikojë tarifa në nivel pakice që kanë efekt diskriminues për operatorët e rrjeteve të tjera celulare kombëtare, për të gjitha ofertat e hedhura në treg.

Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës, monitoroi tregun, ku rezultoi se Vodafone Albania kishte zbatuar Vendimin e Komisionit të Konkurrencës.

Shoqëria Vodafone Albania paditi Autoritetin e Konkurrencës për shfuqizimin e Vendimit nr. 356, datë 31.03.2015 “Për marrjen e masave të përkohshme” dhe shfuqizimin e Pikës “I” të Vendimit nr. 366, datë 04.06.2015 “Për detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e masave detyruese për barazimin e tarifave dhe minutave brenda me jashtë rrjetit”. Por vetë Vodafone pas marrjes së Vendimit të AKEP për barazimin e tarifave dhe thirrjeve brenda dhe jashtë rrjetit kërkoi pushimin e çështjes, e cila u pranua nga Gjykata.

## II.6. Kontrolli i përqendrimeve

Përqendrimet të ndërmarrjeve kemi në rastet kur shkaktohet një ndryshim i qëndrueshëm i kontrollit si rrjedhojë e (a) bashkimit të dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra –tjetra; (b) përfitimit të kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, nga një ose më shumë persona fizikë, të cilët njëkohësisht kanë kontrollin e të paktën një ndërmarrje tjetër ose nga një ose më shumë ndërmarrje, mbi një ose më shumë ndërmarrje ose pjesë të këtyre të fundit përmes blerjes së aksioneve, kuotave ose asetëve , kontratës ose çdo mjeti të ligjshëm; (c) kontrollit të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi një ose më shumë ndërmarrje ose të një pjesë të këtyre të fundit; dhe (d) krijimit të një ndërmarrje të përbashkët e cila nuk ka si objekt apo pasojë bashkërendimin e veprimtarive konkurruese ndërmjet dy ose më shumë ndërmarrjesh të pavarura”.

“Një përqendrim, bëhet objekt shqyrtimi nga ana e Autoritetit të Konkurrencës, pra njoftohet në Autoritet për marrje autorizimi, vetëm nëse përmbush kushtin e parashikuara në nenin 12, pika 1 e Ligjit: “Përqendrimet e ndërmarrjeve njoftohen në Autoritet, për të marrë autorizim, nëse në vitin e fundit financiar, para përqendrimit:

a) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku, në tregun ndërkombëtar, është më shumë se 7 miliardë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrje pjesëmarrëse në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë; b) xhiroja e të gjitha ndërmarrjeve pjesëmarrëse së bashku në tregun e brendshëm është më shumë se 400 milionë lekë dhe xhiroja e të paktën një ndërmarrje pjesëmarrëse, në tregun e brendshëm, është më shumë se 200 milionë lekë”.

Përqendrimi që përmbush kushtin e sipërshtuar, (neni 12, pika 1 e Ligjit), duhet njoftuar brenda 30 ditëve nga lidhja e marrëveshjes për bashkim ose përfitim kontrolli ose për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët.

Gjatë vitit 2015 është vënë re rritja e numrit të njoftimeve të përqendrimeve pranë Autoritetit të Konkurrencës. Ky ndryshim vjen si pasojë e dinamikave në tregun e

brendshëm si dhe të transaksioneve mes kompanive të huaja, të cilat kanë xhiro në tregun e brendshëm dhe për pësoje klasifikohen si transaksione të cilat duhet të njoftohen pranë Autoritetit të Konkurrencës.

Gjithashtu, në kuadër të mbikëqyrjes së tregut, Autoriteti i Konkurrencës ka administruar të gjithë databasen mbi transaksionet e shitëblerjes së aksioneve nga QKR-ja dhe ka filluar me nismën e tij procedurat e vlerësimit nëse rastet përmbushnin kriteret ligjore për t'u autorizuar nga Komisioni i Konkurrencës, të cilat nuk ishin njoftuar nga palët të përfshira në transaksion.

#### II.6.1 Përqendrimet e autorizuara

Gjatë vitit 2015, janë shqyrtuar dhe autorizuar 11 praktika përqendrimesh lidhur me përfitim të kontrollit, bashkimin e ndërmarrjeve apo krijimin e një ndërmarrje të re. Përqendrimet e ndodhura janë shqyrtuar si për efektet pozitive të sjella në treg, parë kjo nga pikëpamja e konsumatorit dhe rritjes së efikasitetit në treg, ashtu edhe nga premiset e mundshme për të krijuar apo forcuar pozitën dominuese të ndërmarrjes së përqendruar në treg në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi si dhe direktivave komunitare.

##### *II.6.1.1 Bashkim i dy ose më shumë ndërmarrjeve ose pjesë ndërmarrjesh të pavarura nga njëra tjetra,*

Nga përqendrimet e autorizuara nga Komisioni i Konkurrencës u analizua një rast i cili ka rezultuar të jetë bashkim apo shkrirje e dy ndërmarrjeve.

Përqendrimin Credins Bank SH.A dhe Credins Leasing SH.A: Komisioni i Konkurrencës me Vendimin e tij nr. 378, datë 02.11.2015 vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë Credins Leasing SH.A. nga shoqëria Banka Credins SH.A. Treg përkatës në këtë transaksion është konsideruar tregu i qirasë financiare leasing. Ky transaksion nuk ka rezultuar të shfaqë shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

##### *II.6.1.2 Përfitim kontrolli (i drejtpërdrejtë ose i tërthortë) i një ose më shumë ndërmarrjeve*

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr.354, datë 19.03.2015 vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të pjesëshëm të shoqërisë Archer Daniles Midland nga shoqëria Olam International Limited". Treg përkatës në këtë transaksionin është konsideruar tregu i prokurimit dhe tregtimit të kokrrave të kakaos, si dhe tregu i prodhimit dhe shitjes së produkteve gjysmë të gatshme të kakaos, si pijes së kakaos, gjalpët të kakaos dhe pluhurit të kakaos. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr.357, datë 02.04.2015 vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit nga shoqërisë Credins Bank SH.A. të 76% të kapitalit aksionar të Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit Sicred SH.A., të zotëruar nga shoqëria Sicred SH.A. Treg përkatës në këtë



transaksionin është konsideruar tregu i pensioneve private vullnetare. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 365, datë 04.06.2015, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqërisë Tranzit sh.p.k. të 100% të kapitalit aksioner të Credit Agricole Albania Bank SH.A., të zotëruar nga shoqëria IUB Holding. Treg përkatës në këtë transaksionin është konsideruar tregu ofrimit të shërbimeve bankare për individë dhe korporata. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 370, datë 21.07.2015, vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të shoqërisë Alcatel – Lucent nga shoqëria Nokia Corporation. Treg përkatës në këtë transaksionin është konsideruar tregu i pajisjeve, pjesëve elektronike dhe të telekomunikacionit dhe zgjidhjeve shërbimeve profesionale të lidhura me to. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin e tij nr. 372, date 04.09.2015 vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Raiffeisen Leasing SH.A. të portofolit të qirasë financiare të shoqërisë Tirana Leasing SH.A. Treg përkatës në këtë transaksionin është konsideruar tregu i qirasë financiare leasing. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin e tij nr. 375, date 08.10.2015 vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Cogemat S.p.A. nga shoqëria SNAI S.p.A. Treg përkatës në këtë transaksionin është konsideruar tregu i ndërtimit, rinovimit dhe restaurimit të hidrocentraleve. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 384, date 03.12.2015 vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft nga shoqëria Messer Hungarogaz Kft. Treg përkatës në këtë transaksionin është konsideruar tregu i gazeve industriale. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 393, datë 29.12.2015 vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Costa Edutainment s.p.a. nga shoqëria Venice European Investment S.p.a dhe shoqëria Priora S.r.l. Treg përkatës në këtë transaksionin është konsideruar tregu i ndërtimit, rinovimit dhe restaurimit të hidrocentraleve. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin e tij nr. 394, date 29.12.2014 vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Kastrati SH.A. të shoqërisë Auto Star Albania SH.A. Treg përkatës në këtë transaksionin është konsideruar tregu me shumicë dhe pakicë i tregtimit të mjeteve motorike (auto vetura, mjete transporti për pasagjerë, kamionë) dhe i pjesëve të këmbimit. Ky transaksion nuk

shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

#### *II.6.1.3 Krijimi i një ndërmarrje të përbashkët,*

Nga përqendrimet e autorizuara nga Komisioni i Konkurrencës gjatë vitit 2015, ka rezultuar një rast i cili shfaqte një ndryshim të qëndrueshëm kontrolli që vinte si pasojë e krijimit të një ndërmarrjeje të përbashkët (*joint venture*), e cila kryen të gjitha funksionet e një njësie ekonomike të pavarur. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 364, datë 27.05.2015 vendosi të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrjeje të pavarur JV nga ndërmarrjet Magyar Telekom Nyrto dhe MET Holding AG. Treg përkatës në këtë transaksionin është konsideruar tregu i shpërndarjes (furnizimit) me pakicë dhe shumicë të gazit natyror dhe tregu i shitjes me pakicë dhe shumicë i energjisë elektrike si dhe gjenerimin e energjisë elektrike. Ky transaksion nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.

#### *II.6.1.4 Raste të shqyrtuara që nuk janë konsideruar objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës*

Gjatë vitit 2015, pranë Autoritetit të Konkurrencës janë paraqitur 4 raste transaksioni të cilët nuk janë konsideruar objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës si pasojë e mospërbushjes së kriterit të ndryshimit të kontrollit të ndërmarrjeve objekt përqendrimi apo të mospërbushjes së kushtit të xhiros minimale të parashikuara në ligj.

##### *ABCCom Sh.p.k - New CableTV Sh.p.k*

Transaksioni i njoftuar ka pasur si objekt realizimin e përfundimit të kuotave dhe si rrjedhojë e kontrollit nga shoqëria ABCCom Sh.p.k tek shoqëria New Durrës CableTV Sh.p.k. Meqenëse shoqëria e re e sapo krijuar shërben si një mjet për transferimin e kuotave, transaksioni i transferimit të asetëve të ortakëve të shoqërisë së re tek shoqëria ABCCom Sh.p.k nuk krijonte kushtet për një ndryshim të qëndrueshëm të kontrollit në ndërmarrjen në fjalë, nuk përbën një përqendrim dhe për pasojë, në bazë të nenit 56 të Ligjit, nuk ishte objekt për dhënien e autorizimit nga Komisioni i Konkurrencës.

##### *AMC SH.A, - Cosmote Mobile Telecommunications S.A - Cosmoholding Albania S.a,*

Autoriteti i Konkurrencës u vu në dijeni nga AKEP mbi shkrirjen (merge) të aksionerëve kryesorë të shoqërisë AMC SH.A. Pra, shkrirjen ndërmjet Cosmote Mobile Telecommunications S.A ("Cosmote") zotërues i 14.757% të aksioneve të AMC-së dhe Cosmoholding Albania S.a ("CHA") zotërues i 85% të aksioneve të AMC-së. Operacioni synonte të realizohej në formën e bashkimit me përthithje ndërmjet aksionerëve të shoqërisë AMC SH.A, shoqërive greke Cosmote dhe CHA me anë të së cilit do të realizohej përvetësimi nga ana e Cosmote S.A të 100% të shoqërisë Cosmoholding Albania S.A. Të dyja shoqëritë objekt i transaksionit të ardhshëm të bashkimit me përthithje kanë rezultuar pjesë e Grupit OTE S.A dhe kontrolloheshin në mënyrë direkte dhe indirekte nga shoqëria mëmë e këtij grupi. Bashkimi i mundshëm i dy shoqërive pjesë të një grupi në formën e bashkimit me përthithje nuk shkaktonte ndryshim cilësor të kontrollit në shoqërinë AMC SH.A e cila ka vazhduar të kontrollohet direkt nga OTE

S.A dhe në mënyrë indirekte nga shoqëria Deutsche Telekom A.G dhe për pasojë nuk është klasifikuar si përqendrim në bazë të nenit 10), pika 1) , shkronja b) e Ligjit .

#### *Comverse INC - Amdoc Limited*

Operacioni i transaksionit të propozuar konsistonte në përthithjen e vetme të aseteve të sistemeve mbështetëse të biznesit të Comverse Inc. nga Amdocs Limited. Si rezultat ky i fundit ka përfutuar kontrollin e drejtpërdrejtë dhe të vetëm mbi astet e biznesit (tragetin) të shoqërisë Comverse Inc. Nga vlerësimi i pasqyrave financiare të palëve ka rezultuar se shoqëritë pjesëmarrëse në këtë transaksion edhe pse përmbushnin kushtin e nenit 12.1 a) në lidhje me xhiron në tregun ndërkombëtar, ato nuk kanë përmbushur kushtin e përcaktuar në nenin 12.1 shkronja b) në lidhje me xhiron në tregun kombëtar për vitin ushtrimor paraardhës dhe për këtë arsye ky përqendrim nuk është klasifikuar objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

#### *Food Trade Sh.p.k - Conad Al Sh.p.k*

Autoritetit i Konkurrencës është njoftuar në lidhje me ndryshimin e strukturës së ortakëve të dy shoqërive përkatësisht Food Trade Sh.p.k dhe Conad Al Sh.p.k, të cilat kanë si ortak të përbashkët shoqërinë Conad Adriatico Societa Cooperativa. Transaksionet, që janë shfaqur në formën e ristrukturimit të brendshëm të ndërmarrjeve, nuk përbënin një përqendrim dhe për pasojë, në bazë të nenit 56 të Ligjit, nuk ka qenë objekt për dhënien e autorizimit nga Komisioni Konkurrencës.

## **II.7. Rishikimi i të drejtave ekskluzive**

Në vijim të procesit të filluar në vitin 2014, edhe përgjatë vitit 2015, në fokus të veprimtarisë së Autoritetit të Konkurrencës kanë qenë një sërë të drejtash ekskluzive dhe të veçanta të dhëna në Shqipëri. Vlerësimi i këtyre marrëveshjeve konçensionare mbështetet në Ligjin nr 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" ( i ndryshuar), ku në nenin 2 të tij është përcaktuar se ky ligj zbatohet edhe për ndërmarrjet publike dhe private të cilave iu janë dhënë nga shteti të drejta ekskluzive ose të drejta të veçanta.

Autoriteti i Konkurrencës ka kryer vlerësimin *ex-post* të këtyre drejtave të veçanta dhe ekskluzive të dhëna nga institucione të ndryshme në Shqipëri, duke pasur parasysh mbrojtjen dhe ruajtjen e parimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive. Nga shqyrtimi dhe vlerësimi i të gjitha kontratave konçensionare, ka rezultuar se gjatë procedurës për dhënien e konçensionave nuk është respektuar detyrimi i nenit 2/1c dhe 69/1/b të Ligjit, pasi institucionet përgjegjëse në të gjitha rastet nuk kanë zbatuar detyrimin për të marrë vlerësimin e Autoritetit gjatë procedurës së dhënies së të drejtave ekskluzive.

Në lidhje me kontratat konçensionare të dhëna, Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 359, datë 04.05.2015 "Për disa rekomandime në lidhje me marrëveshjen e kontratës së konçesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve" është shprehur lidhur me marrëveshjen e kontratës së konçesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve të lidhur ndërmjet Ministrisë së Financave të Republikës së Shqipërisë dhe bashkimit të përkohshëm të shoqërive "Global Fluids International" S.A. dhe "Petroleum Consulting Partners" A.G. Në zbatim të Ligjit nr 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" ( i ndryshuar), është vendosur që t'i rekomandohet autoritetit kontraktor që të kërkojë zbatimin me përpikëri të marrëveshjes konçensionare për markimin dhe monitorimin e karburantit të importuar dhe prodhimit vendas, si dhe të naftës bruto, si dhe brenda një kohe të përshtatshme të realizojë

analizën e plotë *ex-post* të rezultateve gjatë fazës së parë të monitorimit deri në fund të vitit 2014.

Edhe gjatë vitit 2015, u konstatua fenomeni i informimit mbi të drejtat ekskluzive dhe të veçanta nëpërmjet mediave. Për këtë arsye, Komisioni i Konkurrencës, duke marrë shkas nga vlerësimi i konçensionit për ndërtimin e pontilit të ngarkim-shkarkimit të hidrokarbureve në Porto Romano, Durrës, u shpreh me Vendimin nr. 377, datë 22.10.2015 “Për domosdoshmërinë e marrjes së vlerësimit paraprak të Autoritetit të Konkurrencës në rastet e dhënies së të drejtave ekskluzive ose të veçanta nëpërmjet kontratave konçensionare”. Nëpërmjet këtij vendimi, i është kërkuar Këshillit të Ministrave dhe Agjencisë së Trajtimit të Konçensioneve që të zbatojë nenin 2 pika 1 germa c dhe nenin 69 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”(i ndryshuar), duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregjet përkatëse.

Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 383, datë 17.11.2015 “Për disa rekomandime lidhur me kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë konçesionare “Porti MBM (*Multy Buoy Mooring*)”, i ka rekomanduar Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Financave që:

përpara fillimit të zbatimit të projektit të koncesionit të miratojnë metodologjinë e përcaktimi të tarifave për shërbimet portuale të ofruara nga ndërmarrja konçesionare “Porti MBM;

brenda një periudhe sa më optimale të përcaktojë metodologjinë e përgjithshme të përcaktimit të tarifave për çdo koncesion me procedure të një propozimi të pa-kërkuar; për koncesionet me procedure të një propozimi të pa-kërkuar fillimisht të miratohet metodologjia specifike përkatëse për përcaktimin e tarifave, dhe vetëm me pas, Ligjin për miratimin e kontratës konçesionare.

Një tjetër rekomandim jepet lidhur me rregulloren që do të miratohet për funksionimin e Portit MBM, në të cilën duhet të përcaktohet qartë: mënyra e operimit të anijeve sipas parimit “kush hyn i pari, shërbehet i pari”; detyrimi i ndërmarrjes konçesionare “Porti MBM” për të respektuar të drejtën e barazisë për shoqëritë që do të kryejnë shërbime nëpërmjet këtij porti, duke vendosur kushte të barabarta për veprime tregtare të njëjta; si dhe detyrimi i koncesionarit për t’u ofruar shërbimet e saj të gjithë shoqërive me të njëjtat kushte teknike dhe financiare. Rekomandimi tjetër i referohet metodologjisë së tarifave për shërbimet portuale të ofruara nga ndërmarrja konçesionare “Porti MBM” në përcaktimin e së cilës duhet të ketë në konsideratë se tarifat duhet të jenë të orientuara drejt kostos, si dhe të bëhen publike dhe transparente.

Muaji dhjetor të viti 2015 pati risi. Ministria e Transportit dhe e Infrastrukturës ka depozituar dhe ka kërkuar vlerësimin e Autoritetit të Konkurrencës, në lidhje me tre draft- marrëveshje konçensionare, ku kërkohet dhënia e mendimit të Autoritetit në lidhje me shkeljen e mundshme të parimeve të konkurrencës. Në këto raste, institucioni ka kryer një vlerësim *ex-ante* të këtyre draft kontratave konçensionare, duke dhënë edhe rekomandimet përkatëse.

Procesi i analizës dhe vlerësimit të të drejtave të veçanta dhe ekskluzive do të vijojë edhe përgjatë 2016 rast pas rasti, duke dhënë edhe mendimet dhe rekomandimet përkatëse.

## II.8. Monitorimet e tregut

### II.8.1 Monitorim i tregu i importit dhe shitjes se karburanteve

Vendimi i Komisionit të Konkurrencës nr.345, datë 12.02.2015 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregimit me shumicë të karburanteve, ndaj ndërmarrjeve “Kastrati” SH.A., “Kastpetrol” SH.A., “Europetrol Durres Albania” SH.A., “Porto Romano Oil” SH.A., “Bolv Oil” SH.A., “Genklaudis” SH.A., “Everest Oil” SH.A., “Taci Oil” SH.A., “Armo” SH.A., dhe disa rekomandime për mirëfunksionimin e këtij tregu” i ngarkoi Sekretariatit të Autoritetit monitorimin e sjelljes së ndërmarrjeve në tregun e karburanteve pas periudhës hetimore. Pjesë e ndërmarrjeve në monitorim ishin importuesit më të mëdhenj të karburanteve si dhe ndërmarrjet e tyre të integruara në nivelin e shitjes e pakicë.

Raportimi i rezultateve të monitorimit tregoi se tregu i importit të dieselit paraqitet shumë i përqendruar kurse tregu i importit të benzinës është në kufijtë e sipërm të një tregu mesatarisht të përqendruar. Tregut ka karakteristika të qarta të një tregu oligopolistik me një numër të kufizuar ndërmarrjesh, me produkte homogjene dhe transparencë kostosh, me tre ndërmarrje kryesore por ku secila ndjek politikën e veta për ta zotëruar atë. Një ndërmarrje konkurren për ekspansion si në tregun e brendshëm dhe të jashtëm (Kastrati SHA), një tjetër ndryshon vazhdimisht burimet e furnizimit me qëllim maksimizimin e fitimit (Genklaudis SHA) dhe tjetra (Europetrol SHA) përpiqet të maksimizojë fitimin duke realizuar blerje në burim (eksportues të huaj) duke shmangur kostot që do të kishte nga blerjet nga operatorë vendas.

Nga vlerësimi i çmimeve të shitjes u konstatua se ndërmarrjet e shumicës ndjekin çmimin e blerjes (importit) të karburanteve dhe aplikojnë çmime me marzhe të ulta, ndërsa ndërmarrjet e integruara të pakicës nuk ndjekin trendin e çmimit të blerjes, duke aplikuar marzhe të larta kryesisht pas muajit qershor 2015. Nga analiza e çmimeve mesatare mujore të blerjes dhe të shitjes me shumicë dhe pakicë të karburanteve si dhe marzheve mesatare vjetore për periudhën janar-dhjetor 2014 dhe janar-shtator 2015, vihet re se zbatimi i Udhëzimit nr. 6, datë 30.01.2015 “Për TVSH në RSH” nuk ka patur impakt në tregun e karburanteve. Tregu ka ngurtësim të dinamikave të çmimit të pakicës, SHPK-të ndjekin të njëjtën politikë çmimi si ndërmarrjet SHA edhe në vitin 2015, gjë e cila tregon se ky Udhëzim nuk e ka shkëputur ndikimin e ndërmarrjeve SHA në përcaktimin e çmimit të pakicës nëpërmjet të integruarave të tyre. Analiza e çmimeve të larta nga ndërmarrjet e pakicës e bën të nevojshëm vlerësimin e treguesve financiarë të tyre, gjë e cila duhet të vlerësohet në mbyllje të pasqyrave financiare. Për këto arsye dhe për të qenë më të saktë në periudhat krahasimore është vendosur që monitorimi të vazhdojë edhe gjatë vitit 2016.

### II.8.2 Monitorimi i tregun të shërbimit të pajisjeve fiskale

Autoritetit të Konkurrencës realizoi monitorimin e tregut të shërbimit të pajisjeve fiskale për periudhën janar 2014 – shtator 2015, për të parë nëse ka elementë të kufizimit të konkurrencës.

Për vlerësimin e tregut përkatës, ju kërkua informacion në mënyrë shkresore ndërmarrjeve operuese në këtë treg (pesë ndërmarrje), DPT dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD). Nga të dhënat e siguruar nga ndërmarrjet për çmimet e shitjes së kasave fiskale, çmimet e shërbimit të mirëmbajtjes së pajisjeve

fiskale, si edhe nga të dhënat e vëna në dispozicion nga DPD-të, rezultoi se nga sjellja e ndërmarrjeve në tregun përkatës nuk vërehen shenja të mundshme të kufizimeve të konkurrencës. Ndërmarrjet aplikojnë çmime të diferencuara nga njëra tjetra, duke u bazuar kryesisht në kostot dhe cilësinë e produkteve që ato tregtojnë.

Nga vlerësimi i akteve nënligjore që rregullojnë këtë treg, ndërmarrja që kërkon të hyjë në këtë treg dhe të pajiset me autorizimin përkatës, i kërkohet një qarkullimin vjetor për 3 (tri) vitet e fundit në total, i cili nuk duhet të jetë më i vogël se 10 milionë euro ose ekuivalente, si dhe të depozitohet një garanci bankare në vlerën prej 500 000 (pesëqind mijë) \$, në llogari të Ministrisë së Financave, të cilat vlerësohen si barriera domethënëse hyrëse, dhe pengojnë hyrjet e reja në këtë treg.

Komisioni i Konkurrencës pas vlerësimit të këtij raporti konstatoi se në këtë treg nuk ka shkelje të Ligjit nr. 9121, datë 23.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" dhe me synimin e rritjes së hyrjeve në treg i rekomandoi Ministrisë së Financave të rishikojë barrierat ekonomike përse i përket qarkullimit vjetor prej 10 milionë EURO për 3 (tre) vjet dhe garancisë bankare prej 500 000 (pesëqind mijë) \$.

## **II.9. Rishikimi gjyqësor i çështjeve të Autoritetit të Konkurrencës**


Ndjekjes të çështjeve në sistemin gjyqësor, Autoriteti i Konkurrencës i ka kushtuar dhe i kushton kujdes dhe vëmendje të madhe për shkak se efikasiteti dhe impakti konkret në treg i vendimmarrjeve të Komisionit të Konkurrencës lidhen ngushtësisht me procesin e rishikimit gjyqësor ndaj vendimeve të Komisionit. Kjo sepse pothuajse të gjitha vendimet që kanë konkluduar në shkelje të ligjit dhe që përmbajnë ndëshkime për ndërmarrjet, i janë nënshkruar ankimit në gjykatë.

Autoriteti i Konkurrencës ka shënuar progres në zbatimin e ligjit të tij organik, për rivendosjen e konkurrencës në treg nëpërmjet veprimit dhe ndëshkimit me gjobë të ndërmarrjeve në shkelje të ligjit, për rastet e karteleve, abuzimit me pozitën dominuese, pengimin e inspektimeve dhe mos-njoftimin në kohë të përqendrimeve. Por doktrina e së drejtës së konkurrencës, ka vërtetuar se efica e ndërhyrjes së institucionit të konkurrencës në treg kushtëzohet në mënyrë të ndjeshme nga zbatimi i vendimeve të tij.

Kështu që vendimet përfundimtare të Komisionit të Konkurrencës, si akte administrative, si dhe bazuar në Ligjin nr. 49/2012, përgjithësisht i nënshtrohen procesit të rishikimit (ankimit) gjyqësor në të gjitha shkallët e gjyqësorit administrativ. Për këtë arsye Autoriteti i Konkurrencës ka ndjekur me rigorozitet proceset e ankimit dhe mbrojtjes gjyqësore si në Gjykatën e Shkallës së Parë Administrative, Apelit Administrativ dhe Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.


Nëse i referohemi statistikave, të cilat janë mjaft të detajuara në shtojcat e këtij raporti, në Gjykatat e Shkallës së Parë Administrative, gjatë vitit 2015, janë trajtuar gjithsej 6 (gjashtë) vendime të Komisionit të Konkurrencës, nga të cilat 2 (dy) kanë përfunduar me rrëzim padie dhe 2 (dy) të tjera me pushim gjykimi, duke lënë në fuqi vendimet e Autoritetit të Konkurrencës, ndërkohë që 2 (dy) çështje kanë përfunduar me pranim padie. Grafiku i mëposhtëm paraqet grupimin e çështjeve e trajtuara gjatë vitit 2015 nga Gjykata e Shkallës së Parë Administrative.

### Vendimet e Komisionit në Gjykatat e shkallës së parë Administrative



Në Gjykatat e Apelit Administrativ gjatë vitit 2015 kanë qenë për shqyrtim 9 (nëntë) çështje, nga të cilat është shqyrtuar vetëm 1 (një) dhe mbeten edhe 8 (tetë) çështje për t'u shqyrtuar në 2016. Në çështjen (Ferlut) e shqyrtuar gjatë vitit 2015 në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë është vendosur pranimi i padisë kundrejt vendimit të Komisionit të Konkurrencës.

### Vendimet e Komisionit në Gjykatat e Apelit Administrativ




Nga ana tjetër në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë gjatë 2015 kanë qenë 12 çështje për shqyrtim, nga të cilat është shqyrtuar çështja në tregun e importit të grurit dhe prodhimit të miellit, e cila është përfunduar me mospranim rekursi, ndërsa 11 raste të tjera mbeten për tu shqyrtuar gjatë vitit 2016.





Një aspekt shumë i rëndësishëm i shqyrtimit gjyqësor është konsideruar mbrojtja që realizohet nga Autoriteti i Konkurrencës i vendimeve të organit të tij vendimmarrës. Ky proces fokusohet gjerësisht në argumentimin ligjor të shkeljeve të konstatuara dhe evidentimin me prova dhe fakte, si dhe elementë të tjerë sqarues për të mundësuar një rishikim gjyqësor sa më objektiv nga ana e gjykatave. Në procesin e rishikimit gjyqësor Autoriteti i Konkurrencës ka bashkëpunuar gjerësisht me Avokaturën e Shtetit në të gjitha shkallët e gjyqësorit administrativ.

Gjithsesi mund të themi se gjatë vitit 2015 janë ndjekur në sistemin gjyqësor 27 çështje në të tre shkallët, prej të cilave mbeten për shqyrtim nga 2015/16 ( 3ShkP, 4Gj.A, 9KAGj.L) dhe 11 prej tyre të shqyrtuara në 2015, duke rezultuar përkohësisht: Në Gjykata të Shk.I, 1 në GjRRGJT 5 në Administrative, nga kjo e fundit përkatësisht 2 të humbur dhe 4 të fituara.





Në Gjykata të Apelit, 1 në GJAT dhe 8 në Gj.A.Administrativ nga të cilat 7 në pritje dhe 1 e humbur.

Në Gjykatën e Lartë 12 çështje nga të cilat 1 rrëzuar dhe 11 në pritje.

### II.9.1 Analiza e rasteve te rishikimit gjyqësor.

Lidhur me rastet në të cilat gjyqësori ka konkluduar me pranim padie, (çka nënkupton shfuqizim tërësor apo pjesor të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës (VKK), në pjesën konstatuese të vendimet e gjykatave, tërthorazi argumentohet se një pjesë e mirë e provave të zotëruara nga Autoriteti i Konkurrencës nuk janë konsideruar si evidenca dhe prova prej tyre. Konkretisht, në ilustrim të këtij përfundimi po japim disa konstatime nga vendimet e gjyqësorit mbi provat e Autoritetit të Konkurrencës:

#### **Rasti 1: Gjykata rrëzon vendimin e Komisionit të Konkurrencës për marrëveshje të ndaluar ndaj ndërmarrjes “Bloja” SHA**

Në këtë rast vihen re zgjatja me vite e zbardhjes së vendimit të Gjykatës si dhe një periudhë e gjatë kohore rreth 6 vjeçare nga marrja e vendimit të Komisionit të Konkurrencës deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës së Lartë.

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 125, datë 08.10.2009 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Atlas” SH.A dhe “Bloja” SH.A për kufizim të konkurrencës në tregun e importit të grurit, prodhimit dhe shitjes së miellit për prodhimin e bukës”, bazuar në nenin 4, pika 1, germa (a) dhe (c) dhe nenin 74, pika 1, germa (a), të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vendosi të gjobisë ndërmarrjet pjesëmarrëse në marrëveshjen e ndaluar.

Vendimi u ankimua nga palët dhe pas shqyrtimit, Gjykata e rrethit Gjyqësor Tiranë vendosi të pranojë padinë dhe të anulojë gjobën e vendosur nga Komisioni i Konkurrencës. Kjo gjykatë vonoi thujse dy vite zbardhjen e vendimit për shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Konkurrencës pasi vendimi i saj mban numrin 3198, datë 19.04.2010, ndërkohë që zbardhja e vendimit u bë në prill të vitit 2012, në momentin kur Autoriteti i Konkurrencës dhe Avokatura e Shtetit paraqitën ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Gjykata e Apelit e shqyrtoi çështjen brenda dy muajve dhe u shpreh me Vendimin nr. 1709, dt. 28.06.2012 duke lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Tiranës.

Rreth 3 vite më vonë, Gjykata e Lartë, në Dhomë Këshillimi, me vendimin nr. 00-2015-400, datë 19.02.2015 ka vendosur *mospranimin e Rekursit* të Autoritetit të Konkurrencës.

#### **Argumentimi i Autoritetit të Konkurrencës**

Nga inspektimi i kryer nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, me datë 22.01.2009 në ndërmarrjen “Atlas” SH.A, në kompjuterët e kësaj ndërmarrjeje janë gjetur disa skedarë elektronikë të cilët përmbanin të dhëna lidhur me transaksionet midis ndërmarrjes “Bloja” SH.A dhe ndërmarrjes “Atlas” SH.A. Këto të dhëna janë printuar nga kompjuteri i financës dhe janë evidentuar në procesverbalin e inspektimit.

Nga inspektimi në ndërmarrjen “Bloja” SH.A, në kompjuterin e zyrës së financës së kësaj ndërmarrjeje u gjet një skedar elektronik i emërtuar “Bloja Atlasi” 2008, në të cilin gjendej tabela “Përmbledhëse e zhdoganimeve për vitin 2008”, në të cilën pasqyrohen

të dhëna mbi importet për vitin 2008 si: sasia, çmimi, vlefata, taksat doganore, TVSH, pagesat doganore. Të dhënat e kësaj table korrespondojnë me të dhënat e gjetura në kompjuterin e financës së ndërmarrjes "Atlas" SH.A. Të gjitha evidencat e gjetura gjatë inspektimit në ndërmarrjet "Bloja" SH.A dhe Atlas SH.A u vërtetuan edhe nga të dhënat e marra nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Sipas vendimit të Komisionit është konstatuar se gjatë periudhës së marrëveshjes ndërmarrjet Atlas SH.A dhe Bloja SH.A, nuk kanë sjellje konkurruese në tregun e prodhimit dhe shitjes së miellit, pasi: (i) referuar faturave tatimore për periudhën 1-27 shkurt 2008, të dyja ndërmarrjet kanë aplikuar të njëjtin çmim të shitjes së miellit; (ii) këto dy ndërmarrje ndjekin të njëjtin trend të çmimit të shitjes së miellit për periudhën mars-gusht 2008; (iii) në datat 25 dhe 27 shkurt të vitit 2008, këto ndërmarrje kanë rritur çmimin e shitjes së miellit me të njëjtin indeks prej 1.26, vërtetuar nga faturat tatimore të shitjes së miellit të sjella nga vetë ndërmarrjet.

### **Interpretimi i Gjykatës**

Në argumentin e saj pas shqyrtimit gjyqësor gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me Vendimin nr. 3198, datë 19.04.2010 vendosi pranimin e padisë, duke argumentuar se marrëveshja informale midis shoqërive ngelet e paprovuar. Sipas vendimit të Gjykatës "është e vërtetë se dy shoqëritë "Bloja" SH.A dhe "Atlas" SH.A, janë kompani me përvojë të gjatë në fushën e tregimit të miellit dhe të importimit të grurit dhe se zënë një peshë të madhe në tregtimin e këtyre produkteve, po aq sa është e vërtetë se vetëm për një sasi të vogël të faturave të shitjes, rezultoi se çmimi ishte i afërt dhe në disa raste i ngjashëm, por kjo nuk mund të përbëjë kurrësi një marrëveshje të ndaluar midis palëve".

*Gjykata shprehet se "nuk rezultoi i provuar pretendimi i palës së paditur, se skedarët elektronikë të gjetur kishin informacion të saktë dhe të detajuar për çmimet e përbashkëta, për zhdoganimin e përbashkët, për pagimin e përbashkët të T.V.SH në import etj. Sipas shkresave të ardhura prej Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, të depozituara në gjykim, në asnjë rresht të përmbajtjes së atyre shkresave nuk provohet fakti se të dy shoqëritë kanë zhdoganuar së bashku të njëjtën sasi gruri, apo kanë paguar në emër të njëres kompani detyrimet doganore etj.*

*Gjykata arsyeton se, dhënia e sasive të grurit hua njëra tjetrës, për të garantuar furnizimin e vazhdueshëm të tregut, në kuptim të Ligjit me nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", nuk përbëjnë marrëveshje të ndaluara. Në asnjë prej parashikimeve ligjore të ligjit në fjalë, nuk parashikohen shkëmbimet e produkteve, prej kompanive me aktivitet të ngjashëm apo edhe të njëjtë në treg si marrëveshje të ndaluara.*

*Gjykata e justifikon rritjen e menjëhershme të çmimeve me zhvillimet në tregun botëror duke argumentuar se "rritja e çmimeve të drithërave në tregun botëror patjetër do të kishte një ndikim të menjëhershëm në tregun vendas, pasi paditësi do të duhej të blinte prapë në tregun ndërkombëtar tashmë me një çmim më të lartë se më parë, sasi drithërash duke përmbushur kështu detyrimet e veta kontraktore me furnizuesit e huaj"?!"*

Ky përbën një rast tipik kur interpretimi i gjykatave nuk konsideron provat dhe faktet të pasqyruara në vendimet e Komisionit të Konkurrencës, të cilat janë diskutuar në tryeza ndërkombëtare me ekspertë të fushës dhe janë konsideruar nga ana e tyre, si prova të mjaftueshme në këndvështrim të së drejtës së konkurrencës.

## **Rasti 2: Gjykata rrëzon vendimin e Komisionit të Konkurrencës për marrëveshje të ndaluar ndaj ndërmarrjes “FERLUT” SHA**

Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr. 290, datë 23.07.2013 “Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve “Ferlut” SHA, “Tirana Lines” Shpk, “Alba Trans” Shpk, “Tirana Urban Trans” SHA dhe “Parku i Transportit Urban të Udhëtarëve” shpk, për kufizim të konkurrencës në tregun e tregtimit të biletave të pajtimit mujor (aboneve) të përgjithshme dhe studentit në shërbimin e transportit rrugor qytetas të udhëtarëve në qytetin e Tiranës”, bazuar në nenin 4, pika 1, germa (b) dhe (c), nenit 45, pika 1 dhe nenin 74, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, vendosi të gjobisë ndërmarrjet pjesëmarrëse në marrëveshjen e ndaluar.

Kundër vendimit të mësipërm, për pjesën e saj ndërmarrja “FERLUT” SHA depozitoi ankim pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, e cila pas shqyrtimit të çështjes vendosi të pranojë padinë e kësaj ndërmarrjeje. Pas ankimit të Autoritetit të Konkurrencës në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, edhe kjo Gjykatë vendosi lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs pala e paditur (Autoriteti i Konkurrencës) dhe jemi në pritje të caktimit të datës së Gjykimit.

Nga analiza e mësipërme evidentohet qartazi një konfuzion i gjyqësorit mbi terminologjinë e së drejtës së konkurrencës dhe për më tepër një padijeni në çmuarjen e provave të shkeljes, shtrembërimit apo kufizimit të konkurrencës. Ndërkohë që nga praktika e GJED-së në Luksemburg, por edhe nga praktikat e tjera të njohura ndërkombëtarisht prej vendeve të zhvilluara në këtë drejtim (të cilat shërbejnë edhe si shkollë e së drejtës së konkurrencës), provat e konstatuara nga AK-ja në vendimarrjen e saj (të orientuara prej këtyre precedentëve), konsiderohen absolutisht si më se të mjaftueshme për evidentimin e kufizimit të konkurrencës.

Nga analiza e vendimeve të gjykatave rezulton se asnjë prej vendimeve të Komisionit të Konkurrencës nuk është goditur ose rrëzuar për procedurë të ndjekur nga Autoriteti i Konkurrencës. Paditë kanë konsistuar gjithmonë mbi themelin e shkeljeve të konkurrencës të konstatuara në VKK, themele të padive të cilat janë të interpretueshme dhe janë në funksion të *“thelësisë së njohurive”* të palëve mbi terminologjinë e së drejtës së konkurrencës të përmendura edhe më lart, shkak dhe rrjedhojë të së cilës është edhe varësia e gjykimit dhe e dhënies së drejtësisë mbi bazueshmërinë e vendimeve të KK-së.

Por, përtej statistikave, shqetësimi kryesor i Autoritetit të Konkurrencës është dhe mbetet përthithja nga gjyqësori administrativ i filozofisë dhe terminologjisë së konkurrencës, në përgjithësi dhe i parimeve të së drejtës së konkurrencës në veçanti, pasi është shumë e rëndësishme arsyetimi bazuar në interesin publik të vendimeve të tyre dhe të konkurrencës si një e mirë publike.

Sfida kryesore e institucionit të konkurrencës ka qënë dhe është ndërtimi dhe konsolidimi i instrumenteve të absorbimit të filozofisë së konkurrencës nga anëtarët e gjyqësorit të të gjitha niveleve. Në këtë kuadër një ndihmesë e efektshme do të ishte rritja e trajnimeve të

gjyqtarëve, sidomos tashmë, atyre të Gjykatave Administrative të të gjitha shkallëve, pasi do të jenë ata të cilët do të vlerësojnë drejtësinë e VKK në të ardhmen.

## II.10. Përafrimi i legjislacionit në fushën e konkurrencës

Detyrimi dhe angazhimi për përafrimin e legjislacionit shqiptar me të drejtën europiane të konkurrencës sanksionohet në nenin 70, 71 dhe 72 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Autoriteti i Konkurrencës konsideron shumë jetike jo vetëm procesin e përfarimit të këtij legjislacioni, por edhe shkallën e zbatueshmërisë së rregullave dhe dispozitave përkatëse. Në këtë këndvështrim, institucioni i konkurrencës i ka kushtuar rëndësi përsosjes së instrumentave rregullues nëpërmjet përsosjes së legjislacionit dytësor duke e plotësuar dhe përditësuar atë.

Përgjatë 2015, Autoriteti i Konkurrencës ka vijuar procesin e plotësimit të kuadrit nënligjor, kryesisht të udhëzuesve si një produkt që reflekton eksperiencën e institucionit.

Udhëzimi “Mbi vlerësimin e kufizimeve vertikale”, i cili është miratuar me Vendimin nr. 352, datë 3.03.2015, përcakton parimet e vlerësimit të marrëveshjeve vertikale bazuar në nenin 4 të Ligjit si dhe të Rregullores “Për përjashtimin në bllok të kategorive të marrëveshjeve vertikale dhe praktikave të bashkërenduara”. Ky Udhëzim është hartuar duke u përshtatur dhe përafruar me Udhëzimin e BE-së “Njoftimin e Komisionit Europian– Udhëzues mbi kufizimet vertikale” (52010SC0411) (2010/C 130/01) dhe është një udhëzim i rëndësishëm në punën dhe veprimtarinë e institucionit, por jo vetëm, ofrohet një mundësi për vetë komunitetin e biznesit dhe studiot ligjore, që të bëjnë vetëvlerësimin e rasteve dhe llojeve të marrëveshjeve vertikale, eficientat ekonomike që ato sjellin, efektet pozitive të këtyre marrëveshjeve të cilat tejkalojnë efektet anti konkurrese. Procesi nëpër të cilin kaloi ky udhëzim, ishte transparent, duke e bërë atë objekt diskutimi me palë të treta të interesuara, duke e dërguar për mendim, sugjerime dhe komente pranë studiove ligjore, duke publikuar draft udhëzimin para miratimit në faqen zyrtare të AK-së, si dhe duke pasqyruar komentet përkatëse në versionin final.

Udhëzimi “Kushtet dhe detyrimet në rastet e përqendrimeve”, i cili u miratuar me Vendimin nr.374, datë 8.10.2015 në përputhje me njoftimin e BE-së “Njoftim i Komisionit mbi masat e pranueshme sipas Rregullores së Këshillit nr. 139/2004 dhe sipas Rregullores së Komisionit nr 802/2004” (52008XC1022(01), (OJ C 267, 22.10.2008, p.1-27). Qëllimi i Udhëzimit është përcaktimi i rregullave dhe masave mbi angazhimet që marrin përsipër ndërmarrjet që janë të interesuara për ndryshimin dhe autorizimin e përqendrimit. Masat (*Remedies*) janë ndryshimet e modifikimet që i bëhen një përqendrimi, të propozuara nga palët në një përqendrim, me synimin për të eliminuar problematikat dhe shqetësimet e konkurrencës, të cilat janë identifikuar nga Autoriteti i Konkurrencës në një procedurë të kontrollit të përqendrimeve. Udhëzimi është miratuar në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi dhe është bërë publik për të tretët, studiot ligjore dhe më gjerë, nëpërmjet publikimit të tij në webpage-in e institucionit. Gjithashtu është dërguar zyrtarisht për marrje mendimi, komente dhe sugjerime, të cilat janë përfshirë në versionin final të tij.

Programi i Lehtësimit nga Gjobat është miratuar nga Komisioni i Konkurrencës me Vendimin nr.382, datë 17.11.2015 dhe është bazuar në modelin e ECN “Programi i lehtësimit nga gjobat”. Programi është i bazuar në përvojat e përbashkëta të

autoriteteve homologe që kanë operuar me një program lehtësimi për vite me rradhë dhe kanë pasur sukses në zbulim e praktikave anti-konkurrese, rastet e marrëveshjeve të ndaluara. Qëllimi i programit të lehtësimit nuk është vetëm të asistojnë Autoritetin në përpjekjen për të luftuar dhe ndaluar marrëveshjet e ndaluara dhe t'i dënojnë pjesëmarrësit në to, por gjithashtu është edhe "shpërblimi" që përftojnë ndërmarrjet si pasojë e bashkëpunimit me Autoritetin në shërbim të zbulimit të një karteli. Programi i lehtësimit nga gjobat është një instrument i rëndësishëm në luftën kundër marrëveshjeve të ndaluara, duke qenë se ato inkurajojnë ndërmarrjet që të ofrojnë informacion pranë Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me shkeljet e mundshme të konkurrencës. Programi i Lehtësimit nga Gjobat lejon Autoritetin e Konkurrencës që të ofrojë imunitet të plotë ose reduktim nga gjobat, që në të kundërt do të ishin vendosur për një pjesëmarrës në marrëveshje të ndaluar, gjithmonë në shkëmbim të zbulimit të informacionit mbi këtë marrëveshje të ndaluar dhe bashkëpunimit me Autoritetin e Konkurrencës. Duke pasur parasysh natyrën "sekrete" të marrëveshjeve të ndaluara, kjo politikë e lehtësimit nga gjobat synon në zbulimin e karteleve dhe në forcimin e rregullave të konkurrencës. Programi i Lehtësimit nga Gjobat u diskutua brenda Sekretariatit të Autoritetit të Konkurrencës si dhe u dërgua për mendim edhe pranë palëve të treta të interesuara si dhe pranë studiove ligjore të cilat dërguan komentet dhe sugjerimet e tyre në lidhje me programin.

### **III. ADVOKACIA DHE KULTURA E KONKURRENCËS**

Advokacia e konkurrencës përbën shtyllën e katërt të ligjit i cili, për vetë shkallën e zbatueshmërisë së Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës, në kushtet e vendit tonë merr një rëndësi jetike. Aktiviteti i Autoritetit të Konkurrencës në zbatim të këtij aspekti të Ligjit është e fokusuar në dy drejtime kryesore: a) vlerësimi i projekt/akteve normative të hartuara nga institucionet e tjera publike dhe entet rregullatore sektoriale, i cili lidhet me zbatimin e nenit 69 dhe 70 të Ligjit, dhe b) ndërhyrja në tregjet që kanë qenë objekt hetimi apo monitorimi nga institucioni i konkurrencës nëpërmjet rekomandimeve rregulluese si një instrument ligjor i zbatueshmërisë së ligjit.

#### **III.1 Vlerësimi i akteve dhe projekt-akteve normative.**

Gjatë vitit 2015 institucioni ka marrë në shqyrtim me kërkesë të institucioneve propozuese, ose me nismën e vet një sërë aktesh dhe p/aktesh normative për vlerësim në përputhje me ligjin "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" (i ndryshuar).

1. Projekt/ligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit". Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr. 379, datë 02.11.2015 "Mbi disa rekomandime mbi projekt/ligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i ka rekomanduar Ministrisë së Financave, që në projekt-ligj të reflektohen ndryshimet e nevojshme, referuar neneve 11 dhe 12 të ligjit, me qëllim që në çdo rast palës së dëmtuar ti mundësohet trajtimi i kërkesës për dëmshpërblim nga siguruesi i drejtpërdrejt për të mundësuar rritjen e konkurrencës mes shoqërive të sigurimit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit për të siguruarit.

2. Projekt/ligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar. Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr. 389, datë 14.12.2015 "Për domosdoshmërinë e marrjes së vlerësimit paraprak të Autoritetit të Konkurrencës për projekt/ligjin "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar, i ka kërkuar Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë të zbatojë nenin 69 të Ligjit nr. 9121 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (i ndryshuar), duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregjet përkatëse.
3. Kontrata Koncesionare për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve. Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 359, datë 04.05.2015 "Për disa rekomandime në lidhje me marrëveshjen e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve", vendosi t'i rekomandohet Autoritetit Kontraktor që të kërkojë zbatimin me përpikmëri të marrëveshjes koncesionare për markimin dhe monitorimin e karburantit të importuar, prodhimit vendas, si dhe të naftës bruto. Gjithashtu, brenda një kohe të përshtatshme, të realizojë analizën e plotë ex-post të rezultateve gjatë fazës së parë të monitorimit deri në fund të vitit 2014.
4. Marrëveshja për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sha dhe OSHEE, aprovuar nga ERE me Vendimin nr. 12, datë 06.02.2015. Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit nr. 367, datë 04.06.2015 "Për përjashtimin nga ndalimi të Marrëveshjes për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015", vendosi të përjashtojë nga ndalimi i parashikuar në nenin 4 të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (i ndryshuar) Marrëveshjen për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015, me një afat përjashtimi nga hyrja në fuqi e këtij vendimi deri më 31.12.2015; miratimin sa më shpejt të modelit të tregut të energjisë elektrike në përputhje me specifikat e tregut shqiptar; njoftimin e marrëveshjeve dhe ndryshimet e bëra në to pranë Autoritetin e Konkurrencës për vlerësimin e përjashtimit individual të marrëveshjeve.
5. Projekt/Marrëveshja e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike midis OSHEE SHA dhe "Furnizuesve" të energjisë elektrike. Komisioni i Konkurrencës, me anë të Vendimit nr.381, datë 9.11.2015 "Për vlerësimin e Projekt-Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike midis OSHEE SHA dhe "Furnizuesve", u shpreh se kjo "Projekt/Marrëveshje nuk bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës" (i ndryshuar).
6. Projekt/Ligji "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, për transport". Autoriteti i Konkurrencës me anë të shkresës nr. 458/1 prot, datë 30.12.2015 është shprehur se Projekt/Ligji "Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, për transport", nuk bie ndesh me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", të ndryshuar.

7. Projekt/udhëzimi "Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarive në fushën e transportit detar dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre". Autoriteti i Konkurrencës, pas vlerësimit të projekt/udhëzimit, nëpërmjet shkresës nr. 185 prot, dt. 03.04.2015, shprehet se rekomandimet e dhëna me anë të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 349, datë 19.02.2015 janë marrë në konsideratë nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës. Gjithashtu, Autoriteti i Konkurrencës sugjeroi që në projekt udhëzim të përcaktohet që: "Licencës ti bashkëlidhet orari dhe itinerari i linjës dhe çmimet maksimale të biletave sipas të gjitha kategorive përfshirë taksat". Për metodologjinë e llogaritjes së çmimit do të shërbejnë të dhënat që do të dorëzohen nga ndërmarrjet si dhe në Udhëzim të shtohet një pikë, ku të kërkohej paraqitja në mënyrë të detajuar të të gjitha kostove reale për shërbimin që ofrojnë.
8. Projekt/rregulloren "Për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të pjesëshëm ose të plotë, rinovimit dhe heqjes së licensave në sektorin e energjisë elektrike". Autoriteti i Konkurrencës me anë të shkresës nr. 303/1 prot, dt. 22.07.2015 drejtuar ERE, është shprehur se Projekt/rregullorja e paraqitur nuk bie ndesh me ligjin "Për mbrojtjen e konkurrencës", sugjeron që procedurat e licensimit të operatorëve pjesëmarrës në tregun e energjisë elektrike duhet të kryhen në përputhje me modelin e tregut të energjisë elektrike.
9. Projekt/rregulloren "Mbi procedurat për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike". Autoriteti i Konkurrencës me anë të shkresës nr. 304/1 prot, dt. 22.07.2015 drejtuar ERE, është shprehur se projekt-akti i paraqitur nuk bie ndesh me ligjin "Për mbrojtjen e konkurrencës". Por meqenëse OST luan një rol kyç për mirëfunksionimin e tregut të energjisë elektrike nga pikëpamja e konkurrencës, duhet që të hartohet dhe të miratohet modeli i tregut të energjisë elektrike fillimisht dhe pastaj të plotësohet me aktet përkatëse.
10. Projekt/rregulloren "Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s". Me anë të shkresës nr. 305/1 prot, dt. 22.07.2015 drejtuar ERE, Autoriteti i Konkurrencës është shprehur se Projekt-Rregullorja nuk bie ndesh me ligjin "Për mbrojtjen e konkurrencës". Bazuar në përvojën e deritanishme, do të ishte në interes të tregut të energjisë dhe të parandalimit të sjelljeve antikonkurrese, në parashikimin e nenit 20 "Procedimi i aplikimit për marrje license", të merret në konsideratë edhe opinioni i Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me operatorët e rinj apo ekzistues që do të licensohen në segmente të ndryshme të tregut të energjisë.
11. Projekt/amendimet e Rregullores "Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes", me anë të shkresës nr. 167/1 prot, dt. 09.04.2015 drejtuar ERE, Autoriteti i Konkurrencës është shprehur se bazuar në ligjin "Për mbrojtjen e konkurrencës" ky projekt/akt bie në kundërshtim me Ligjin, pasi sjell kufizim të numrit të ofruesve për kryerjen e shërbimeve në rrjetin e shpërndarjes, gjë e cila çon në kufizim të konkurrencës në tregun përkatës dhe në mundësinë konsumatorë për të zgjedhur.  
Me qëllim shmangien e këtij kufizimi, Komisioni i Konkurrencës i rekomandon ERE-s që në ndryshimet e propozuara në Rregulloren e "Lidhjeve të Reja në sistemin e shpërndarjes", të mos ketë kufizim të numrit të ofruesve për të gjitha llojet e shërbimeve që do të kryhen në rrjetin e shpërndarjes; të gjitha procedurat për shërbimet e kërkuara nga OSHEE "Për lidhjet e reja në rrjetin e shpërndarjes" të jenë transparente dhe të publikuara, me qëllim që të mos



kufizohet numri i ofruesve të këtij lloji shërbimi; miratimi për të licensuarit për shërbimet në rrjetin e shpërndarjes të kryhet nga ERE ose nga institucionet licensuese dhe të njoftohet OSHEE.

12. Dokumenti “Analizë e tregut të telefonisë fikse. Tregu me pakicë i aksesit/thirrjeve nga rrjete publike telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit/tranzitimit/origjinimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse”. Autoriteti i Konkurrencës është shprehur pa vërejtje dhe sugjerime, duke vlerësuar se dokumenti ka adresuar drejt çështjet e konkurrencës dhe se ndërmarrja "Albtelekom" ka rënie të pjesëve të tregut, duke u ndeshur me konkurrencë të operatorëve të tjerë.

## III.2. Rekomandimet e mirëfunksionimit të tregjeve

Autoriteti i Konkurrencës, gjatë procedurave hetimore si dhe monitorimeve të realizuara bazuar në ankesat e depozituara nga operatorë të tregut, ka vlerësuar faktorët që ndikojnë në nivelin e konkurrencës në tregjet e adresuara. Një paraqitje e detajuar e proceseve hetimore dhe monitoruese është prezantuar në kapitullin e mëparshëm. Në mënyrë më të përmbledhur të rekomandimeve konkrete të adresuara për secilin treg të analizuar nga institucioni i Konkurrencës trajtohet në vijim:

### III.2.1 Në tregun e energjisë elektrike

- ✓ Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 388, datë 14.12.2015 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në “Tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes” dhe disa rekomandime për Entin Rregullator të Energjisë dhe Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, ka rekomanduar që gjatë procedurave të plotësimit të kuadrit nënligjor sipas parashikimeve të Ligjit nr. 43/2015 “Për energjinë elektrike” lidhur me modelin e tregut dhe rregulloret e posaçme për blerjen e energjisë nga OSHEE për mbulimin e humbjeve, të mbahen parasysh rekomandimet e përsëritura të Autoritetit të Konkurrencës lidhur me parimet e garës dhe transparencës së procedurave dhe zbatimin e rregullave të ankandit sipas praktikave më të mira të ofruara nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë dhe vendet anëtare; ndalimin e pjesëmarrjes së ndërmarrjeve të lidhura që i përkasin të njëjtit grup, apo kanë lidhje aksionerësh, të paraqiten me oferta të veçanta në procedurat e prokurimit apo të blerjes së energjisë elektrike.
- ✓ Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 385, datë 3.12.2015 Për “Disa rekomandime për Entin Rregullator të Energjisë mbi zgjidhjen e problematikës së faturimit për klientët e lidhur në tensionin e mesëm dhe faturohen në tensionin e ulët”, i rekomandoi ERE-së: zgjidhjen përfundimtare të problemeve për klientët e lidhur në tension të mesëm duke miratuar një tarifë të posaçme sipas kategorisë së klientëve, me qëllim vendosjen në kushte jo diskriminuese dhe të njëjta konkurrence, si dhe; vlerësimin e tarifës së zbatuar nga OSHEE nëse përbën një tarifë mbi tarifën e miratuar dhe kompensimin përkatës të klientëve në zbatim të parashikimeve ligjore në fuqi.

### III.2.2 Në tregun e karburanteve dhe gazit të lëngshëm të naftës

- ✓ Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 345, datë 12/02/2015 ka dhënë disa rekomandime lidhur me mirëfunktionimin e tregut të prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve. Ndër këto rekomandime përmendim: rishikimin e Ligjit nr. 8450, datë 24.02.19996 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre"; krijimin e bazës ligjore dhe infrastrukturën administrative të nevojshme për një njësi të transparencës së çmimit të hidrokarbureve në të cilën ndërmarrjet që operojnë në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve duhet të njoftojnë në kohë reale brenda 5-15 minuta këtë njësi dhe Autoritetin e Konkurrencës për çdo ndryshim të çmimit të shitjes me shumicë; vlerësimin e zbatimit të marrëveshjes koncesionare në portin "Vlora 1" për respektimin e detyrimit të mos përfshirjes së koncesionarit në tregtimin e karburantit si dhe transferimin e së drejtës ekskluzive në tregjet e lidhura; ndërtimin e instrumenteve për të kontrolluar hyrjet dhe daljet e shpeshta brenda vitit financiar të ndërmarrjeve që operojnë në tregun e tregtimit me shumicë të karburanteve, të cilët gjenerojnë konkurrencë të pandershme". Nëpërmjet këtij vendimi është rekomanduar që: Ndërmarrjet që operojnë në tregun e hidrokarbureve të paraqesin pranë Autoritetit të Konkurrencës për vlerësim, marrëveshjet që ato lidhin për realizimin e importeve të përbashkëta apo përdorimin e logjistikës, për të përfituar përjashtimin individual të tyre në bazë të nenit 5 të Ligjit.
- ✓ Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 390, datë 21.12.2015 "Për Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës dhe dhënien e rekomandimeve për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë", ka rekomanduar që: të ndërmerren veprimet e nevojshme për mirëfunktionimin e segmenteve të tregut të importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të GLN-së në përputhje me nenin 14, 15 dhe 16 të Ligjit nr. 8450, date 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar.  
Me shkresën nr 6619/2 të datës 17.11.2015 Ministria e Energjisë dhe Industrisë shprehet se e vlerëson këtë raport dhe njëkohësisht informon se për të parë në detaje situatën ligjore pikërisht në tregun gazit të lëngshëm të naftës është ngritur një Grup Pune me Urdhrin nr.200 date 02.09.2015 "Për ngritjen e Grupit të Punës për vlerësimin e situatës aktuale ligjore dhe institucionale në aktivitetin e tregtimit të gazit të lëngëzuar të naftës", dhe se do të na bëhen me dije rezultatet konkrete që do të arrihen nga puna e këtij grupi.

### III.2.3 Në tregun e transportit ajror dhe detar,

- ✓ Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 391, datë 24.12.2015 "Për disa rekomandime në lidhje me draft-amendamentin e Marrëveshjes së Koncesionit të lidhur më datë 15 Tetor 2004 ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Tirana Internacional Aeroport SHPK", ka rekomanduar: mos zgjatjen e afatit të ekskluzivitetit për fluturimet ndërkombëtare pavarësisht kushteve të vendosura nga koncesionari për rishikimin e marrëveshjes; liberalizimin e shërbimeve (*ground handling*) sipas anekseve të kontratës koncesionare: (i) Pagesës së Shërbimit në Tokë dhe e Uljes dhe e Ngritjes, (ii) Pagesës për Pasagjerët, (iii) Pagesës së Kargos, (iv) Pagesës së Parkimit të Avionëve dhe (v) Pagesës së ndriçimit të aerodromit. Nëpërmjet këtij vendimi është kërkuar edhe zbatimi i vendimit të

Komisionit të Konkurrencës nr. 308, datë 21.02.2014 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në tregun e shërbimit të transportit ajror”, në mënyrë të veçantë: “Për shkak të pozicionit të kompanisë koncesionare si i vetmi ofrues i shërbimeve ndërkombëtare të transportit të pasagjerëve, OSHA të hartojë dhe aprovojë një metodologji/rregullore për vendosjen e tarifave të aeroportit, si edhe tarifatat të jenë të orientuara drejt kostos”.

- ✓ Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 349, datë 19.02.2015 “Për masat rregulluese dhe rekomandimet në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”, i ka rekomanduar Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës që të detyrojë ndërmarrjet që operojnë në treg të mbajnë të dhënat ditore për tarifatat e aplikuara të çdo biletë të shitur si dhe të mbajnë rekorde të shitjeve të biletave për një periudhë të paktën 3 (tre) vjeçare. Këto të dhëna të jenë të aksesueshme në çdo kohë nga institucionet licensuese dhe mbikëqyrëse të tregut. Gjatë procesit të licencimit të ndërmarrjeve të miratohen nivelet e tarifës maksimale që do të aplikohen për çdo kategori udhëtimi sipas sezoneve. Gjithashtu, është rekomanduar që Ministria të realizojë mbikëqyrjen e tarifave të aplikuara nga ndërmarrjet krahasuar me tarifatat maksimale të miratuara, si dhe të hartojë një metodologji bazuar në kostot reale për përcaktimin e nivelit të tarifave maksimale për shërbimin e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve dhe automjeteve.
- ✓ Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 369, datë 02.07.2015 “Për disa masa detyruese në tregun e shërbimit të transportit ndërkombëtar detar në Portin e Vlorës”, ka vendosur ndalimin e ndarjes së tregut të shërbimit të transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve nga ndërmarrja “Porti Vlorë” SHA; si dhe detyrimin e ndërmarrjes “Porti Vlorë” SHA të zbatojë dhe lejojë operimin në kushte të barabarta, për të gjithë operatorët që operojnë në terminalin e Portit të Vlorës, duke i vendosur ato në gjendje të favorshme konkurrence, për shërbimin e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve.

#### III.2.4 Në tregun e komunikimeve elektronike dhe postare

- ✓ Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 351, datë 03.03.2015 “Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike lidhur me brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WIMAX”, i ka rekomanduar Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare që t’u mundësohet të gjithë operatorëve celularë e drejta e përdorimit në brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMTS/WIMAX, duke i vendosur ata në kushte të barabarta konkurrence në treg.

#### III.2.5 Në tregun e ndërtimit/prokurimit publik

- ✓ Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr.358, datë 16.04.2015 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtimi i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (Segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3” dhe disa rekomandime për Autoritetin Rrugor Shqiptar”, ka rekomanduar që: në ndarjen e loteve të mos krijohet mundësi për ndarje tregu sipas vëllimit të punimeve ndërmjet konkurrentëve dhe ndarje tregu gjeografik; të kryhet vlerësimi i plotë i kriterëve ekonomike dhe financiare për të gjithë pjesëmarrësit apo bashkimet e kompanive pjesëmarrëse me qëllim që të sigurohet

trajtim i barabarte dhe jodiskriminues ndërmjet pjesëmarrësve në procedura, si dhe; të shmangen format e paradhënies dhe vlerësimit preferencial ndaj ndërmarrjeve të ndryshme të cilat kufizojnë konkurrencën.

### III.2.6 Në tregun e pajisjeve fiskale

- ✓ Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. 387, datë 14.12.2015 “Për disa rekomandime në tregun e shërbimit të pajisjeve fiskale”, ka rekomanduar që: të rishikohen barrierat ekonomike për sa i përket qarkullimit vjetor prej 10 milionë EURO për 3 (tre) vjet dhe garancisë bankare prej 500 000 (pesëqind mijë) \$ si kushte për liçensimin e ndërmarrjeve që e ofrojnë këtë produkt.

## III.3 Bashkëpunimi ndërinstitutional

Bashkëpunimi real i Autoritetit me entet rregullatore sektoriale dhe institucionet qendrore të ekzekutivit gjithmonë është konsideruar si një domosdoshmëri për një treg sa më konkurrues. Për realizimin e këtij objekti, institucioni i konkurrencës ka përdorur të gjitha instrumentet e komunikimit dhe të bashkëveprimit duke synuar që rekomandimet e dhëna në Vendimet e Komisionit të Konkurrencës të mos mbeteshin vetëm në letër por të mundësohej diskutimi dhe vendosja në efikasitet reale e tyre.

### III.3.1. Bashkëpunimi me entet rregullatore dhe institucionet e tjera publike

Gjatë vitit 2015, Autoriteti i Konkurrencës ka patur një bashkëpunim të mirë me Kuvendin e Shqipërisë, dhe më konkretisht me Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, i cili ka kërkuar opinionin e Autoritetit të Konkurrencës për Ligjin në sektorin e energjisë dhe atë të gazit. Gjatë seancave dëgjimore i është tërhequr vëmendja Ministrisë së Energjetikës për mos dërgimin e Ligjit të sektorit të energjisë për mendim në zbatim të nenit 69 të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Sikurse është paraqitur në pjesën e parë dhe të dytë të këtij kapitulli, janë të shumta rekomandimet e Komisionit të Konkurrencës për tregje në të cilët janë identifikuar probleme. Por, marrja në konsideratë e tyre apo hedhja për diskutim me Komisionin e Konkurrencës është pothuajse e pamundur që të evidentohet. Ky fakt mund të vihet re edhe nga informacioni i paraqitur tek kolona “Sa është marrë në konsideratë” e shtojcës nr.7: “Matrica e vendimeve për dhënie rekomandimesh për vitin 2015”.

### III.3.2. Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës dhe gjyqësorin

Bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për trajnimin e gjyqtareve me specifikat e ligjit të konkurrencës dhe praktikën e së Drejtës Evropiane në këtë fushë ka qenë një nga objektivat e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2015. Trajnimi dhe seminarët në fushën e gjyqësorit mbi çështjet e konkurrencës është, gjithashtu, një nga detyrat e Komisionit Evropian të cilësuar qartësisht gjatë viteve të fundit.

Kështu, në 17-18 Dhjetor 2015, Autoriteti i Konkurrencës në bashkëpunim me ekspertët e konkurrencës të UNCTAD, si dhe Shkollës së Magjistraturës (në kuadër të një projekti mes palëve) organizoi një workshop dy ditor, për rreth 20 gjyqtarë. Pjesëmarrës në këtë seminar trajnues ishin si gjyqtarë të dy shkalleve të gjyqësorit në aspektin e

gjykatave Administrative edhe në ato Civile nga i gjithë vendi, ashtu edhe përfaqësues nga Autoriteti i Konkurrencës.

Trajnimi u zhvillua në mjediset e Shkollës së Magjistraturës dhe synimi kryesor i tij ishte t'i familjarizonte pjesëmarrësit (që kishin një formim të përgjithshëm juridik) me çështjet ekonomike në fushën e konkurrencës, legjislacionin parësor dhe dytësor, rregullore të tjera të Autoritetit si dhe Politikën e Konkurrencës. Njëkohësisht gjate seminarit u arrit promovimi i këtij kuadri ligjor me zbatueshmërinë e tij në të njëjtën linjë me qëllimet e politikës së konkurrencës të parashikuara në ligj.

Ky seminar ishte i pari, i një serie seminaresh që do të mbahen gjatë 2016 në kuadër të këtij projekti.

### III.3.3 Marrëdhëniet me Ministrinë e Integritit Evropian

Gjatë vitit 2015, Autoriteti i Konkurrencës ka vazhduar bashkëpunimin me Ministrinë e Integritit Evropian si institucioni koordinues i të gjitha përpjekjeve të vendit drejt integritit evropian. Autoriteti i Konkurrencës ka përgatitur raporte të cilat pasqyrojnë progresin e arritur dhe ka dhënë kontributin e tij në hartimin e dokumenteve që lidhen me procesin e Stabilizim-Asociimit. Autoriteti i Konkurrencës ka marrë pjesë në hartimin e Planit Kombëtar për Integritin Evropian (PKIE) 2016-2020 për Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës”, si dhe në përditësimin e këtij plani për vitin 2015 e në vazhdim. Plani Kombëtar shërben si bazë për planifikimin e procesit të integritit evropian të Shqipërisë, duke përcaktuar kuadrin ligjor dhe nismat e planifikuara për tu përfaruar në kuadër të procesit të integritit.

Në respektim të afateve kohore, i janë përcjellë Ministrisë së Integritit raporte periodike për monitorimin e realizimit të Planit Kombëtar për Integritin Evropian (PKIE) 2014-2020 për kapitullin 8. Po kështu janë përgatitur dhe prezantuar informacione pranë Komisionit Evropian në kuadrin e zhvillimit të takimeve periodike midis Shqipërisë dhe BE-së, konkretisht takimi i gjashtë i Komitetit të Stabilizim – Asociimit BE Shqipëri dhe i Nën-komitetit BE–Shqipëri për “Tregun e Brendshëm dhe Konkurrencën, përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit” në Mars 2015. Në këto takime është raportuar mbi aktivitetin e institucionit, punën e bërë me rastet hetimore të nisura, vlerësimet e kryera nga autoriteti dhe përpjekjet për mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg.

Në takimin e nën-komitetit të Marsit 2015, u vlerësua puna dhe aktiviteti i Autoritetit të Konkurrencës, si institucioni që funksionon në zbatim të ligjit dhe në mbrojtje të parimeve të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Për rritjen e efikasitetit të vendimeve të Komisionit të Konkurrencës, përfaqësuesit e Njësisë së Zgjerimit të Komisionit Evropian i kërkoi përfaqësuesve të MIE të hartonin matricën e veprimeve për zbatimin e rekomandimeve të Autoritetit të Konkurrencës.

Si lider dhe koordinator i kapitullit 8 “Politika e Konkurrencës”, Autoriteti i Konkurrencës ka raportuar edhe në lidhje me vlerësimet e të drejtave të veçanta dhe ekskluzive të kryera nga institucioni, vlerësime *ex-ante* apo *ex-post* rast pas rasti.

### III.4. Kultura e konkurrencës – marrëdhëniet me publikun dhe mediat

Prioritete të punës dhe aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës janë forcimi i kulturës së konkurrencës tek komuniteti i biznesit dhe konsumatori nëpërmjet transparencës dhe

njohjes nga ana e publikut të rregullave dhe procedurave që institucioni i konkurrencës zbaton në kuadër të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Edhe gjatë vitit 2015, së bashku me aktivitetet zbatuese, në respektim të dispozitave ligjore, institucioni ka vijuar të përdorë të gjitha instrumentet e mundshme për të promovuar advokacinë e konkurrencës dhe për të forcuar kulturën e konkurrencës.

Organizimi i seminareve rajonale. Autoriteti i Konkurrencës e vlerëson shumë të rëndësishëm bashkëpunimin me qeverisjen vendore, si dhe me komunitetin e biznesit në qarqe të ndryshme të Shqipërisë. Me synimin edhe rritjen e kulturës dhe ndërgjegjësimin në çështjet e konkurrencës, gjatë viti 2015 u organizuan seminare rajonale me përfaqësuesit vendorë. Një seminar i tillë u organizua në muajin Tetor 2015, dhe qëllimi i këtij seminari ishte ndërtimi i një partnership-i real me komunitetin e biznesit, universitetin dhe pushtetin vendor të qarkut të Korçës.

Objekti i diskutimit në këtë seminar ishte njohja me aspektet e ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, raste e trajtuara nga Autoriteti i Konkurrencës, sanksionet që parashikon ligji dhe nisma e ndërmarra nga Autoriteti i Konkurrencës në hartimin e një programi të ri të lehtësimit nga gjobat për biznesin, i cili synon në bashkëpunimin me komunitetin e biznesit për zbulimin e praktikave anti-konkurrese.

Seminare të tilla ndërgjegjësuere, lidhur me punën dhe aktivitetin e institucionit, si dhe njohja me nocionet bazë të ligjit dhe rasteve praktike të institucionit, janë parashikuar të organizohen edhe gjatë 2016.

Komunikimi me publikun përbën një hallkë të rëndësishme në aktivitetin e Autoritetit të Konkurrencës, si në përmbushjen e detyrimit për të ofruar transparencë maksimale të vendimmarrjes dhe efektivitetit të saj, ashtu edhe për arritjen e objektivit të përhershëm të rritjes së besueshmërisë së institucionit. Në këtë kuadër, Autoriteti i Konkurrencës e vlerëson komunikimin ndërveprues me publikun si një çështje parësore dhe me rëndësi strategjike, për të transmetuar tek opinioni publik, sa më drejt dhe kuptueshëm, politikën e konkurrencës të zbatuar prej tij. Komunikimi me studentët e fakulteteve juridike dhe ekonomike është konsideruar si një instrument për rritjen e kulturës.

Informimi i publikut: Autoriteti i Konkurrencës përdor një sërë kanalesh komunikimi për informimin e publikut, me qëllim shpjegimin sa më qartë të misionit të institucionit, si dhe të mënyrës së përmbushjes së tij. Ndër to përmendim: konferencat për shtyp dhe intervistat që Autoriteti i konkurrencës organizon në lidhje me vendimmarrjeje të rëndësishme të Komisionit të Konkurrencës .

Marrëdhëniet me median : Autoriteti i Konkurrencës e konsideron komunikimin me median si element mjaft të rëndësishëm për informimin e publikut në kohë reale mbi vendimet dhe aktivitetet e tij. Në këtë kuadër, media është informuar dhe sensibilizuar në vazhdimësi mbi çështje që lidhen, si me procedurat hetimore ashtu edhe me situatën e konkurrencës në tregje të caktuara të ekonomisë shqiptare.

Botimet: Botimet e Autoritetit të Konkurrencës ofrojnë informacion të zgjeruar e të përditësuar mbi veprimtarinë e institucionit; mbi shpjegimin e koncepteve bazë të konkurrencës, mbi miratimin e akteve të nevojshme ligjore apo nënligjore etj., duke u konsoliduar kështu si burim informacionesh të sakta dhe të besueshme për publikun. Botimet e realizuara gjatë vitit 2015 kanë të bëjnë me; Raporti Vjetor (vjetor), Buletini i vendimeve; Përmbledhje e akteve ligjore dhe nënligjore, Botim në lidhje me Programin e Lehtësimit nga Gjobat, ribotim të broshurave informuese në fushën e konkurrencës etj.

Faqja e internetit: Gjatë vitit 2015, Autoriteti i Konkurrencës ka ofruar transparencë të plotë, duke publikuar në kohë reale, në faqen e tij të internetit, informacion mbi aktivitetet e tij , vendime të Komisionit të Konkurrencës, njoftime në lidhje me veprimtari të kryera etj. Njoftimet për shtyp si dhe vendimet me kryesore të Komisionit të Konkurrencës janë publikuar edhe në gjuhën angleze.



## **IV. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR**

### **IV.1 Bashkëpunimi me Komisionin Evropian**

Dhënia e statusit të vendit kandidat për Shqipërinë, në 24 qershor 2014, përbën një vlerësim për reformat e ndërmarra nga Shqipëria si dhe përçon një sinjal të rëndësishëm, lidhur me reformat që kërkohen në kuadër të procesit të integritimit evropian dhe e vendos marrëdhënien me Bashkimin Evropian në një stad të ri. Në Tetor 2015, Komisioni Evropian publikoi raportin e tij vjetor për progresin e realizuar nga Shqipëria drejt integritimit evropian, duke vlerësuar përpjekjet e vendit për të përmbushur kriteret e Kopenhagenit dhe kushtet e procesit të stabilizim-asociimit

Pjesë e këtij Raporti janë edhe vlerësimet për Kapitullin 8 – Politika e Konkurrencës, ku Komisioni Evropian ka vlerësuar pozitivisht disa përparime në fushën e konkurrencës. Në mënyrë më të detajuar paraqitet në Shtojca 7: “Raporti i KE-së për Shqipërinë : Kapitulli 8 “Politika e Konkurrencës””, në të cilën shprehet qartë për nivelin e ekspertizës së stafeve të institucionit të konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës ka rol kryesor në Kapitullin 8 “Politika e Konkurrencës” duke qenë se është lider dhe koordinator i këtij kapitulli, që përbëhet nga tre pjesë, pjesa e konkurrencës, e ndihmës shtetërore dhe ajo e liberalizimit. Si koordinator i Kapitullit, edhe gjatë vitit 2015 janë kontaktuar edhe institucionet e tjera, pjesë përbërëse dhe anëtarë të Grupit Ndërinstitucional të Punës për Integritimin Evropian, në mënyrë që kontributi për këtë kapitull të jetë sa më i plotë.

### **IV.2. Bashkëpunimi me OECD (RCC Budapest)**

Ligji dhe politika e konkurrencës po marrin gjithmonë e më tepër natyrë ndërkombëtare, dhe për këtë arsye është shumë i rëndësishëm dhe i domosdoshëm bashkëpunimi ndërkombëtar. Bashkëpunimi me OECD ka vijuar edhe përgjatë 2015 nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve dhe eksperiencës, diskutimit lidhur me rastet e shqyrtuara nga institucioni shqiptar i konkurrencës, përfshirja në diskutimet e rasteve hipotetike të ndërtuar nga ekspertet ndërkombëtar të fushës, etj. Trajnimet e ofruara nga OECD në Hungari, janë një burim i rëndësishëm trajnimi për stafin e institucionit, duke qenë se në këto trajnime diskutohen dhe analizohen çështje të konkurrencës dhe rregullat e konkurrencës, të cilat janë të domosdoshme në trajtimin e çështjeve konkrete me të cilat ndeshen specialistët e autoritetit në punën e tyre të përditshme në zbatim të ligjit.

### **IV.3. Bashkëpunimi me Konferencën për Tregti dhe Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNCTAD)**

UNCTAD është një nga organizatat ndërkombëtare që i kushton një rëndësi të madhe politikës së konkurrencës. Një nga aktivitetet kryesore të UNCTAD është asistencë që u jep autoriteteve të konkurrencës në procesin e adoptimit dhe zbatimit të rregullave të konkurrencës nëpërmjet ofrimit të asistencës teknike, duke ndihmuar këto vende që të rrisin kapacitetet e tyre dhe nivelin e ekspertizës në çështjet e konkurrencës.

Autoriteti i Konkurrencës, më kërkesën e tij vullnetare, ishte pjesë e procesit të vlerësimit (*Peer review*) të kryer nga ekspertët e UNCTAD, të cilët në përfundim të

procesit (i cili është prezantuar në raportin Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2014) hartuan një raport të detajuar duke konkluduar me rekomandime për institucionin e konkurrencës, ligjvënësin si dhe ekzekutivin shqiptar. Një seksion i veçantë dëgjimor u mbajt në Konferencën Vjetore Ndërkombëtare në Gjenevë, në Korrik 2015, gjatë të cilit u vlerësua aktiviteti i Autoritetit, kuadri ligjor primar dhe sekondar, si dhe zbatueshëmia në praktikë e Ligjit dhe Politikës së Konkurrencës. Gjatë këtij seksioni pati diskutime dhe pyetje të ndryshme nga përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare të konkurrencës si dhe interes lidhur me veprimtarinë e institucionit tonë.

Në përfundim të procesit të vlerësimit, Autoritetit Shqiptar të Konkurrencës iu akordua asistencë nga donator të ndryshëm të cilat drejtohen nga UNCTAD. Ky financim do të përdoret për trajnime të ndryshme në fushën e konkurrencës, jo vetëm për stafin e Autoritetit por edhe për të tretë. Projekti i UNCTAD parashikon aktivitete të tjera që do të forcojnë punën e Autoritetit të Konkurrencës, në veçanti, realizimi i atyre aktivitete që do të mbështetin rekomandimet që janë adresuar në dokumentin e *Peer Review*.

#### **IV.4. Bashkëpunimi me Rrjetin Ndërkombëtar të Konkurrencës (ICN)**

Rrjeti Ndërkombëtar i Konkurrencës është një rrjet i Autoriteteve Kombëtare të Konkurrencës, i krijuar për të trajtuar çështje të ndryshme lidhur me konkurrencën, duke pasur në fokus zhvillimin e bashkëpunimit dhe vendosjen e marrëdhënieve të mira në trajtimin e këtyre çështjeve. Autoriteti Shqiptar i Konkurrencës, duke qenë anëtar i këtij rrjeti, dhe duke pasur në konsideratë rëndësinë e ICN, ka marrë pjesë aktivisht në aktivitetet e grupeve të punës së këtij Rrjeti, me synimin për të ndarë eksperiencën dhe duke dhënë kontributet përkatëse .

## V. BURIMET NJERËZORE


Investimi dhe motivimi i kapitalit njerëzor ka qenë një tjetër objektiv për Autoritetin e Konkurrencës edhe për vitin 2015. Matja e performancës në mënyre sa më objektive dhe përdorimi i instrumenteve që do të nxisin ambicien e personelit për përmirësimin e rezultateve përbën një sfidë të vazhdueshme për institucionin e konkurrencës.

### V.1. Struktura organizative dhe funksionet e Autoritetit të Konkurrencës

Gjatë viti 2015, struktura organizative e Autoritetit të Konkurrencës është miratuar me Vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 77/2015. Ky vendim, pa ndryshuar misionin dhe detyrat sipas drejtorive, konsiston në shtimin me një pozicion të ri, inspektor në Drejtorinë e Mbikëqyrjes dhe Hetimit të Tregjeve si dhe transferimi i inspektorit të teknologjisë së informacionit nga Drejtoria Juridike në atë të Mbikëqyrjes së Tregut. Kjo shtesë dhe lëvizje është bërë për arsye të nevojave dhe specifikave të proceseve gjatë veprimtarisë, të cilat janë vazhdimisht në rritje.

Numri i punonjësve në total, për vitin 2015, është 37 vetë, nga të cilët 25 vetë janë staf teknik i përbërë nga ekonomistë dhe juristë (12 ekonomistë 11 juristë 2 informaticienë) si dhe personeli mbështetës.

#### Stafi teknik i Autoritetit sipas formimit



Autoriteti i Konkurrencës përbëhet nga Komisioni i Konkurrencës, si organ vendimmarrës dhe Sekretariati si organ administrativ dhe hetimor. Në shtojcën nr.9 “Struktura e Autoritetit të Konkurrencës” bashkëlidhur është vendosur organograma e Autoritetit të Konkurrencës.

**Komisioni i Konkurrencës:** Përbëhet nga pesë anëtarë, të votuar në mënyrë nominale nga Parlamenti. Aktualisht Komisioni ka në përbërjen e vet katër ekonomistë dhe një juristë. Përmirësimi i vazhdueshëm nëpërmjet debatit dhe mendimit alternativ kanë qenë karakteristikat e veprimtarisë së Komisionit të Konkurrencës për forcimin e zbatimit të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

**Kabineti:** Është njësi që funksionon pranë Komisionit duke asistuar në organizimin dhe mirëfunksionimin e mbledhjeve të Komisionit, ndërlihd punën midis Komisionit dhe

Sekretariatit, organizon seancat dëgjimore, mban marrëdhëniet me Kuvendin, marrëdhëniet me mediat, marrëdhëniet me jashtë, kujdeset për instrumentet e advokacisë dhe kulturës së konkurrencës etj.

**Sekretariati:** Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës është organi administrativ i ngarkuar me ligj për të kryer monitorimin dhe hetimin e tregjeve për të siguruar konkurrencën e lirë dhe efektive në treg. Sekretariati drejtohet nga Sekretari i Përgjithshëm, dhe përbëhet nga tre drejtori dhe sektori i analizës. Punonjësit e sekretariatit janë nëpunës me statusin e shërbimit civil.

**Drejtoria Mbikëqyrjes dhe e Hetimit të Tregjeve** realizon procesin e mbikëqyrjes dhe të investigimit të sjelljes së ndërmarrjeve në treg në zbatim të Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe Politikës Kombëtare të Konkurrencës. Kjo drejtori përbëhet nga tre sektorë të emërtuar sipas tre shtyllave kryesore që prezantohen në Ligj, Sektori i Abuzimit me Pozitën Dominuese, Sektori Anti-kartel dhe Sektori i Përqendrimeve.

**Drejtoria Juridike, e Hetimit dhe Proçedurave** realizon argumentimin juridik të produkteve të veprimtarisë së Sekretariatit, merr pjesë në grupet e punës gjatë procedurave hetimore në bashkëpunim me Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Tregut, dhe përfaqëson Autoritetin në proceset gjyqësore në mbrojtje të Vendimeve të Komisionit ndaj akt-padive nga palët e prekura.

**Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Integritimit Evropian** është pjesa e strukturës së funksionimit të Autoritetit të Konkurrencës e cila realizon kryesisht përafrimin e legjislacionit të konkurrencës me atë të BE, si dhe menaxhimin e burimeve njerëzore në përputhje me kërkesat dhe proçedurat e Ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, programon zhvillimin e kapaciteteve nëpërmjet trajnimeve, duke shfrytëzuar të gjitha burimet e mundshme si OECD, ICN, RCC, ITAP, Universiteti i Tiranës etj.

Një drejtim tjetër i punës së kësaj drejtorie është mbulimi i veprimtarisë financiare të Autoritetit dhe mbajtja e përgjegjësisë së plotë për të gjitha proçedurat e hartimit dhe të administrimit të fondeve të buxhetit, në përputhje me legjislacionin për menaxhimin e buxhetit të Shtetit Shqiptar.

**Sektori i Analizës dhe Studimit** ka si mision realizimin e monitorimeve sistematike të tregjeve sipas detyrave të përcaktuara nga vendimet e Komisionit të Konkurrencës, si dhe vëzhgimin e kushteve dhe kryerjen e analizave ekonomike të strukturave të ndryshme të tregjeve.


## V.2. Forcimi i kapaciteteve administrative

Autoriteti i Konkurrencës vazhdimisht i ka kushtuar vëmendje forcimit të kapaciteteve administrative si faktori kyç për pavarësinë reale të institucionit si dhe për realizimin me sukses të zbatimit të ligjit.

Gjatë 2015, punonjësit e Autoritetit të Konkurrencës kanë marrë pjesë në workshope trajnuese, takime apo konferenca të shumta në fushën e konkurrencës, duke qenë pjesëmarrës aktiv në to, nëpërmjet diskutimit të rasteve praktike, shkëmbimit të eksperiencave dhe informacioneve, risive në fushën e konkurrencës.

Personeli i Autoritetit të Konkurrencës është trajnuar për rreth 48 ditë gjatë vitit 2015, në trajtimin e rasteve dhe praktikave të fundit në fushën e konkurrencës. Një paraqitje

grafike e trajnimeve sipas institucioneve organizuese të trajnimeve paraqitet si më poshtë:



### V.3. Menaxhimi financiar

Autoriteti i Konkurrencës gjatë vitit 2015 ka zbatuar me korrektësi kërkesat e Ligjit Nr160, date 27.11.2014 "Për buxhetin e vitit 2015". Administrimi i vlerave materiale dhe monetare është konsideruar një fushë e rëndësishme e punës tonë duke zbatuar me korrektësi të gjitha aktet ligjore e nënligjore dhe normativat në përdorimin e fondeve buxhetore.

Sektori i financës në këtë institucion planifikon dhe ndjek miradministrimin e shpenzimeve buxhetore të miratuara, të cilat janë të lidhura me aktivitetin e institucionit, Në tërësinë e vet ky sektor ka ndikuar në realizimin e objektivave që ka institucioni.

Buxheti i miratuar për vitin 2015 është realizuar në masën 94.5%. Informacioni i detajuar jepet në pasqyrën e paraqitur në aneksin mbi realizimin e buxhetit.

Mosrealizimi në masën 5.5% % ka ardhur kryesisht nga fondet e mbetura pas procedurave të prokurimeve të kryera gjatë vitit si dhe nga parashikimet për paga dhe sigurime shoqërore për një pozicion inspektori të paplotësuar nga momenti i miratimit të strukturës deri në realizimin e procedurave të konkurrimit.

Gjatë hartimit të projekt buxhetit për vitin 2016 është marrë në konsideratë parrimi i rritjes institucionale, si nga pikëpamja e kapitalit njërëzor ashtu edhe nga pikëpamja e investimeve në teknologjinë informatike. Por, buxheti i miratuar për vitin 2016 nuk na mundëson realizimin e plotë të këtij objekti.

## VI. PRIORITETET PËR VITIN 2016

Përcaktimi i prioriteteve merr në konsideratë eksperiencat pozitive dhe jopozitive me të cilat është ballafaquar Autoriteti i Konkurrencës gjatë aktivitetit të përditshëm për zbatimin e Politikës dhe të Ligjit të Konkurrencës, por jo vetëm. Zbatimi i rekomandimeve të raportit të vlerësimit (Peer Review), paraqitur nga ekspertet e UNCTAD-it, do të përbejnë drejtimet kryesore të aktivitetit të Autoritetit të Konkurrencës për të përmirësuar performancën institucionale, si dhe do të shërbejnë si një platformë bashkëpunimi me të gjithë faktorët e tjerë kyç për përmirësimin e zbatimit të Politikës së Konkurrencës.

Sikurse është argumentuar edhe në këtë raport, efiçensa e Vendimeve të Komisionit të Konkurrencës është në funksion të vendimeve të gjyqësorit si dhe të shkallës së marrjes në konsideratë të rekomandimeve që i adresohen enteve rregullatore dhe institucioneve publike, politikbërëse dhe ekzekutive. Prandaj, ky aspekt i zbatimit të Ligjit ka qenë në fokus kryesor për përcaktimin e prioriteteve për vitin që sapo ka filluar.

Promovimi i një ambienti pro konkurrues kërkon jo vetëm zbatimin e Ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” por edhe zbatimin e të gjithë legjisllacionit shqiptar që ndikon konkurrencën në treg. Ky është një tjetër faktor i marrë në konsideratë për përcaktimin e prioriteteve.

Forcimi i zbatimit të ligjit, si ndaj operatorëve ashtu edhe ndaj fasilitorëve (institucioneve publike) të tregut, në funksion të mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg; debati publik dhe miratimi dokumentit të Politikës së Konkurrencës; plotësimi kuadrit nënligjor; zbatimi i projekteve të asistencës teknike në funksion të rritjes dhe forcimit të kapaciteteve administrative janë sfidat kryesore të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2016.

### VI.1. Zbatimi i ligjit të konkurrencës

Përfundimi i hetimit të përgjithshëm në Sektorin Bankar mbështetur në metodologji dhe praktika të konsoliduar të hulumtimit të tregut, mbetet rasti kryesor për autoritetin gjatë gjysmës së parë të vitit 2016. Tashmë janë administruar të dhënat e kërkuara nga bankat dhe subjektet e tjera financiare jo bankare dhe në vijim do të realizohen analiza e tyre për t'i dhënë përgjigje pyetjes se cili është niveli i konkurrencës në këtë sektor jetik të ekonomisë shqiptarë.

Përfundimi i rasteve hetimore dhe të monitorimit të nisura gjatë vitit të kaluar si: në tregun e prokurimit publik të sinjalistikës rrugore; tregun e prodhimit të qumështit e nënprodukteve të tij; tregu i mediave me pagesë, i cili është një treg i rregulluar dhe do të bashkëpunojmë me AMA; tregu i shërbimit të teknologjisë së informacionit (software dhe hardware) në procedurat e prokurimit publik etj.

Gjithashtu, në funksion të forcimit të zbatimit të Ligjit të Konkurrencës dhe të rritjes së besimit tek komuniteti i biznesit dhe i konsumatorit, institucioni i konkurrencës do të trajtojë të gjitha ankesat nga operatorët e tregut apo faktorë të tjerë, duke përdorur instrumentet ligjore dhe në respektim të afateve, për rivendosjen e konkurrencës.



## VI.2 Përafrimi dhe përmirësimi i legjislacionit

Në vëmendje të Autoritetit të Konkurrencës, edhe për vitin 2016, do të jetë plotësimi dhe përmirësimi i kuadrit nënligjor dhe rregullativ nëpërmjet hartimit të rregulloreve dhe udhëzuesve apo amendimeve të tyre me qëllim rritjen e shkallës së përafrimit me kuadrin ligjor të BE-së, Acquis Communautaire dhe me standardet e parimet ndërkombëtare të konkurrencës.

Janë identifikuar nevojat për përmirësime të mëtejshme legjislative në fushën e konkurrencës të cilat janë pasqyruar edhe në Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2016-2020. Kuadri ligjor dytësor i Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2016 do të plotësohet me akte të tjera nënligjore dhe konkretisht: Udhëzimin “Për Procedurat e thjeshtëzuara në rastet e përqendrimeve”, si dhe Udhëzimin “Mbi procedurat e angazhimeve” të cilët ishte pjesë e një nga rekomandimet e UNCTAD

Autoriteti i Konkurrencës në zbatim të ligjit “Për mbrojtjen e të dhënave personale”; në përmbushje të detyrimeve për plotësimin e Regjistrimit Elektronik; për regjistrimin në databazën e të dhënave shtetërore si dhe nevojave për saktësimin e marrjes së të dhënave elektronike gjatë inspektimeve, ka ndërmarrë disa nisma për plotësimin e legjislacionit sekondar. Këto nisma do të miratohen gjatë tremujorit të parë të vitit 2016.

## VI.3. Rritja e advokacisë dhe bashkëpunimi ndërinstytucional

Prioriteti kryesor për vitin 2016 është bashkëpunimi me Shkollën e Magjistraturës për trajnimin e gjyqëtarve, për një njohje sa më të plotë të veçorive të ligjit të konkurrencës si dhe të drejtës europiane në këtë fushë. Gjithashtu, bashkëpunimi me Komisionin e Ekonomisë për të kthyer në një plan pune rekomandimet e Autoritetit të Konkurrencës si dhe rekomandimet e UNCTAD për një treg sa më konkurrues.

Autoriteti i Konkurrencës, gjatë vitit të kaluar, ka punuar për ri-konceptimin e dokumentit të Politikës së Konkurrencës duke zgjeruar tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit, përmirësimin e instrumenteve hetimorë dhe bashkëveprimin me aktorët e tregut dhe institucionet, kryesisht entet rregullatorë, për të siguruar funksionimin e një ekonomie tregu konkurruese. Vazhdimi i frymës së Politikës Kombëtare të Konkurrencës drejt standardeve të BE-së është edhe një nga rekomandimet e UNCTAD, për forcimin e ambientit pro konkurrues në Shqipëri.

Gjatë vitit 2016, me përparësi do të shikohet procesi i konsultimit të draftit të dokumentit të Politikës Kombëtare të Konkurrencës me stafet akademike të Fakultetit Juridik dhe Ekonomik, me komunitetin e biznesit dhe konsumatorit, entet rregullatore, politikëbërësit dhe ekzekutivin. Gjithëpërfshirja në këtë diskutim publik është konsideruar si instrumenti më efikas për forcimin e advokacisë dhe kulturës së konkurrencës. Në përfundim të tërheqjes së opinionit nga të gjithë palët e interesit, procesi do të përfundojë me miratimin nga Komisioni i Konkurrencës të dokumentit të Politikës së Konkurrencës.

Bazuar edhe në rekomandimet e UNCTAD, me qëllim rritjen e efikasitetit në luftën kundër karteleve në prokurimet publike, do të bashkëpunohet me institucionet e ngarkuara me prokurimet publike dhe antikorrupsionin; do të forcohen instrumentet për

advokacisë e konkurrencës nëpërmjet një bashkëpunimi real përmes debatit dhe konsultimit me entet rregullatore dhe institucionet e tjera vendimmarrëse; do të organizohen tryeza informuese me komunitetin e biznesit në qarqet kryesore të vendit për rritjen e kulturës së konkurrencës, ndërgjegjësimin e operatorëve ekonomikë duke prezantuar programin e lehtësimit nga gjrobat si dhe politikën e konkurrencës.

#### **VI.4 Forcimi i kapaciteteve administrative**

Përmirësimi i kapaciteteve investiguese dhe realizimi i analizave të thelluara ekonomike që mundësojnë vlerësimin e sjelljes së firmave në treg, përbëjnë sfidat e vazhdueshme për forcimin e kapaciteteve institucionale të Autoritetit të Konkurrencës.

Forcimi i kapaciteteve administrative nëpërmjet trajnimeve të planifikuara sipas kërkesave të drejtorive dhe rekomandimeve të Komisionit Evropian në Progres Raportin e fundit, do të realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes në seminarët trajnuese që do të organizohen nga RCC(OECD), ICN etj.

Stafi i Autoritetit të Konkurrencës do të marrë pjesë në seminare dhe konferenca që do të organizohen nga entet publike, me qëllim mbrojtjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, parandalimin dhe zbulimin e praktikave anti konkurrese që mund të preken nga marrëveshjet e ndaluar, abuzimi me pozitën dominuese apo kontrolli i përqendrimeve.

Për vitin 2016 Drejtoria e Burimeve Njerëzore në Bashkëpunim me Drejtoret e Drejtorive ka hartuar planin e zhvillimit profesional për çdo nëpunës, i cili përbën edhe një nga rekomandimet e raportit të UNCTAD. Për këtë arsye është hartuar grafiku individual i trajnimeve me temat e nevojshme që do të realizohet një pjesë nga Shkolla e Administratës Publike, një pjesë nga profesorë të universiteteve shqiptare e nga organizatorë të huaj.

Shtojca 1 Të dhëna statistikore mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës sipas viteve

Të dhëna statistikore mbi vendimet e Komisionit të Konkurrencës sipas viteve

Viti	Vendime në total	Përqendrim	Abuzimin me pozitën dominuese	Marrëveshje të ndaluara	Përjashtime nga marrëveshjet	Rregullore dhe udhëzues	Rekomandime ndaj institucioneve publike	Vendimepër vendosje gjobe	Masa të përkohshme	Kushte dhe detyrime	Vendime të tjera
2004	13	2				6	1	-			4
2005	17	-				2	3	1			12
2006	14	4				-	1	1			9
2007	25	9	1	3		4	2	5			6
2008	29	11	1		1	4	5	-			7
2009	36	8	1	2	1	2	10	2			12
2010	34	6	3	2	-	7	5	2			11
2011	43	10	2	2	-	6	5	1			18
2012	48	9	2	2	1	5	5	7			24
2013	42	13	0	1	1	3	1	2	1		22
2014	42	8	3	7	1	2	4	2	0	1	14
2015	51	11	3	6	1	3	11	0	1	2	15
<b>Vendime Total 394</b>											

*Shtojca 2* Vendimet e Komisionit të Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2015

1. Vendimi nr. 344, datë 02/02/2015 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve”
2. Vendimi nr. 345, datë 12/02/2015 “Për mbylljen e hetimit të thelluar në tregun e prodhimit, importit dhe tregtimit me shumicë të karburanteve, ndaj ndërmarrjeve “Kastrati” SH.A, “Genkludis” SH.A, “Everest Oil” SH.A, “Taci Oil” SH.A dhe “Armo” SH.A. dhe disa rekomandime për mirëfunktionimin e këtij tregu.
3. Vendimi nr. 346, datë 16/02/2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtimi i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut- Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3”
4. Vendimi nr. 347, datë 16/02/2015 “Për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Komisionit të Konkurrencës”
5. Vendimi nr. 348, datë 16/02/2015 për miratimin e Raportit Vjetor “Mbi veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2014 dhe synimet kryesore për vitin 2015”
6. Vendimi nr. 349, datë 19/02/2015 “Për masat rregulluese dhe rekomandimet në tregun e transportit ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe automjeteve”
7. Vendimi nr. 350, datë 19/02/2015 “Mbi vlerësimin e kërkesës së ndërmarrjes “SICPA” për revokimin e Vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr. 337, datë 11.11.2014 “Për disa rekomandime në lidhje me kontratën e koncesionit për projektimin, financimin, dizenjimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave”
8. Vendimi nr. 351, datë 03/03/2015 “ Për disa rekomandime për rritjen e konkurrencës në sektorin e komunikimeve elektronike lidhur me brezin e frekuencave 1800 MHz për sistemet GSM/LTE/UMT/WiMAX”
9. Vendimi nr. 352, datë 03/03/2015 për miratimin e udhëzimit “Mbi Vlerësimin e kufizimeve vertikale”
10. Vendimi nr. 353, datë 05/03/2015 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të cigareve të fabrikuara”
11. Vendimi nr. 354, datë 19/03/2015 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të pjesshëm të shoqërisë Archer Daniels Midland nga shoqëria Olam International Limited”
12. Vendimi nr. 355, datë 20/03/2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”
13. Vendimi nr. 356, datë 31/03/2015 “Për marrjen e masave të përkohshme ndaj ndërmarrjes Vodafone Albania SH.A, në tregun e telefonisë celulare me pakicë”
14. Vendimi nr. 357, datë 02/04/2015 mbi “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga shoqëria Credins Bank Sh.a të 76% të

kapitalit aksionar të Shoqërisë Administruese të Fondit të Pensionit Sicred Sh.a, të zotëruara nga shoqëria Sicredd Sh.a”

15. Vendimi nr. 358, datë 16/04/2015 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Ndërtimi i rrugës së Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (Segmenti Kthesa Saukut—Bregu i Lumit) loti 1, loti 2, loti 3” dhe disa rekomandime për Autoritetin Rrugor Shqiptar.
16. Vendimi nr. 359, datë 04/05/2015 “Për disa rekomandime në lidhje me marrëveshjen e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve”
17. Vendimi nr. 360, datë 04/05/2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës”
18. Vendimi nr. 361, datë 11.05.2015 “Për hapjen e hetimit paraprak në tregun e shërbimeve të hotelerisë”
19. Vendimi nr. 362, datë 15/05/2015 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prodhimit dhe shitjes me shumicë të vezëve”
20. Vendimi nr. 363, datë 14/05/2015 “Mbi refuzimin e kërkesës së ndërmarrjes “GEN-I Tirana” shpk për revokimin e Vendimit nr. 355, datë 20/03/2015 të Komisionit të Konkurrencës “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes”
21. Vendimi nr. 364, datë 27/05/2015 “Mbi Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet krijimit të një ndërmarrje të pavarur JV nga ndërmarrjet Maygar Telekom Nyrt dhe MET Holding AG”
22. Vendimi nr. 365, datë 04/06/2015 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfuturit të kontrollit nga shoqëria Tranzit Sh.p.k të 100% të kapitalit aksionar të “Credit Agricole Albania Bank” Sh.a, të zotëruar nga shoqëria “IUB Holding”
23. Vendimi nr. 366, datë 04/06/2015 “Për detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e masave detyruese për barazimin e tarifave dhe minutave brenda me jashtë rrjetit”
24. Vendimi nr. 367, datë 04/06/2015 “Për përjashtimin nga ndalimi i marrëveshjes për shit- blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE, për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015”
25. Vendimi nr. 368, datë 16/06/2015 “Për ndreqje gabimi material në Vendimin nr. 366, datë 04.06.2015 të Komisionit të Konkurrencës “Për detyrimin e ndërmarrjes Vodafone Albania për zbatimin e masave detyruese për barazimin e tarifave dhe minutave brenda me jashtë rrjetit”
26. Vendimi nr. 369, datë 02/07/2015 “Për disa masa detyruese në tregun e shërbimit të transportit ndërkombëtar detar në Portin e Vlorës”

27. Vendimi nr. 370, datë 21/07/2015 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm të Alcatel-Lucent nga Nokia Corporation”
28. Vendimi nr. 371, datë 04/09/2015 “Për mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e shërbimeve të hotelierisë”
29. Vendimi nr. 372, datë 04/09/2015 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga Raiffeisen Leasing Sh.a të portofolit të qirasë financiare të Tirana Leasing Sh.a”
30. Vendimi nr. 373, datë 16.09.2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit të përgjithshëm në sektorin bankar”
31. Vendimi nr. 374, datë 08/10/2015 për miratimin e Udhëzimit “Për kushtet dhe detyrimet në rastet e përqendrimeve”
32. Vendimi nr. 375, datë 08/10/2015 mbi “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Cogemat S.p.a nga shoqëria SNAI S.p.a”
33. Vendimi nr. 376, datë 15/10/2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/ horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore— vazhdimi”, Loti 1 dhe Loti 2”
34. Vendimi nr. 377, datë 22/10/2015 “Për domosdoshmërinë e marrjes së vlerësimit paraprak të Autoritetit të Konkurrencës në rastet e dhënies së të drejtave ekskluzive ose të veçanta nëpërmjet kontratave koncesionare”
35. Vendimi nr. 378, datë 02/11/2015 mbi “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet bashkimit me përthithje të Credins Leasing SHA nga Banka Credins SHA”
36. Vendimi nr. 379, datë 02/11/2015 “Mbi disa rekomandime për projekt/ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”
37. Vendimi nr. 380, datë 02/11/2015 “ Për hapjen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e prokurimit publik me objekt “Ruajtje objektësh për vitin 2015”, ndarë në 13 lote, zhvilluar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, për të parë nëse ka ose jo, shenja të kufizimit të konkurrencës”
38. Vendimi nr. 381, datë 09/11/2015 “Për vlerësimin e Projekt-Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike midis OSHEE SHA dhe “Furnizuesve”
39. Vendimi nr. 382, datë 17/11/2015 “Për miratimin e “Programi i Lehtësimit nga Gjjobat” dhe “Formulari i Aplikimit për Lehtësimin nga Gjjobat””
40. Vendimi nr. 383, datë 17/11/2015 “Për disa rekomandime lidhur me kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)



41. Vendimi nr. 384, datë 03/12/2015 “Mbi autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Air Liquide Hungary Ipari Gaztermelo Kft. nga shoqëria Messer Hungarogaz Kft”
42. Vendimi nr. 385, datë 03/12/2015 për “Disa rekomandime për Entin Rregullator të Energjisë mbi zgjidhjen e problematikës së faturimit për klientët e lidhur në tensionin e mesëm dhe faturohen në tensionin e ulët”
43. Vendimi nr. 386, datë 14/12/2015 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e prokurimit publik me objekt “Përmirësimi, rifreskimi i sinjalistikës vertikale/horizontale në akset kombëtare dhe përmirësimi i sigurisë rrugore”
44. Vendimi nr. 387, datë 14/12/2015 “Për disa rekomandime në tregun e shërbimit të pajisjeve fiskale”
45. Vendimi nr. 388, datë 14/12/2015 “Për mbylljen e procedurës së hetimit të thelluar në “Tregun e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në sistemin e shpërndarjes” dhe disa rekomandime për Entin Rregullator të Energjisë dhe Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
46. Vendimi nr. 389, datë 14/12/2015 “Për domosdoshmërinë e marrjes së vlerësimit paraprak të Autoritetit të Konkurrencës për projekt/ligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 9374, datë 21.04.2015, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar”
47. Vendimi nr. 390, datë 22/12/2015 për “Mbylljen e procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, shitjes me shumicë dhe pakicë të gazit të lëngshëm të naftës dhe dhënien e rekomandimeve për Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë”
48. Vendimi nr. 391, datë 24/12/2015 “Për disa rekomandime në lidhje me draft-amendamentin e Marrëveshjes së Koncesionit të lidhur me datë 15 Tetor 2004 ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Tirana International Aeroport SHPK”
49. Vendimi nr. 392, datë 29/12/2015 për një ndryshim vendimi nr. 391, datë 24.12.2015 “Për disa rekomandime në lidhje me draft-amendamentin e Marrëveshjes së Koncesionit të lidhur me date 15 Tetor 2004 ndërmjet Qeverisë së Shqipërisë dhe Tirana Internacional Aeroport SHPK”
50. Vendimi nr. 393, datë 29/12/2015 mbi “Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të përbashkët të shoqërisë Costa Edutainment S.p.a nga Venice European Investment S.p.a dhe Piora S.r.l.”
51. Vendimi nr. 394, datë 29/12/2015 mbi “Autorizimin e përqendrimeve të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit nga Kastrati Sh.a të Auto Star Albania Sh.a”

<b>Gjobat e vendosura nga AK</b>	<b>Shuma në lekë</b>	<b>Përqindja ndaj total<sup>2</sup></b>
Gjopa të vendosura në total	<b>1.037.199.298</b>	100
Gjopa të mbledhura nga përmbarimi	<b>522.123.238</b>	50%
Gjopa në proces mbledhjeje nga përmbarimi	<b>45.381.419</b>	5%
Gjopa për të cilat nuk është marrë ende një vendim gjyqësor (ende pa FP)	<b>469.694.641</b>	45%

## I. GJOBA TË DERDHURA NË BUXHETIN E SHTETIT NË TOTAL

- a) Vitet paraardhëse 259.831233 **Lekë**
- b) TUT+Classic 2130772+330.000 =**262292005 Lekë**

**Totali i derdhur : 522123238 Lekë**

## II. GJOBA NË PROÇES MBLEDHJEJE NGA PËRMBARIMI TË MBARTURA PËR 2015

- a. "Albanian Airlines" 2.600.000 lekë
- b. "Classic" 25.382.000lekë
- c. "Noti" 2.994.000 lekë
- d. Furrtarët e Vlorës 240.000 lekë
- e. "Ultra Motors" 1.517.000 lekë
- f. "Hyundai" 5.383.000 lekë
- g. "VILOIL" 100.000 lekë
- h. "Media vision" 100.000 lekë
- i. "ROMANO PORT" 6.735.419 lekë

**Totali 45.611.419-230.000(K.Hallka+Heany+Geci) = 45.381.419 lekë**

<sup>2</sup> Shifrat në përqindje janë të rrumbullakosura

Nr.	Vendimi i Komisionit	Lëshimi i Urdhrit të Ekzekutimit nga Gjykata	Debitor
1	Nr. 59 datë 09.11.2007 "Vendosje gjobe ndaj AMC SHA dhe Vodafone SHA"	Vendimi Nr. 3359 Akti datë 09.11.2010 (Vetëm për pjesën që i përket AMC)	AMC SHA
2	Nr. 66 datë 18.12.2007 "Për vendosje gjobe ndaj ndërmarrjeve që operojnë në tregun e betonit"	Vendimi Nr. 3357 Akti datë 22.12.2010	"Alban Tirana Co", "Best Construction Alb", "Beton Ekspres", "Ferro Beton & Const", "Halili", "Ital - Beton Const", "Kirchberger - Albania", "Qarri - 02", " Shkodra Beton"
3	Nr. 123 datë 08. 09. 2009 "Vendosje gjobe ndaj Albanian Airlines MAK" SHPK.	Vendimi Nr. 3355 Akti datë 12.11.2010	Albanian Airlines MAK SHPK
4	Nr.290,dt.3ë7ë2013 "Per vendosje gjobe ndaj TUT per abonentë"	Vendimi Nr. 371 Akti datë 18.03.2015	Tirana Urban Trans, Vlera 2.130.772 Lek
5	Nr. 154 dt. 01.10.2011 (vetëm për pjesën që i përket ndërmarrjes "Hyundai Auto Albania" sh.p.k.)	Vendimit Nr. 1611 Akti datë 10.02.2012	Hyundai Auto Albania sh.p.k.
6	Nr. 239 datë 26.07.2012 "Vendosje gjobe ndaj Media Vizion",	Vendimit Nr. 9772 Akti datë 09.10.2012	Media Vizion
7	Vendimi i Komisionit të Konkurrencës Nr. 154 dt. 01.10.2011 (vetëm për pjesën që i përket ndërmarrjes "Ultra Motors" sh.p.k.)	Vendimit Nr. 1612 Akti datë 27.02.2012	Ultra Motors sh.p.k
8	Nr. 154 dt. 01.10.2011 (vetëm për pjesën që i përket ndërmarrjes "Classic" sh.p.k dhe "NOTI" SHPK)	Vendimit Nr. 2384 Akti datë 19.04.2013	Classic sh.p.k dhe "NOTI" SHPK
9	Nr. 265, datë 05.02.2013 "Për Vendosje Gjobe ndaj ndërmarrjes VILOIL" SHA	Vendimi Nr. 7677 Akti, datë 20.12.2013	VILOIL SHA
10	Nr. 221, datë 11.04.2012 "Për Vendosje Gjobe ndaj ndërmarrjes "Romano Port" SHA	Nr. 703 Regjistri, datë 23.05.2014	ROMANO PORT SHA

Shtojca 5: Përqendrimit e njoftuara dhe të autorizuara

Nr.	Rasti i Përqendrimit	Tregu Përkatës	Nr. i Vendi meve	Data e Autorizimit	Procedura	Lloji i Përqendrimit
1	Archer Danilesë Olam Internatioal Limited	Tregu i prokurimit dhe tregtimit të kokrrave të kakaos	354	19.03.2015	Faza e parë Formulari i thjeshtuar i njoftimit	Përfitim i Kontrollit të Pjesshëm
2	Credins Bankë Shoqëria Administruese e Fondit të Pensioneve Sicred Sh.aëSicred sh.a	Tregu i Pensioneve Private Vullnetare	357	02.04.2015	Faza e parë Formulari i thjeshtuar i njoftimit	Përfitim i Kontrollit
3	Magyar Telekom Nyrtöë MET Holding AG	Tregu i shpërndarjes me shumicë dhe pakicë të gazit natyror dhe tregu i shitjes me pakicë dhe shumicë i energjisë elektrike si dhe gjenerimin e energjisë elektrike	364	27.05.2015	Faza e parë Formulari i thjeshtuar i njoftimit	Joint Venture
4	Tranzit Sh.p.kë Crdit Agricole Albania Bank sh.aëIUB Holding	Tregu i ofrimit të shërbimeve bankare për individë dhe korporata	365	04.06.2015	Faza e parë Formulari i thjeshtuar i njoftimit	Përfitim i Kontrollit
5	Alcatel-Lucentë Nokia Corporation	Tregu i pajisjeve, pjesëve elektronike dhe telekomunikacionit dhe zgjidhjeve (solutions), shërbimeve profesionale të lidhura me to	370	21.07.2015	Faza e parë Formulari i thjeshtuar i njoftimit	Përfitim i Kontrollit
6	Raiffeissen Leasing sh.aë Tirana Leasing sh.a	Tregu i qirasë financiareëLeasing	372	04.09.2015	Faza e parë Formulari i thjeshtuar i njoftimit	Përfitim i Kontrollit
7	Cogemat s.p.aë SNAI s.p.a	Tregu i ndërtimit, rinovimit dhe restaurimit të hidrocentraleve	375	08.10.2015	Faza e parë Formulari i thjeshtuar i njoftimit	Përfitim i Kontrollit
8	Credins Leasing sh.aë Banka Credins sh.a	Tregu i qirasë financiareëLeasing	378	02.11.2015	Faza e parë Formulari i thjeshtuar i njoftimit	Merger
9	Air Liquide Hungary Ipri Gaztermelo Kftë Messer Hungarogaz Kft	Tregu i gazeve industriale	384	03.12.2015	Faza e parë Formulari i thjeshtuar i njoftimit	Përfitim i Kontrollit
10	Costa Edutainment s.p.aëVenice European Investment s.p.aëPriora s.r.l	Tregu i ndërtimit, rinovimit dhe restaurimit të hidrocentraleve	393	29.12.2015	Faza e parë Formulari i thjeshtuar i njoftimit	Përfitim i Kontrollit
11	Kastrati sh.aëAuto Star Albania sh.a	Tregu me shumicë dhe pakicë i tregtimit të mjeteve motorike dhe i pjesëve të këmbimit	394	29.12.2015	Faza e parë Formulari i thjeshtuar i njoftimit	Përfitim i Kontrollit



REPUBLIKA E SHQIPËRISE  
KUVENDI

MIRATOHET

KRYETARI

**Ilir Meta**

**REZOLUTE**

**PER VLERESIMIN E VEPRIMTARISE SE AUTORITETIT  
TE KONKURRENCES PER VITIN 2014**

**Kuvendi i Shqiperise konstaton se:**

Veprimtaria e Autoritetit te Konkurrences eshte ushtruar ne perputhje me kerkesat e ligjit nr.9121, date 28.7.2003,"Per mbrojtjen e konkurrences", te ndryshuar.

**Kuvendi vlereson veprimtarine e Autoritetit te Konkurrences ne drejtim te:**

-Ndergjegjesimit dhe rritjes se besimit te publikut ne rolin e Autoritetit ne mbrojtje te konkurrences, e shprehur nepermjet rritjes se numrit te çeshtjeve te ankimuaara prane Autoritetit te Konkurrences.

- Rritjes se numrit te nderhyrjeve ne treg dhe zgjerimit te llojeve te tregjeve, te cilat kane qene objekt i monitorimit dhe hetimeve ne zbatim te ligjit.

-Konsolidimit te institucionit te konkurrences nepermjet permiresimit te nivelit te ekspertizes dhe forcimit te kapaciteteve institucionale , si nje nga faktoret kryesore per pavaresine reale te institucionit te konkurrences.

-Plotesimit dhe permiresimit te kuadri t ligjor dhe rregullativ, duke synuar parafrimi n me standardet nderkombetare, ne kuader te permbushjes se angazhimeve te institucionit dhe te vendit per zbatim i n e Marreveshjes se Stabilizim-A sociimit me Bashkimin European.

**Kuvendi kerkon qe Autoriteti i Konkurrences, per vitin 2015, te permiresoje punen ne drejtim te:**

-Monitorimit ne menyre te vazhdueshme e te tregjeve prioritare, qe kane qene objekt hetimi apo monitorimi nga Autoriteti i Konkurrences me pare si: tregu i telefonise celulare, tregu importit dhe shitjes me shwnice te gazit, tregu i sigurimeve, tregu i karburanteve, tregu i energji se, tregu i sherbimit te transportit ajror, tregu i transportit nderkombetar detar te udhetareve dhe automjeteve, per te ndjekur sjelljen e firmave ne treg.

-Ndjekja ne vazhdimesi eshte e rendesishme per te mundesuar zbatimin konkret terekomandimeve te dhena, me qellim vendosjen dhe ruajtjen e konkurrences se lire dhe efektive ne keto tregje.

- Shpeshimit te inspektimeve ne formen "*Dawn raids*" me nismen e vete Autoritetit ne tregjet me kerkesa cilesore e te ndjeshme ndaj shpenzimeve konsumatore, me qellim parandalimin dhe zbulimin e praktikave antikonkurrese.

- Angazhimit ne vazhdimesi ne procese trajnimi te gjyqesorit administrativ te te gjitha shkalleve per te thelluar njohurite ne fushen e se drejtes se konkurrences, per te mundesuar nje rishikim gjyqesor sa me objektiv ne interesin publik te vendimeve te Autoritetit dhe te konkurrences, si nje e mire publike, duke qene se efienca e nderhyrjes se institucionit te konkurrences ne treg kushtezohet ne menyre te ndjeshme nga zbatimi i vendimeve te tij.

- Nxitjes se metejshtme te perhapjes se advokacise e kultures se konkurrences nepermjet bashkepunimit proaktiv, me ane te aktiviteve te perbashketa me komunitetin e biznesit, per te vleresuar perceptimin e biznesit mbi nivelin e njohjes se filozofise se konkurrences dhe zbatimit te ligjit e per te siguruar qe veprimtaria e tyre te jete ne perputhje me rregullat e konkurrences.

-Forcimit te rolit te institucionit si mbrojtës i interesave te qytetareve nepermjet zbatimit te ligjit "Per mbrojtjen e konkurrencës".

### **Kuvendi i kerkon organeve ekzekutive te te gjitha niveleve te bashkepunojne me Autoritetin e Konkurrences:**

- Duke zbatuar detyrimin per te kerkuar parapraki sht vleresimin ligjor te Autoritetit te Konkurrences ne dhenien e miratimit e akteve, qe kane si objekt ose pasqje dhenien e te drejtave ekskluzive ose kufizime sasiore ne tregje ose sektore te ndryshem te ekonomise.

-Per konsultime te perhershme ne procesin e pergatitjes dhe miratimit te akteve ligjore dhe nenligjore.

- Per te paraqitur ne kohen e duhur prane Autoritetit te Konkurrences gjithë dokumentacionin e nevojshem te kerkuar per monitorimin e tregjeve apo hetimin e praktikave qe deformojne konkurrencen ne treg.

Miratuar ne daten 30.4.2015

*Rregullat e BE-së mbrojnë konkurrencën e lirë. Ato përfshijnë rregullat antikartel kundër marrëveshjeve kufizuese ndërmjet kompanive dhe abuzimit me pozitën dominuese. Rregullat e BE-së u ndalojnë gjithashtu qeverive dhënien e ndihmës shtetërore e cila shtrembëron konkurrencën.*

Shqipëria ka bërë **përgatitje të moderuar** në fushën e politikës së konkurrencës. Janë bërë **disa përparime** sidomos në lidhje me antikartelet dhe kontrollin e përqëndrimeve. Vitin e ardhshëm, Shqipëria duhet t'i kushtojë vëmendje të veçantë:

→ rritjes së pavarësisë operacionale të Komisionit të Ndhmës Shtetërore.

→ forcimit të kapaciteteve administrative të Njësisë për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore.

Në fushën **antikartel dhe kontrollit të përqëndrimeve (mergers and acquisitions)**, Autoriteti i Konkurrencës (AK) ka miratuar udhëzimet për vlerësimin dhe abuzimin e pozitës dominuese në treg dhe ka hartuar udhëzime të reja për mjetet ligjore bazuar në njoftimin e Komisionit Evropian për mjetet ligjore. Kapaciteti administrativ i AK-së është i mjaftueshëm dhe stafi i tij ka nivel të mirë ekspertize. Megjithatë, vonesat në proceset gjyqësore janë shumë të gjata dhe duhen bërë përpjekje të mëtejshme për të rritur disponueshmërinë dhe cilësinë e trajnimit për gjyqtarët mbi politikën e konkurrencës.

Në fushën e **ndihmës shtetërore**, është ngritur një grup pune ndërministror për të përmirësuar bashkëpunimin. Shqetësim mbeten kapacitetet administrative të Njësisë për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë, Turizmit dhe Sipërmarrjes. Ligji për Kontrollin e Ndhmës Shtetërore është duke u rishikuar për të forcuar pavarësinë e autoriteteve zbatuese, por ky ligj mbetet vetëm pjesërisht i përafëruar me *acquis*. Shuma e ndihmës shtetërore të dhënë në 2014 ishte 46.4 milion euro, e cila është mënyrë të konsiderueshme më e vogël se në vitin e kaluar. Aksesin në informacionin e vendimeve të Komisionit të Ndhmës Shtetërore është përmirësuar me publikimin e vendimeve të tij online.

Për sa i përket liberalizimit, një vlerësim *ex post* i AK-së zbuloi se autoritetet kontraktuese nuk kishin përmbushur detyrimet e tyre për të kërkuar vlerësimin e AK-së kur u jepeshin të drejtat ekskluzive.

<sup>3</sup> <http://www.integrimi.gov.al/al/dokumenta/progres-raporte/progres-raporti-2015&page=1>



Shtojca 8: Matrica e vendimeve për dhënie rekomandimesh për projektaktet për vitin 2015

Nr.	Objekti:	Nisma:	Vlerësimi i Autoritetit të Konkurrencës	Sa është marrë në konsideratë
1.	Vlerësimi i Kontratës Koncesionare për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve;	Monitorimi për marrëveshjen e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve.	Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit <b>Nr. 359, datë 04.05.2015</b> “Për disa rekomandime në lidhje me marrëveshjen e kontratës së koncesionit për shërbimin e markimit dhe monitorimit të karburanteve”, vendosi: <i>“1. T’i rekomandohet Autoritetit Kontraktor:</i> <i>a. Të kërkojë zbatimin me përpikmëri të marrëveshjes koncesionare për markimin dhe monitorimin e karburantit të importuar dhe prodhimit vëndas, si dhe të naftës bruto.</i> <i>b. Brenda nje kohe te pershtatshme te realizojë analizën e plotë ex-post të rezultateve gjatë fazës së parë të monitorimit deri në fund të vitit 2014”.</i>	
2.	Vlerësim i marrëveshjes për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sha dhe OSHEE, aprovuar nga ERE me vendimin Nr. 12, datë 06.02.2015.	Ankesa e Shoqatës së Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) me anë të shkresës Nr. 3 Prot., datë 13.03.2015; protokolluar me tonën Nr. 150 prot, datë 16.03.2015.	Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit <b>Nr. 367 , datë 04.06.2015</b> “Për përjashtimin nga ndalimi të Marrëveshjes për shit - blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE, për tepricat e energjisë elektrike, përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015”, vendosi: <i>“1. Të përjashtojë nga ndalimi i parashikuar në nenin 4 të Ligjit nr .9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, Marrëveshjen për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH dhe OSHEE përfshirë tepricat në kushtet e prurjeve të mëdha, me qëllim plotësimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2015.</i> <i>2. Afati i përjashtimit të kësaj marrëveshjeje është nga hyrja në fuqi e këtij vendimi deri më 31.12.2015.</i> <i>3. Miratimi sa më shpejt të Modelit të Tregut të Energjisë</i>	

			<i>Elektrike, në përputhje me specifikat e tregut shqiptar.</i> 4. <i>Njoftimin e marrëveshjeve dhe ndryshimet e bëra në to në Autoritetin e Konkurrencës, për vlerësimin e përjashtimit individual të marrëveshjeve.”</i>	
<u>3.</u>	Projekt Ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr. 10076, datë 12.02.2009, “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”	Shkresa nr. 14162ë1 prot, dt. 16.10.2015 (protokolluar pranë AK me nr. 411 prot, dt.21.10.2015) e Ministrisë së Financave.	Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit <b>Nr. 379, datë 02.11.2015</b> "Mbi disa rekomandime mbi projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", vendosi: 1.T'i rekomandojë Ministrisë së Financave, që në projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10076, datë 12.02.2009, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", të reflektohen ndryshimet e nevojshme, referuar neneve 11 dhe 12 të ligjit, me qëllim që në çdo rast palës së dëmtuar ti mundësohet trajtimi i kërkesës për dëmshpërblim nga siguruesi i drejtpërdrejt për të mundësuar rritjen e konkurrencës mes shoqërive të sigurimit dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit për të siguruarit.	
<u>4.</u>	Vlerësimi i Projekt-Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike midis OSHEE SH.A dhe “Furnizuesve” të energjisë elektrike;	Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) shkresa Nr. 1ë1 prot, datë 18.09.2015 (AK Nr. 383 prot, dt. 18.09.2015). Si dhe shkresa e ERE-s me nr.	Autoriteti i Konkurrencës, me anë të Vendimit <b>Nr. 381, datë 9.11.2015</b> “Për vlerësimin e Projekt-Marrëveshjes së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike midis OSHEE SHA dhe “Furnizuesve”, vendosi: “1. <i>“Projekt-Marrëveshja e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike midis OSHEE SHA dhe “Furnizuesve” të energjisë elektrike, e propozuar nga Shoqata Shqiptare e Furnizuesve të Energjisë Elektrike (AAES) nuk bie në kundërshtim me Ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar).”</i>	Nuk ka patur rekomandime pasi akti ka qenë në përputhje me ligjin “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”

		620 prot., datë 20.10.2015.		
5.	Kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”	Me nismën e vetë AK	<p>Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit Nr. <b>383, datë 17.11.2015</b> “Për disa rekomandime lidhur me kontratën e koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”, vendosi:</p> <p>1. T’i rekomandojë Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Financave:</p> <p>1.1 Përpara fillimit të zbatimit të projektit të koçesionit të miratojnë metodologjinë e përcaktimi të tarifave për shërbimet portuale të ofruara nga ndërmarrja koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)”.</p> <p>1.2 Brenda një periudhe sa me optimale të përcaktoje metodologjinë e përgjithshme të përcaktimit të tarifave për çdo koncesion me procedure të një propozimi të pakërkuar.</p> <p>1.3 Në çdo rast tjetër për koncesionet me procedure të një propozimi të pakërkuar, fillimisht të miratohet metodologjia specifike përkatëse për përcaktimin e tarifave dhe vetëm me pas, Ligjit për miratimin e kontratës koncesionare.</p> <p>2. Në rregulloren që do të miratohet për funksionimin e Portit MBM (Multy Buoy Mooring), të përcaktohet qartë:</p> <p>(a) mënyra e operimit të anijeve sipas parimit “kush hyn i pari, shërbehet i pari”;</p> <p>(b) detyrimi i ndërmarrja koncesionare “Porti MBM (Multy Buoy Mooring)” për të respektuar të drejtën e</p>	Pas këtij vendimi Ministria e Transporteve ka sjellë për mendim ex-ante kontratat e tjera koncesionare

			<p>barazisë për shoqëritë që do të kryejnë shërbime nëpërmjet këtij porti, duke vendosur kushte të barabarta për veprime tregtare të njëjta si dhe</p> <p>(c) detyrimi i koncesionarit për t'u ofruar shërbimet e saj të gjithë shoqërive me të njëjtat kushte teknike dhe financiare.</p> <p>Në përcaktimin e metodologjisë së tarifave për shërbimet portuale të ofruara nga ndërmarrja konçesionare "Porti MBM (Multy Buoy Mooring)", të ketë në konsideratë se tarifat duhet të jenë të orientuara drejt kostos, të bëhen publike dhe transparente.</p>	
<u>6.</u>	Vlerësim mbi projekt-ligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar”;	Me nismën e vetë AK.	<p>Komisioni i Konkurrencës me anë të Vendimit <b>Nr. 389, datë 14.12.2015</b> “Për domosdoshmërinë e marrjes së vlerësimit paraprak të Autoritetit të Konkurrencës për projektëligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar”, vendosi:</p> <p>“1. T’i kërkojë Këshillit të Ministrave dhe Kuvendit të Shqipërisë:</p> <p><i>Të zbatojë nenin 69 të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (i ndryshuar), duke kërkuar vlerësimin ligjor të Autoritetit të Konkurrencës për çdo projekt akt normativ që potencialisht mund të sjellë kufizime të konkurrencës në tregjet përkatëse.”</i></p>	
<u>7.</u>	Vlerësimi i ProjektëLigjit “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, për transport”.	Shkresa e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (MEI) nr. 7851 prot, dt. 02.12.2015,	<p>Autoriteti i Konkurrencës me anë të shkresës nr. 458ë1 prot, dt. 30.12.2015 është shprehur se: ProjektëLigji “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburanteve dhe të lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, për transport”, nuk bie ndesh me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, të ndryshuar.</p>	

		protokolluar me tonën Nr. 458, date 03.12.2015.		
8.	Vlerësimi i Projekt Udhëzimit “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarive në fushën e transportit detar dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre”	Nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI) në rrugë elektronike	<p>Autoriteti i Konkurrencës, pas vlerësimit të Projekt Udhëzimit, me anë të shkresës nr. 185 prot, dt. 03.04.2015, konkludoi se Rekomandimet e dhëna me anë të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 349, datë 19.02.2015 janë marrë në konsideratë nga MTI, si dhe sugjeron që në Projekt Udhëzim të kryhen rregullimet e mëposhtme:</p> <p>- Në nenin 5, paragrafi 5, fjalia e dytë të projekt Udhëzimit ku është përcaktuar: “Licencës i bashkëlidhet orari dhe itinerari i linjës dhe çmimet e biletave përfshirë taksat.”, propozojmë që në përputhje me nenin 7, pika (j) dhe nenin 10, pika 4 të Projekt Udhëzimit, ky përcaktim të bëhet si vijon: “Licencës i bashkëlidhet orari dhe itinerari i linjës dhe çmimet maksimale të biletave sipas të gjitha kategorive përfshirë taksat.”.</p> <p>Në lidhje me Rekomandimin (5), për hartimin e një metodologjie bazuar në kostot reale për përcaktimin e nivelit të tarifave maksimale për shërbimin e transportit detar ndërkombëtar të udhëtarëve dhe automjeteve, mendojmë se për metodologjinë do të shërbejnë të dhënat që do të dorëzohen nga ndërmarrjet sipas rekomandimeve (1) dhe (3), por propozojmë se është e nevojshme që kërkesave ndaj ndërmarrjeve të përcaktuara në nenin 10 të Projekt Udhëzimit t’u shtohet dhe një pikë, lidhur me depozitimin e detajuar të të gjitha kostove reale për shërbimin që ofrojnë, gjë e cila do të bënte të mundur realizimin e metodologjisë.</p>	Rekomandimet e dhëna me anë të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 349, datë 19.02.2015 janë marrë në konsideratë nga MTI, duke u përfshirë në Projekt Udhëzimin “Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarive në fushën e transportit detar dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre”


<u>9.</u>	Vlerësim i Dokumentit të AKEP “Këshillim Publik - Rregullore për Ofrimin e Shërbimit Universal Postar”			
<u>10.</u>	Vlerësim i Dokumentit të AKEP “Këshillim Publik - Rregullore për Autorizimin e Përgjithshëm për Ofrimin e Shërbimeve Postare			
<u>11.</u>	Vlerësim mbi draftërregullore “për procedurat e licensimit, modifikimit, transferimit të pjeshëm ose te plotë, rinovimit dhe heqjes se licensave ne sektorin e energjisë elektrike”;	Shkresa e ERE Nr. 498 prot, datë 03.07.2015 (protokolluar me tonën Nr. 303 prot, datë 6.07.2015).	Autoriteti i Konkurrencës me anë të shkresës nr. 303ë1 prot, dt. 22.07.2015 drejtuar ERE, është shprehur se: Projekt-Rregullorja e paraqitur nuk bie ndesh me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, por procedurat e licensimit të operatorëve pjesëmarrës në tregun e energjisë elektrike duhet të kryhen në përputhje me modelin e tregut të energjisë elektrike, i cili ende nuk është miratuar apo hedhur për diskutim në grupet e interesit. Sugjerojmë që gjatë procedurave të licensimit të operatorëve të cilët janë të integruar vertikalisht apo do të licensohen për aktivitete në segmente të ndryshme të tregut të merret në konsideratë edhe opinioni i Autoritetit të Konkurrencës.	
<u>12.</u>	Vlerësim mbi draftë Rregullore mbi procedurat për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike;	Shkresa e ERE Nr. 499 prot, datë 03.07.2015 (protokolluar me tonën Nr. 304 prot, datë 6.07.2015);	Autoriteti i Konkurrencës me anë të shkresës nr. 304ë1 prot, dt. 22.07.2015 drejtuar ERE, është shprehur se: Projekt-Rregullorja e paraqitur nuk bie ndesh me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”. Por meqenëse Operatori i Sistemit të Transmetimit luan një rol kyç për mirëfunksionimin e tregut të energjisë elektrike nga pikëpamja e konkurrencës, e konsiderojmë si shumë të rëndësishme që rregullorja për procedurat e certifikimit duhet të miratohet pas miratimit ose paralelisht me hartimin apo miratimin e modelit të tregut të energjisë	

			elektrike.	
<u>13.</u>	Vlerësim mbi draftë Rregulloren për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s;	Nr. 500 prot, datë 03.07.2015 (protokolluar me tonën Nr. 305 prot, datë 6.07.2015)	Autoriteti i Konkurrencës me anë të shkresës nr. 305ë1 prot, dt. 22.07.2015 drejtuar ERE, është shprehur se: Projekt-Rregullorja e paraqitur nuk bie ndesh me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, por bazuar në eksperiencën e deritanishme do të ishte në interes të tregut të energjisë dhe të parandalimit të sjelljeve antikonkurruese në treg, në parashikimin e nenit 20 “Procedimi i aplikimit për marrje license”, të merret në konsideratë edhe opinioni i Autoritetit të Konkurrencës në lidhje me operatorët e rinj apo ekzistues që do të licensohen, në segmente të ndryshme të tregut të energjisë.	
<u>14.</u>	Vlerësim mbi projekt-ligjin “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me të”;			
<u>15.</u>	Mendim mbi kontratën e koncesionit për menaxhimin, operimin dhe mirëmbajtjen e terminalit lindor të Portit të Durrësit”;			
<u>16.</u>	Vlerësim mbi draft-amendimet e Rregullores se “Lidhjeve të Reja në sistemin e shpërndarjes”.	Shkresa e ERE me nr. 94ë3 prot, datë 23.03.2015 (protokolluar së brendshmi në AK me nr. 167 prot, datë 24.03.2015).	Autoriteti i Konkurrencës me anë të shkresës nr. 167ë1 prot, dt. 09.04.2015 drejtuar ERE, është shprehur se: <i>Parë nën këndvështrimin e Ligjit Nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, bazuar në nenin 69 të tij, draftëamendimet e Rregullores “Për lidhjet e reja në sistemin e shpërndarjes”, bien në kundërshtim me këtë ligj pasi sjellin kufizim të numrit të ofruesve për kryerjen e shërbimeve në rrjetin e shpërndarjes, gjë e cila çon në kufizim të konkurrencës në tregun përkatës dhe në mundësinë</i>	



			<p><i>konsumatore për të zgjedhur.</i></p> <p><i>Me qëllim shmangien e këtij kufizimi, Komisioni i Konkurrencës i rekomandon ERE-s që në ndryshimet e propozuara në Rregulloren e “Lidhjeve të Reja në sistemin e shpërndarjes”:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><i>1) Të mos ketë kufizim të numrit të ofruesve për të gjitha llojet e shërbimeve që do të kryhen në rrjetin e shpërndarjes;</i></li> <li><i>2) Të gjitha procedurat për shërbimet e kërkuara nga OSHEE “Për lidhjet e reja në rrjetin e shpërndarjes” të jenë transparente dhe të publikuara, me qëllim që të mos kufizohet numri i ofruesve të këtij lloji shërbimi;</i></li> <li><i>3) Miratimi për të licensuarit për shërbimet në rrjetin e shpërndarjes të kryhet nga ERE ose nga institucionet licensuese dhe të njoftohet OSHEE.</i></li> </ol>	
17.	Vlerësim i Dokumentit për Konsultim Publik “Analizë e tregut të telefonisë fikse: tregu me pakicë i aksesitëthirrjeve nga rrjete publike telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimitëtranzitimitëorigjinimit të thirrjeve në rrjetet telefonike publike nga vendndodhje fikse”.	Me nismën e vetë AK.	Autoriteti i Konkurrencës me anë të shkresës nr. 307ë1 prot, dt. 16.09.2015, drejtuar AKEP, është shprehur se: <i>Në përfundim të analizës, Autoriteti i Konkurrencës shprehet pa vërejtje dhe sugjerime, duke vlerësuar se dokumenti ka adresuar drejt çështjet e konkurrencës dhe se ndërmarrja “Albtelekom” ka rënie të pjesëve të tregut, duke u ndeshur me konkurrencë të operatorëve të tjerë.</i>	

Shtojca 9: Organograma e Autoritetit të Konkurrencës



**REALIZIMI I TREGUESVE TE BUXHETIT**

( Viti 2015 )

<b>E m e r t i m i</b>	<b>Njesia</b>	<b>Plani</b>	<b>Fakti</b>	<b>Mbetje</b>	<b>në %</b>
Paga, shpërblime e shpenzime etj.	leke	45,500,000	43,667,799	1,832,201	96
Kontribute për Sig. Shoqërore	leke	7,000,000	6,458,523	541,477	92
Materiale dhe Shërbime	leke	10,100,000	8,984,255	1,115,745	89
Bonus transporti	leke	240,000	240,000	0	100
Ndihme ekonomike	leke	50,000	50,000	0	100
Investime	leke	1,000,000	999,380	620	100
<b>Totali</b>		<b>63,890,000</b>	<b>60,399,957</b>	<b>3,490,043</b>	<b>94.5</b>

**Të ardhurat nga Përqendrimet janë 5,600,000 le**